





U N  
D P

*Albania*





**NXITJA  
E ZHVILLIMIT RAJONAL  
NEPERMJET OBJEKTIVAVE  
TE MIJEVJEÇARIT**

**Përgatitur me mbështetjen e**  
PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA (UNDP)

**Procesi i përgatitjes së raportit u drejtua nga Grupi Qëndror i përbërë nga:**

Kozma Hakani, Qazim Sejдини, Hysen Domi, Luljeta Dollani, Roland Çerepi, Pajtim Çela, Ferdinand Shuteriqi, Jani Dode, Shpresa Banja, Serafin Papa dhe Dhoksi Gjoka.

**Bashkëpunuan:**

Drejtorja e Koordinim-Zhvillimit e Këshillit të Qarkut, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik të Prefekturës, Drejtoritë e Zhvillimit Ekonomik të bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin, Drejtoritë e Shëndetit Publik të rretheve, Drejtoritë Arsimore të rretheve, Drejtoritë e Bujqësisë, Zyra Rajonale e Ndihmës Ekonomike, Zyra Rajonale e Punësimit, Drejtorja Rajonale e Pyjeve, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Agjencia Rajonale e Zhvillimit Elbasan, Instituti i Studimeve dhe Projekttimeve të Metalurgjisë, Instituti i Mjedisit, Forumi i Gruas Elbasan, Instituti i Duhanit Cërrrik, shoqata Gruaja Kurajoze dhe shoqata Shëndeti Publik.

**si dhe:**

Albert Delimeta, Abdulla Madhi, Alqi Çabiri, Arjan Rukaj, Besa Peçi, Beqir Kila, Desdemona Kali, Desantila Tahiraj, Drita Demiri, Kostandin Çakalli, Islam Levenishti, Kadri Kyçyku, Milva Ekonomi, Nurie Çausi, Silvana Simaku, Spiro Fara, Shpëtim Sulkuqi dhe Ymer Tola.

Përgatitja e raportit u asistua nga  
Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC).

**Autorë udhëheqës:**

Dr. Ylli Çabiri dhe Dr. Lindita Xhillari

**Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni:**

Drejtorja e Koordinim - Zhvillimit

Këshilli i Qarkut Elbasan

Tel: +355 54 528 61, Fax: +355 54 521 44

Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC)

Rr. Vaso Pasha, P. 9/1, Tiranë

Tel: +355 4 253 300, Fax: +355 4 253 299

E-mail: hdpc@icc-al.org

dhe

Zyra e Përfaqesuesit Rezident të UNDP në Shqipëri

Tel: +355 4 233122

E-mail: registry.al@undp.org

*Këtë Raport mund ta gjeni në trajtë elektronike nëpërmjet rrjetit të internetit me adresë: <http://www.undp.org.al>, <http://www.undp.org.al> dhe [www.elbasan.org.al](http://www.elbasan.org.al)*

**Redaktor i gjuhës shqipe:**

Prof. Dr. Xhevat Lloshi

*graphic design:*



# Përmbajtja e lëndës

Hyrje	7
Niveli varfërisë dhe të ardhurat	11
Shtimi i mundësive për shkollim	33
Nxitja e barazisë gjinore	51
Përkujdesja për shëndetin e nënës dhe të fëmijës	65
Sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm	79



## Përmbledhje Paraqitëse

Shqipëria është vend Ballkanik me një popullsi rreth 3.067 milion banorë dhe sipërfaqe 28,748 km<sup>2</sup>. Rreth 57% e popullsisë jeton në zonën rurale. Pas ndryshimeve politike të vitit 1991, Shqipëria u nda përfundimisht nga totalitarizmi dhe izolimi i skajshëm 50 vjeçar dhe u fut ne rrugën e zhvillimit demokratik. Dekada e tranzicionit është karakterizuar nga reforma të thella politike, ekonomike e sociale, të cilat kanë synuar ndryshimin rrënjësor të jetës në vendin, qe konsiderohet si më i varfëri i Evropës. Ndryshimet janë të dukshme, sikunder edhe veshtiresitë për të përmbushur aspiratën e shqiptarëve për t'u integruar në Bashkimin Evropian Vendi është i ndarë në 12 qarqe, të cilët përbëhen nga 36 rrethe dhe 309 komuna. Qarku i Elbasanit, i treti në vend për nga numri i popullsisë dhe sipërfaqja, deri në vitin 1990 konsiderohej si nje rajon i rëndësishëm industrial, ku mbizoteronte industria e rëndë. Kjo industri nuk mundi te mbijetojë, duke bërë që pasojat e tranzicionit te ndjehen më shumë se në shumicën e rajoneve të tjera të vendit. Me papunesi të lartë, me një nivel mjaft të ulët të prodhimit bujqësor, por me burime njerëzore dhe ekonomike të konsiderueshme, qarku i Elbasanit është përfshirë në rrugën e ndryshimeve të mëdha, duke bërë përpjekje të vendosë dhe realizojë objektivat afatmesme të zhvillimit dhe t'i harmonizojë ato me Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillimin.

Në Samitin e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, që u mbajt në shtator të vitit 2000, zhvillimi u vendos në qendër të të gjitha programimeve globale, dhe, duke sintetizuar Konventat dhe Deklaratat e mëparshme, që lidheshin me të, udhëheqësit e 191 vendeve të botës nënshkruan Deklaratën e Mijëvjeçarit, e cila përcakton edhe 8 Objektivat e Mijëvjeçarit për Zhvillimin. Nëpërmjet këtyre objektivave, çështje të tilla si zhdukja e varfërisë të skajshme dhe urisë, kryerja universale e arsimit bazë, nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas, zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore, rritja e kujdesit për shëndetin e nënës, lufta kundër sëmundjeve të rrezikshme, sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm dhe partneriteti për zhvillim global, u vlerësuan si kërkesat më themelore për të nxitur një zhvillim të qëndrueshëm të secilit vend. Këto objektiva tashmë janë përkthyer në synime e tregues sasiore, të cilët kanë

krijuar mundësinë e matjes së përparimit drejt përmbushjes së tyre.

Shqipëria është firmëtare e Deklaratës së Mijëvjeçarit dhe, mbështetur në angazhimet politike që ka marrë përsipër, është përfshirë në një proces të gjerë njohjeje, ndërgjegjësimi, zbërthimi e zbatimi të secilit prej Objektivave të Mijëvjeçarit. Raporti “Shqipëria dhe Objektivat e Mijëvjeçarit” ishte një shtysë e rëndësishme për këtë proces<sup>1</sup>. Ai ishte një përpjekje për të përshtatur synimet dhe treguesit për çdo Objektiv me kushtet reale të Shqipërisë dhe vendosur linjat bazë për secilin prej tyre, që të analizohen mundësitë e Shqipërisë për t'i përmbushur ato, të vlerësohen shkalla e angazhimit dhe e mbështetjes së mjedisit shqiptar, si dhe të përcaktohen masat më të rëndësishme që duhen marrë për të realizuar përparimin e nevojshëm. Ai përfaqëson,

<sup>1</sup> Raport i përgatitur në maj të vitit 2002 nga Qendra për Nxitjen e Zhvillimit Njerëzor (HDPC) për sistemin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, me mbështetjen e institucioneve shtetërore, Agjencive të OKB-së në Tiranë, Bankës Botërore dhe Organizatave Jofitimprurëse.

gjithashtu, një hap te parë për arritjen e një mirëkuptimi të të gjithë aktorëve në lidhje me treguesit dhe synimet e Objektivave të Mijëvjeçarit në nivel vendi.

Rritja e shkallës së njohjes për Objektivat e Mijëvjeçarit, si nga publiku i gjerë ashtu edhe nga strukturat vendimmarrëse dhe administrative, detajimi e përshatatja e mëtejshme e synimeve dhe treguesve me kushtet reale dhe stadin e zhvillimit të çdo sektori, integrimi më i mirë i Objektivave në strategjitë kombëtare dhe sektoriale të zhvillimit, përmirësimi i sistemit të grumbullimit, analizës dhe monitorimit të të dhënave, forcimi i partneritetit me sektorin jo qeveritar dhe përfshirja e gjerë e shoqërisë civile, si dhe nevoja e bashkërendimit të mbështetjes financiare të partnerëve ndërkombëtarë të Shqipërisë për të rritur frytshmërinë e ndërhyrjeve të tyre, ishin konkluzionet dhe rekomandimet më kryesore të kësaj analize. Raporti vlerëson se Shqipëria ka shanse të mira për t'i përmbushur Objektivat, por që kjo të ndodhë duhet të hartohen e zbatohen politika e programe më konkrete e më efikase, të forcohen institucionet e zbatimi i ligjit dhe të sigurohen burime financiare shtesë.

Përparimi i integritetit të Objektivave të Mijëvjeçarit në strategjitë e zhvillimit është mjaft i dukshëm. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social, që përcakton drejtimit themelore të zhvillimit të vendit për një periudhë afatmesme, merr parasysh synimet dhe treguesit afatgjatë të këtyre Objektivave. Kohët e fundit, kjo është pasqyruar kënaqshëm edhe në Matricën e Programit të Veprimeve Prioritare Afatmesme, ku përcaktohen edhe tregues sasiore, që krijojnë mundësinë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të zotimit të vendimmarrësve për zbatimin e masave të parashikuara. Tregues sasiore kanë filluar të përzgjidhen edhe për çdo sektor, duke i integruar në strategjitë sektoriale që janë hartuar. Të gjitha këto masa janë në harmoni dhe po kombinohen me treguesit e reformave që po ndërmerren në kuadrin e procesit të Stabilizim-Asociimit, i cili konsiderohet si një objektiv mjaft i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Megjithatë, duke e vlerësuar si themelor rolin e kë-

tyre strategjive dhe reformave në përparimin e përgjithshëm të vendit, përvoja po dëshmon se ky përparim është i pabarabartë në nivel lokal. Një dukuri e tillë ka ndikim të qartë në ngadalësimin e ritmeve të përmbushjes së Objektivave të Mijëvjeçarit. Që kjo gjendje të fillojë të ndryshojë, është e nevojshme të nxiten veprime të posaçme lokale, që synojnë mobilizimin dhe përqendrimin e potencialit ekonomik e njerëzor në ato drejtime ku prapambetja është më e madhe. Këtu e ka filluesin edhe ideja e zbrërthimit të mëtejshëm të synimeve e treguesve të Objektivave të Mijëvjeçarit në nivele më të ulëta se niveli kombëtar.

Nevoja e këtij zbrërthimi u pohua dhe u përforcua më tej gjatë debateve të gjera e mjaft të frytshme në kuadrin e turneut rajonal të Objektivave të Mijëvjeçarit. Pothuajse të gjithë përfaqësuesit e aktorëve vendorë të zhvillimit paraqiten argumente mbi mundësinë e realizimit të kësaj ideje, duke shprehur edhe zotimin e plotë të kapaciteteve njerëzore vendore për ta zbatuar atë.

**Qarku i Elbasanit, i mbështetur nga sistemi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, e ndërmoi i pari nismen pilote për të përgatitur një dokument strategjik mbi rrugën në të cilën duhet të zhvillohet qarku në mënyrë që të përmbushë Objektivat e Mijëvjeçarit. Objektiv i kryesor i kësaj nisme ishte lokalizimi në nivel qarku i synimeve dhe treguesve të Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin dhe verifikimi i mundësise së shndërrimit të tyre në instrumente nxitëse të zhvillimit të gjithanshëm rajonal dhe të mobilizimit të burimeve ekonomike e njerëzore në funksion të këtij zhvillimi.**

Përgatitja e këtij dokumenti është bërë nëpërmjet përfshirjes së gjerë të të gjithë aktorëve vendorë. Procesi është drejtuar prej një grupi qendror, të përbërë nga përfaqësues të pushtetit vendor dhe të strukturave të pushtetit qendror që veprojnë në nivel lokal, të organizatave të shoqërisë civile, të instituteve shkencore të qarkut dhe të Universitetit “Aleksander Xhuvani” të Elbasanit. Ky grup, i mbështetur në debatin e gjerë të zhvilluar në shkallë qarku mbi raportin



“Shqipëria dhe Objektivat e Mijëvjeçarit” si dhe në vlerësimin e treguesve të zhvillimit të qarkut, të rretheve përbërës të tij, të bashkive dhe të komunave, përzgjedhi edhe çështjet më themelore, ku duhen fokusuar analizat dhe ndërhyrjet në qarkun e Elbasanit për përmbushjen e Objektivave. Zbutja e varfërisë, shtimi i mundësive për shkollim, nxitja e barazisë gjinore, përkujdesja për shëndetin e nënës e fëmijës dhe sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm, ishin pesë drejtimet e përzgjedhura.

Specialistë të secilës fushë nga administratat vendore të qarkut, të bashkive dhe komunave, nga drejtoritë rajonale që administrojnë përgjegjësitë e pushtetit qendror në nivel lokal, nga Organizata Jofitimprurëse të specializuara vendore, nga fakultetet e universitetit dhe nga sektori privat, të grupuar sipas problematikës së përzgjedhur, u përfshinë në përgatitjen e bazës së të dhënave, në analizat specifike dhe në përcaktimin e orientimeve mbi përparësitë e zhvillimit që lidhen me Objektivat e Mijëvjeçarit.

Materialet e përgatitura nga secili grup iu nënshtruan debateve në tryeza të rumbullakta, me pjesëmarrje të gjerë specialistësh sipas fushave përkatëse. Kjo ndihmoi vështrimin realist të gjendjes dhe të prioritetëve të përzgjedhura, si dhe përcaktimin e potencialeve të qarkut për t’i zbatuar këto përparësi. Këto debate ishin veçanërisht të frytshme për përcaktimin e synimeve dhe treguesve të përshtatshëm vendorë për secilin nga Objektivat e Mijëvjeçarit.

Konkluzionet e këtyre takimeve për çdo fushë u vunë në qendër të disa debateve të hapura televizive, me pjesëmarrje të specialistëve dhe të publikut, i cili, nëpërmjet medias lokale, ishte vënë në dijeni në mënyrë të vazhdueshme për çdo veprimtari të realizuar në kuadrin e përgatitjes së këtij dokumenti strategjik.

Ky proces u mbështet nga të gjitha Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, të cilat ndihmuan me ekspertizë sipas përkatësisë së çështjeve që u trajtuan. Programi i Zhvillimit i Kombeve të

Bashkuara (UNDP) dhe mbështetjen kryesore, duke vënë në dispozicion të procesit edhe ekspertizën e projekteve që financohen prej tij në të gjithë Shqipërinë, të shoqëruar me trainime për administratën vendore dhe për aktorë të tjerë të interesit.

Në këtë mënyrë, përgatitja e këtij dokumenti strategjik shërbeu edhe si një proces njohjeje të thellë në nivel vendor të Objektivave të Mijëvjeçarit, ngritjeje kapacitetesh në administratat dhe në strukturat e zgjedhura vendore, pjesëmarrjeje të publikut dhe medias në diskutimin e mundësive reale për përmbushjen e objektivave dhe debati për masat, që duhen marrë me përparësi në qarkun e Elbasanit, për të zgjidhur problemet më kryesore dhe përshpejtuar progresin.

Të dhënat, analizat, mendimet, konkluzionet dhe rekomandimet e shohitura nëpërmjet këtij procesi pjesëmarrjeje u përfshinë në këtë raport, i cili synon të vendosë bazat e programimit për zhvillimin lokal, të fokusuar në ato sektorë që lidhen drejtpërdrejt me Objektivat e Mijëvjeçarit. Për të shmangur trajtesat e gjera e të përgjithshme, janë përzgjedhur vetëm ato çështje, ndikimi i të cilave është mbizotërues për secilin sektor dhe që mund të përshpejtojë ritmet e përmbushjes së objektivave.

Kështu, zbutja e varfërisë është konsideruar si një nga çështjet më të rëndësishme për qarkun e Elbasanit. Profili i varfërisë është analizuar veçmas për zonën urbane dhe rurale. Në zonën urbane, punësimi, nëpërmjet zgjerimit të biznesit privat dhe përshatjes me tregun e punës, është veçuar si kushti themelor për zbutjen e varfërisë, duke qenë se papunësia reale është mjaft e lartë, e ndikuar edhe nga falimentimi i industrisë gjatë periudhës së tranzicionit. Në zonën rurale, rritja e prodhimit nga fermat dhe ndryshimi i strukturës së prodhimit të tyre janë veçuar si rrugët më kryesore për të rritur të ardhurat. Shtimi i mundësive për shkollim është fokusuar në analizën e treguesve më kryesorë të arsimit bazë, duke veçuar rëndësinë e rritjes së aksesit real të nxënësve, shpërndarjes optimale të infrastrukturave dhe burimeve njerëzore, si dhe vendosjen e disa standardeve në arsim. Nxitja e barazisë gjinore është trajtuar

nëpërmjet analizës së nivelit të arsimimit, punësimit dhe përfshirjes së femrave në jetën politike e shoqërore në nivel lokal, duke analizuar në veçanti kontributin e femrave në sektorin e arsimit dhe në strukturat vendimmarrëse vendore të të gjitha niveleve, në përfaqësimin e tyre në organet drejtuese lokale të partive politike dhe në përfshirjen e tyre në organizatat jofitimprurëse. Përkujdesja për shëndetin e nënës dhe fëmijës është mbështetur në analizën e vdekshmërisë foshnjore dhe amësore dhe të mundësisë për të pasur shërbime shëndetësore bazë, duke vënë theksin në domosdoshmërinë e rritjes së aksesit ndaj shërbimit shëndetësor në fshat.

Sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm është konsideruar, gjithashtu, si një çështje mjaft prioritare për qarkun e Elbasanit, në të cilin janë përqendruar pasoja të mëdha dhe ende të pastudjuara si duhet nga ndotjet industriale të mëparshme. Theksi është vënë në ndotjen e tokës dhe të ujrave, në depozitimet e shkarkimeve industriale si një burim i vazhdueshëm ndotjeje, në burimet e sotme ndotëse të kësaj zone dhe në hedhurinat e gurta urbane. Pyjet dhe mundësitë e furnizimit të popullsisë me ujë të pijshëm, janë përfshirë në çështjet e rëndësishme, që kërkojnë ndërhyrje me përparësi. Frenimi i degradimit të pyjeve dhe rehabilitimi i pyjeve ekzistuese, përmirësimi rrënjësor i menaxhimit të zonave të mbrojtura, si dhe dhënia përparësi e investimeve për sigurimin e ujit të pijshëm në fshatrat ku pothuajse asnjë familje nuk furnizohet me ujë, janë drejtimet më kryesore ku duhet të ndërhyhet.

Për të gjitha këto çështje janë përcaktuar edhe tregues sasiore si dhe parashikime të vlerave të tyre për periudha afatmesme dhe, aty ku ka qenë e mundur, afatgjata. Parashikimet dhe masat prioritare për arritjen e tyre janë mbështetur në mendimin e ekspertëve lokalë të secilit sektor dhe në objektivat e prioritetit afatmesme dhe afatgjata të përcaktuara në shkallë vendi në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social dhe në strategjitë sektoriale të përgatitura nga disa ministri të linjës, sipas një skenari realist sidomos të mundësive dhe kontributeve lokale.

Lidhja e ngushtë dhe varësia e ndërsjellë midis Objektivave të Mijëveçarit për Zhvillimin është një tipar shumë i dukshëm i këtij raporti. Pothuajse të gjitha çështjet e trajtuara në këtë dokument ndërthuren me njera tjetrën. Punësimi për zbutjen e varfërisë lidhet ngushte me arsimin dhe formimin profesional, çështjet gjinore lidhen me punësimin, mundësinë për shkollim dhe mbrojtjen e shëndetit, vdekshmëria foshnjore është e lidhur me kushtet sociale dhe ekonomike të familjeve dhe me nivelin kulturor të tyre, problemet e trajtuara për mbrojtjen e mjedisit lidhen edhe me shëndetin, me rritjen e të ardhurave nga bujqësia dhe me punësimin. Përmirësimi i gjendjes së pyjeve dhe të zonave të mbrojtura nuk është vetëm një problem i madh mjedisor por është edhe një problem i rëndësishëm punësimi, të ardhurash për fermerët dhe të ardhurash nga zhvillimi i agroturizmit.

Një qasje e tillë për analizën e Objektivave të Mijëveçarit është e domosdoshme dhe veçanërisht e mundshme, kur këto objektiva zërthehen në nivel lokal. Në këtë rast shumë ndërhyrje prioritare mund të bëhen të kombinuara, duke shpenzuar më pak kohë dhe financime. Shembulli i kombinimit të investimeve për rehabilitimin ose ngritjen e shkollave të fshatrave me ato të ambulancave dhe qendrave shëndetësore nëpërmjet njësimi të studimeve midis dy sektorëve, arsimit dhe shëndetësisë, mund të jetë më tipiku për rritjen e frytshmërisë së ndërhyrjeve.

Mbështetur në këtë dokument strategjik, strukturat e pushtetit vendor të qarkut të Elbasanit kanë përcaktuar disa drejtime prioritare të zhvillimit të sektorëve më të rëndësishëm, që lidhen me Objektivat e Mijëveçarit për Zhvillimin, si dhe janë në fazën e parë të shndrrimit të tyre në projekte konkrete. Në këtë mënyrë, ky dokument është një bazë e mirë nisjeje drejt identifikimit të projekteve prioritare, formulimit të projekteve dhe përpjekjeve për sigurimin e financimeve, në radhë të parë nga burimet e brendshme. Një proces i tillë merr rëndësi të madhe veçanërisht tani që ka një anagazhim të dukshëm për progresin e shpejtë të reformës së decentralizimit fiskal.

## niveli i varfërisë dhe të ardhurat

brenda vitit 2015 i përafshirë në ditë është shtuar nga 10 në nivel kaq të ulët që të objektive të kësaj, kuadrit linjave të publikut etj. vitin 2015 është e

<sup>2</sup> UNDP (HDPC). “Shqipëria dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit”, Tiranë, maj 2002. Nivelet e përdorura për vlerësimin e mundësisë së përbushjes së objektivit janë “Mundet”, “Mbase”, “Vështirë” dhe “S’ka të dhëna”. Nivelet e përdorura për vlerësimin e shkallës së mbështetjes së mjedisit janë “E plotë”, “Normale”, “E dobët në përmirësim” dhe “E dobët”.

## 1.1 Tipare demografike

Qarku i Elbasanit renditet i treti në vend për numrin e popullsisë, pas qarkut të Tiranës e Fierit, dhe i treti, pas qarkut të Korçës e Shkodrës, për nga sipërfaqja e tij. Popullsia e qarkut është rreth 366 mijë banorë, e përhapur në 4 rrethe, 7 qytete, 43 komuna dhe 397 fshatra. Rrethi i Elbasanit është rrethi më i madh i qarkut, me popullsi mbi 20% më të madhe se popullsia e tre rretheve të tjera së bashku. Gjatë periudhës së tranzicionit qarku ka pësuar këto ndryshime thelbësore demografike:

Fig. 1.1 Popullsia sipas rretheve





Fig. 1.2 Popullsia në qytet dhe në fshat



- Popullsia e përgjithshme e qarkut pothuajse nuk ka ndryshuar, me gjithë lëvizjen e madhe migratore të popullsisë (shih tabelën 1.1). Emigrimi jashtë shtetit dhe migrimi drejt Tiranës përbëjnë një dukuri të rëndësishme të lëvizjes së popullsisë në dhjetëvjeçarin e fundit, që ka sjellë si përfundim largimin e një pjese të popullsisë nga qarku i Elbasanit. Shpërngulja nga zona rurale drejt qyteteve dhe nga qytetet e vogla drejt qytetit të Elbasanit, si dhe ardhjet nga qarqet e tjera përbëjnë një dukuri tjetër kryesore që ka sjellë rritjen e popullsisë së qarkut nga të ardhurit. Si rezultat i një balancimi të vetvetishëm të këtyre lëvizjeve, numri i përgjithshëm i popullsisë së qarkut është pothuajse ai i fundit të viteve '80 (shih tabelën 1.2). Ndryshimet e popullsisë në nivel rrethesh në përgjithësi janë të vogla. Megjithatë, vihet re një rritje e vogël e popullsisë së rrethit të Elbasanit e Peqinit, dhe zvogëlim i dukshëm i popullsisë së rrethit të Gramshit, gjë që përputhet me prirjet migratore, që kanë si bazë arsytet ekonomike.
- Dendësia e popullsisë, megjithëse në nivel qarku ka mbetur pothuajse e pandryshuar, është rritur veçanërisht në rrethin e Peqinit dhe të Elbasanit. Rrethi i Peqinit renditet i katërti në vend për nga dendësia e popullsisë me rreth 303 banorë për km<sup>2</sup>. Ulja e dendësisë është e ndjeshme në rrethin e Gramshit.

**Tabela 1.1 Popullsia sipas rretheve në vitin 2001**

Rrethi	Popullsia gjithsej	Urbane		Rurale		Banorë për km <sup>2</sup>
		Gjithsej	Popullsia aktive	Gjithsej	Popullsia aktive	
Elbasan	224,974	97,224	47,827	127,750	57,967	161.5
Gramsh	35,723	10,477	5,324	25,246	10,292	51.5
Librazhd	72,520	11,520	6,969	61,000	26,004	70.7
Peqin	32,920	7,242	3,199	25,678	11,640	303.3
<b>Qarku</b>	<b>366,137</b>	<b>126,463</b>	<b>62,198</b>	<b>239,674</b>	<b>105,903</b>	<b>113.4</b>

Burimi: Repoba 2001

- Në qarkun e Elbasanit aktualisht mbizotëron popullsia fshatare, e cila përfaqëson rreth 65% të popullsisë gjithsej, kundrejt 69% që ishte në vitin 1989. Pjesën e popullsisë rurale e ka më të ulët rrethi i Elbasanit, afër 56%. Në rrethet Librazhd dhe Gramsh popullsia rurale përfaqëson përkatësisht 84% dhe 70% të popullsisë gjithsej të tyre, kundrejt 87% dhe 81% që ka qenë në vitin 1989. Këto ndryshime përputhen me prirjen e përgjithshme në nivel vendi të rritjes së shkallës së urbanizimit, që është shprehur qartë në zvogëlimin nga 63% në 57% të pjesës së popullsisë që banon në fshat.

**Tabela 1.2 Popullsia sipas rretheve në vitin 1989**

Rrethi	Popullsia në vitin 1989	Banorë për km <sup>2</sup> 1989
Elbasan	211,948	154.48
Gramsh	43,565	62.6
Librazhd	71,982	70.3
Peqin	30,002	275.2
<b>Gjithsej</b>	<b>357,497</b>	<b>111.7</b>

Burimi: Instat, Vjetari Statistikor 1991

## 1.2 Tregu i punës

Popullsia aktive e qarkut aktualisht zë rreth 45% të popullsisë gjithsej. E ndikuar nga emigrimi dhe shpërnguljet, popullsia aktive është rritur ndjeshëm në rrethin e Elbasanit dhe të Peqinit, në krahasim me vitin 1989, dhe rritja më e ndjeshme vihet re në popullsinë e moshave 35 deri 55 vjeç. Në rrethin e Gramshit popullsia aktive është zvogëluar dhe kjo lidhet me zvogëlimin e popullsisë së këtij rrethi.

Pjesa më e madhe e forcave të punës së qarkut, rreth 63%, është e zënë në bujqësi. Në rrethin e Peqinit dhe Librazhdit, ky është sektori mbizotërues i punësimit, me përkatësisht 79% dhe 76% të forcave të punës. Në rrethin e Elbasanit, pjesa e popullsisë e zënë në sektorin e bujqësisë është shumë më e vogël, rreth 56%, për shkak të një shkalle më të lartë urbanizimi në krahasim me rrethet e tjera të qarkut.

<sup>3</sup> Në vitin 1989 Peqini ka qenë i përfshirë në rrethin e Elbasanit.

Pjesa tjetër e forcave të punës është e zënë në sektorë të tjerë, me shumicë në sektorin e arsimit dhe industrisë. Në sektorin e arsimit në secilin rreth janë punësuar 3-5% të forcave aktive të punës. Në sektorin e industrisë ky tregues është më i lartë në rrethin e Elbasanit, afër 5%, i ndikuar nga prania e një zone të rëndësishme e të përqendruar industriale.

Fig 1.3 Punësimi sipas sektorëve në qarkun e Elbasanit




Fig. 1.4 Punësimi sipas sektorëve në rrethin e Elbasanit




Fig 1.5 Punësimi sipas sektorëve në rrethin e Gramshit




Fig 1.6 Punësimi sipas sektorëve në rrethin e Peqinit





Fig 1.6 Punësimi sipas sektorëve në rrethin e Librazhdit



**Tabela 1.3 Treguesit kryesorë të tregut të punës**

	Elbasan	Gramsh	Librazhd	Peqin	Qarku	Vendi
<b>Forca e punës (000)</b>	105.8	15.6	32.9	14.8	168.1	1,347.3
<b>Punësimi (000)</b>	81.9	12.8	26.2	12.5	133.5	1,041.8
<b>Papunësia %</b>	22.6	17.9	20.4	15.5	20.6	22.7

Burimi: HDPC mbështetur në të dhënat e Repoba 2001

Shkalla e papunësisë, si në nivel vendi ashtu edhe në nivel rajonal, llogaritet në bazë të të dhënave administrative për numrin e të papunëve, të cilat marrin për bazë punëkërkesit e papunë të regjistruar në zyrat e punës, dhe popullsinë e përgjithshme aktive, e cila përfshin zonën urbane dhe rurale. Sipas kësaj metodike, shkalla e papunësisë në qarkun e Elbasanit del rreth 11%, pra më e ulët se vlera mesatare e këtij treguesi në nivel vendi.

Në fakt, në bazë të të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2001, numri i të papunëve del më i lartë se ai sipas të dhënave administrative, gjë që tregon se jo të gjithë të papunët i drejtohen administratës shtetërore për të kërkuar ndihmë që të punësohen. Në bazë të këtyre të dhënave, papunësia në qarkun e Elbasanit, del të jetë rreth 20.6% e popullsisë aktive<sup>4</sup> dhe vlera më e lartë, rreth 22.6% i përket rrethit të Elbasanit, ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (shih tabelën 1.3). Ky tregues është pak më i ulët se mesatarja e vendit, si për qarkun ashtu edhe për secilin nga rrethet që e përbëjnë.

### **Papunësia sipas të dhënave administrative**

Në shkallë vendi, gjatë periudhës 1990-1993 është regjistruar një rritje e madhe e papunësisë, deri në rreth 470 mijë të papunë, si pasojë e mbylljes, ristrukturimit apo privatizimit të shumicës së ndërmarrjeve industriale. Mbas vitit 1993 papunësia u ul gradualisht deri në rreth 160 mijë të papunë. Këtu ndikoi dalja nga skema e papunësisë e popullsisë fshatare, që perfitoi nga ligji i ndarjes së tokës, emigrimi dhe fillimi i përshtatjes së të papunëve me tregun e ri të punës. Në periudhën 1997-1998 niveli i papunësisë përsëri u rrit deri në 235 mijë veta, pas kolapsit të përgjithshëm nga mbyllja e firmave piramidale dhe në nivel vendi arriti deri në 16.6% të forcave aktive. Më pas filloi zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit dhe në fund të vitit 2001 shkalla e papunësisë ka zbritur në 13.5% të forcave aktive, aq sa është edhe sot.<sup>5</sup>

<sup>4</sup> Popullsia aktive në këtë rast nënkupton popullsinë aktive të zonës rurale dhe urbane të marra së bashku.

<sup>5</sup> Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Strategjia e punësimit dhe formimit profesional.

### 1.3 Punësimi në zonën urbane

Profili i varfërisë në zonën urbane të qarkut të Elbasanit është mjaft i ndryshëm nga ai i zonës rurale. Karakteristikat e tregut të punës janë, gjithashtu, të ndryshme. Papunësia ka një kuptim shumë më të drejtpërdrejtë në zonën urbane sesa në zonën rurale. Prandaj, është quajtur më efektive dhe më realiste që analiza e nivelit të varfërisë dhe e rrugëve për zbutjen e saj të jetë e ndarë për secilën zonë. **Për zonën urbane, kushti themelor për zbutjen e varfërisë është punësimi.**

#### Pasoja të tranzicionit

Deri në vitin 1990, qarku i Elbasanit konsiderohej si një rajon i rëndësishëm industrial, ku mbizotëronin industria metalurgjike, e prodhimit të çimentos dhe industria mekanike në rrethin e Elbasanit, industria e nxjerrjes dhe pasurimit të hekur-nikelit dhe kromit në rrethin e Librazhdit dhe industria mekanike në rrethin e Gramshit.

Ndërmarrjet më të mëdha ishin të përqendruara në rrethin e Elbasanit, ku, për më se dy dhjetëvjeçarë, u transferuan të banojnë njerëz nga i gjithë vendi, për të përballuar nevojat e mëdha për fuqi punëtore e specialistë të industrisë së ngritur. Kjo lëvizje e drejtuar e popullsisë jo vetëm rriti ndjeshëm numrin e banorëve të këtij rrethi, por rriti veçanërisht pjesën e popullsisë aktive. Në fund të vitit 1990, në dhjetë ndërmarrjet kryesore të këtij rrethi ishin të punësuar rreth 24,000 punonjës (shih tabelën 1.4), të cilët përfaqësonin rreth 40% të numrit të punonjësve të sektorit shtetëror të rrethit<sup>6</sup>.

Pas vitit 1990, shumica e ndërmarrjeve industriale ekzistuese nuk mundën të mbijetonin, për shkak të teknologjive të vjetruara, efektivitetit mjaft të ulët dhe konkurrencës së lartë të produkteve të importuara. Ato ndërprejnë punën dhe u përfshinë në procesin e ristrukturimit apo privatizimit, por vetëm një pjesë e vogël e tyre e rifilloi punën dhe me kapacitete prodhimi mjaft të reduktuara, duke bërë njëkohësisht shkurtime drastike të punonjësve. Kështu, në dhjetë ndërmarrjet kryesore të vitit 1990, aktualisht janë mbajtur në punë vetëm 9% e numrit të mëparshëm të punonjësve, të cilat përfaqësojnë vetëm rreth 4% të forcave të punës në vitin 2003 (shih tabelën 1.4).


**Tabela 1.4 Punësimi në 10 ndërmarrjet kryesore të Elbasanit**

Ndërmarrja	Numri i punonjësve		Emri i sotëm
	1990	2003	
Kombinati Metalurgjik	11,223	1,335	KURUM (private)
Kombinati i drurit	1,862	93	ITALDRURI (private)
Fabrika e duhanit	1,200	42	Fabrika e duhanit (private)
Uzina e ferrokromit	585	145	DARFO (private)
Rruga-ura	1,253	20	Sh.a. Rruga (shtetërore)
Fabrika e çimentos	821	374	ECF (private)
Uzina Mekanike	648	109	Uzina mekanike (private)
NP Veshje	1,447	157	Disa reparte private
NSHN	2,884	-	-
HC Banjë	1,749	-	-
<b>Shuma</b>	<b>23,672</b>	<b>2,275</b>	

<sup>6</sup> Në evidencën e numrit të punonjësve të rrethit të Elbasanit të vitit 1990 figurojnë 59,706 punonjës.



Fig 1.8 Punësimi në ndërmarrjet kryesore të qarkut të Elbasanit



ishin të punësuar 940 punonjës, nga të cilët sot punojnë në to vetëm rreth 110 punonjës. Kështu që në nivel qarku vetëm nga ndërmarrjet më kryesore u nxorën nga puna rreth 92% e punonjësve të punësuar para vitit 1990, apo rreth 25,000 punonjës. Nga ky këndvështrim, qarku i Elbasanit në përgjithësi dhe rrethi i Elbasanit në veçanti, mund të renditen midis rajoneve me pasoja më të rënda nga reformat e tranzicionit.

Aktualisht në qytetet kryesore dalin të punësuar rreth 35,000 punonjës, të cilët përfaqësojnë 63.6 % të popullsisë aktive (shih tabelën 1.5). Rreth 2/3 e tyre janë të punësuar në punë të përhershme, që do të thotë se në 4 qytetet kryesore të qarkut vetëm 46.5 % e popullsisë aktive është e punësuar në një punë të përhershme (shih tabelën 1.6). Pjesa tjetër është e punësuar në punë të përkohshme, sezonale, të rastit ose është e papunë.

Tabela 1.5 Treguesit e punësimit në qytetet kryesore

Qyteti	Popullsia aktive	Të punësuar	Të papunë	Shkalla e papunësisë në qytet %
Elbasan	43,138	26,905	16,233	37.6
Librazhd	3,619	2,555	1,064	29.4
Peqin	3,199	2,064	1,135	35.5
Gramsh	5,324	3,426	1,898	35.6

Burimi: Repoba 2001

Tabela 1.6 Lloji i punësimit

Qyteti	Të punësuar gjithsej	Nga këto, në punë			
		të përhershme	të përkohshme	sezonale	të rastit
Elbasan	26,905	19,517	3,972	2,194	1,222
Librazhd	2,555	2,043	300	150	62
Peqin	2,064	1,561	269	157	77
Gramsh	3,426	2,576	451	283	116

Burimi: Repoba 2001

## Papunësia

Sipas të dhënave administrative të drejtorisë rajonale të punësimit, në fund të muajit shkurt 2003, në qytetet kryesore të qarkut të Elbasanit dolën të regjistruar 18,263 *punëkërkuës të papunë*, nga të cilët rreth 52% te moshës 20 deri 34 vjeç dhe rreth 44% me arsim të mesëm të përgjithshëm e profesional (shih tabelën 1.7). Numri më i madh i tyre është në qytetin e Elbasanit, si qyteti me popullsi më të madhe në qarkun e Elbasanit. Në realitet, vetëm në qytetet kryesore të qarkut numri i të papunëve sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2001 rezulton të jetë 23,550. Kështu që, shkalla reale e papunësisë në 6 qytetet kryesore të qarkut është rreth 37%, me vlera shumë të larta në qytetin e Cërrikut dhe të Elbasanit (shih tabelën 1.5)

Fig 1.9 Të papunët sipas qyteteve kryesore




Tabela 1.7 Punëkërkuës të papunë të regjistruar

Rrethi	Gjithsej	Sipas grupmoshave					Sipas nivelit arsimor			
		15-19	20-24	25-34	mbi 34	8vjeçar	i mesëm	Profesional	i lartë	
Elbasan	13,131	340	2,520	4,604	5,667	7,706	3,766	1,623	36	
Gramsh	2,876	50	370	1,070	1,377	1,322	830	675	49	
Librazhd	947	111	81	316	436	355	432	135	22	
Peqin	1,309	167	398	282	475	581	408	330	3	
<b>Qarku</b>	<b>18,263</b>	<b>668</b>	<b>3,369</b>	<b>6,272</b>	<b>7,955</b>	<b>9,964</b>	<b>5,436</b>	<b>2,763</b>	<b>110</b>	

Burimi: Drejtoria Rajonale e Punësimit

Analiza e të papunëve të regjistruar në zyrat e punësimit sipas grupmoshave tregon se të rinjtë e grupmoshës 15-24 vjeç përbëjnë vetëm 25% të totalit të punëkërkuësve të papunë të regjistruar (shih tabelën 1.7). Këta janë kryesisht të rinj që mbarojnë shkollat 8-vjeçare ose të mesme dhe kanë nevojë për këshillim dhe informim nga zyrat e punësimit. Kjo kategori përpiket të përshtatet me tregun e punës kryesisht nëpërmjet përfshirjes në kurset e formimit profesional publike apo private. Numrin më të madh të punëkërkuësve të papunë të regjistruar, rreth 43%, e zënë ata të grupmoshave 35 vjeç e lart. Kjo është grupmosha që ka interesin më të madh për punë. Ata zënë mesatarisht çdo muaj 37% të totalit të punësimeve.

Në strukturën e të papunëve sipas nivelit arsimor (shih tabelën 1.7), vendin kryesor, rreth 50%, e zënë punëkërkuësit e papunë të regjistruar me arsim fillor e tetëvjeçar. Ky grup

është edhe kontingjenti më i pakualifikuar. Punëkërkuessit me arsim të mesëm profesional përbëjnë 17% të numrit të përgjithshëm të punëkërkuessve. Ky grup zë përqindjen më të lartë të punësimit çdo muaj. Punëkërkuessit e papunë me arsim të lartë zënë një përqindje të papërfillshme, vetëm 1.6% të punëkërkuessve.

Struktura e punëkërkuessve të papunë sipas kohës që qëndrojnë të regjistruar pranë zyrave të punësimit, dëshmon për mbizotërimin absolut të të papunëve afatgjatë dhe të tillë konsiderohen ata që figurojnë të regjistruar pranë zyrës së punësimit prej më shumë se një vit. Këta përbëjnë rreth 70% të totalit të punëkërkuessve të papunë dhe shumicën e tyre e përbëjnë të papunët e moshës mbi 45 vjeç, të cilët paraqesin vështirësitë më të mëdha në punësim, për shkak se nuk kanë profesionin apo formimin e duhur për t’iu përgjigjur kërkesave të reja të tregut të punës.

### Përshtatja me tregun e punës

Niveli i përshtatjes së forcave të punës me tregun e punës në përgjithësi është i ulët. Këtu ndikon fakti se kualifikimi i forcave të punës të moshës mbi 35 vjeç nuk u përgjigjet siç duhet kërkesave të reja të biznesit, veçanërisht për disa profesione “të reja”. Kjo duket qartë nga struktura e kurseve të autorizuara të formimit profesional në secilin rreth (tabela 1.8).

### 1.8 Kurset e formimit profesional

Kurset	Lloji i qendrave	Shpërndarja sipas rretheve			
		Elbasan	Gramsh	Librazhd	Peqin
Automekanik	Shkolla profesionale	+			
Elektrik	Shkolla profesionale	+			
Gjuhë e huaj	Qendra publike, private, OJF	+	+	+	+
Hidraulik	Shkolla profesionale	+			
Kompjuter	Qendra publike, private, OJF	+	+	+	
Mekanik	Shkolla profesionale, qendra private, OJF	+			
Murator	Shkolla profesionale	+			
Parukeri	Qendra publike, private, OJF	+	+	+	+
Rrobaqepësi	Shkolla profesionale, qendra publike, private, OJF	+	+		
Sekretari	Qendra publike	+	+		
Zdrukhtari	Shkolla profesionale	+			
Infermier	Shkolla profesionale	+			

Në rrethin e Elbasanit mungojnë kurse për trajnime në fusha të tilla si hoteleri, bar-restorant, elektroauto, riparim radio-tv, riparim pajisje elektrike, saldator, termohidraulik, kuzhinier, përpunim duralumini, që përfaqësojnë profesione të kërkuara nga biznesi lokal. Në rrethet e tjera numri i kurseve është shumë më i kufizuar dhe mundësitë për kualifikim janë të pakta.

Prandaj zgjerimi i rrjetit të sistemit të formimit profesional në qytetin e Elbasanit në disa profesione të kërkuara dhe shtrirja edhe në rrethet e tjera konsiderohen si masa përparësore për një përshtatje më të mirë të forcave të punës me kërkesat e tregut të punës, gjë që do të

ketë ndikime të dukshme në rritjen e shkallës së punësimit. Nëpërmjet këtyre masave parashikohet që të krijohen mundësi për formimin profesional të rreth 1600 të papunëve në rreth 23 profesione, të cilat konsiderohen si nevojat përparësore për qarkun e Elbasanit për periudhën 2003-2005<sup>7</sup>.

Në strategjinë e punësimit dhe formimit profesional parashikohet rikonstruksioni i qendrës ekzistuese të formimit profesional në qytetin e Elbasanit. Sipas kësaj strategjie, synohet mbështetja me kapacitetet e nevojshme trajnuese për disa degë me përparësi: (i) turizëm-me profesione të tilla si agjentë të agjencive turistike, kuzhinierë, kameriere, recepsioniste, punonjës ndihmës etj. (ii) shërbime-kurse për etikën e shërbimeve, (iii) agrobiznes dhe agroturizëm, për formimin e specialistëve për përpunimin e produkteve dhe nënprodukteve bujqësore e blegtorale si dhe të bimëve mjekësore, (iv) ndërtim-për kualifikimin e fuqisë punëtore në funksion të teknologjive të reja të ndërtimit do të ofrohen kurse për ndërtim, për sistemet qendrore të ngrohjes e ftohjes, elektrikist i impianteve të ndërtimit, punim duralumini, hidraulik-hidrosanitar etj. (v) punë artizanale e dorës-kurse për qëndistari, përpunim argjendi, përpunim hekuri, bakri, druri, leshi, gurpunues etj.

### Ndihma ekonomike

Në zonën urbane të qarkut të Elbasanit përfitojnë ndihmë ekonomike (NE) rreth 25 mijë veta dhe e ardhura mesatare mujore e tyre nga kjo ndihmë është rreth 610 lekë (shih tabelën 1.9). Nisur nga kriteret e përcaktuara me ligj për përfituesit e NE, mund të konsiderohet se në shkallë qarku në zonën urbane rreth 25 mijë veta kanë të ardhura më të vogla se 1\$ US në ditë. Këta përfaqësojnë rreth 19.9% të popullsisë urbane të qarkut.

**Tabela 1.9: Ndihma ekonomike në zonat urbane**

Qyteti	Popullsia gjithsej	Pjesa e popullsisë me NE (%)	Të ardhurat mesatare për frymë në muaj nga NE (lekë)	Të ardhurat mesatare për frymë në ditë nga NE (\$ US) <sup>8</sup>
Elbasan	87,797	18.7	612.5	0.16
Cërrik	9,427	23.3	643.5	0.17
Peqin	7,242	23.3	577.5	0.15
Gramsh	10,477	21.4	631.8	0.16
Librazhd	7,216	7.5	612.4	0.16
Përrenjas	4,304	18.1	572.6	0.15
<b>Gjithsej</b>	<b>126,463</b>	<b>19.9</b>	<b>608.4</b>	<b>0.156</b>

<sup>7</sup> Sipas të dhënave të Strategjisë së punësimit dhe formimit profesional, Tiranë maj 2003.

<sup>8</sup> Kursi i këmbimit është marrë 1\$ = 125 lekë

Sipas ligjit nr. 7710, datë 18.05.1993, shteti u ofron ndihmë ekonomike familjeve të shtetasve të cilëve u mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht ose i kanë ato të pamjaftueshme. Të tilla konsiderohen familjet që nuk kanë kapital dhe të ardhura e burime materiale jetese nga veprimtaria ekonomike, nga sigurimet shoqërore ose ndonjë sistem tjetër sigurimi. Përfituesit dhe masa e ndihmës ekonomike përcaktohen nga Këshilli i Bashkisë ose i Komunës.

## 1.4 Zbutja e varfërisë në qytete

### Investimet

Gjatë periudhës 1997-2003, në qarkun e Elbasanit janë investuar rreth 125 milion dollarë, me fonde nga buxheti i shtetit, të ardhurat lokale dhe donatorët, nëpërmjet projekteve kombëtare ose të veçanta, apo rreth 49 \$ US për frymë çdo vit (shih tabelën 1.10). Më se gjysma e këtyre fondeve, rreth 54%, janë investuar në rrethin e Elbasanit. Në to nuk përfshihen investimet private, të cilat nuk janë të evidentuara në shkallë rrethi apo qarku.

**Tabela 1.10 Investimet në qarkun e Elbasanit sipas viteve në milion \$US**

Burimi	1997	1998	1999	2000	2001	2001	2003 <sup>9</sup>
Buxheti	1.05	4.73	9.6	10.4	10.7	6.6	4.22
Donatorët	0.15	2.30	7.0	8.6	29.7	20.6	8.4
Gjithsej	2.15	7.03	16.6	19.0	40.4	27.2	12.62

Këto investime janë fokusuar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturave rrugore dhe të furnizimit me ujë e energji elektrike, si dhe në rehabilitimin e shkollave e të objekteve të shërbimit shëndetësor ose ndërtimin e objekteve të reja. Një pjesë e vogël e investimeve është përdorur në bujqësi për rehabilitimin e sistemeve të ujitjes e kullimit dhe për përmirësimin e pyjeve. Investimet kanë ndikuar në përmirësimin e infrastrukturave dhe kanë favorizuar zhvillimin ekonomik të qarkut, duke ndikuar tërthorazi në rritjen e punësimit.

### Roli i biznesit privat

Në qarkun e Elbasanit ushtrojnë aktivitet ekonomik rreth 4,320 subjekte private<sup>10</sup>, shumica e të cilëve, rreth 60%, ndodhen në rrethin e Elbasanit. Rreth 80% e tyre kanë të punësuar vetëm një punonjës, 18% kanë 2 deri në 10 punonjës dhe vetëm rreth 85 ndërmarrje kanë më shumë se 10 punonjës. Rreth 49% e ndërmarrjeve zhvillojnë aktivitet në fushën e tregtisë dhe vetëm rreth 9% në industri. Numri i ndërmarrjeve në 5 vitet e fundit është rritur rreth 21% në shkallë qarku, ndërsa në rrethin e Elbasanit rreth 30%<sup>11</sup>. Si rrjedhim,

<sup>9</sup> Parashikim

<sup>10</sup> Burimi: INSTAT.

<sup>11</sup> Burimi: Zyra e punësimit.

bazën e zhvillimit ekonomik të zonës urbane të qarkut e përfaqësojnë ndërmarrjet e vogla e të mesme, por edhe ndikimi i ndërmarrjeve të mëdha industriale (shih tabelën 1.4) është i ndjeshëm, veçanërisht për rrethin e Elbasanit.

Nxitja e investimeve vendase e të huaja për konsolidimin dhe zgjerimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme ekzistuese dhe për ngritjen e atyre të reja, përbën një objektiv parësor për rritjen e potencialit ekonomik të qarkut dhe punësimin. Për këtë qëllim, krahas masave të parashikuara në strategjitë kombëtare të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe në atë të punësimin, në qarkun e Elbasanit janë bërë përpjekje për të hartuar programe e plane zhvillimi, që favorizojnë rritjen me ritme të shpejta të sektorit privat. Më të rëndësishmet janë plani strategjik për zhvillimin ekonomik të qytetit të Elbasanit, i përgatitur në vitin 2000 dhe Programi për krijimin e klimës së përshtatshme për zhvillimin e biznesit në rrethin e Elbasanit, i përgatitur në vitin 2002<sup>12</sup>.

Plani strategjik i zhvillimit ekonomik të qytetit të Elbasanit parashikon një sërë masash për përmirësimin e mjedisit të biznesit, përshtatjen e fuqisë punëtore me tregun e punës, nxjerrjen në pah dhe vënien në shërbim të investitorëve të mundësive që ofron qyteti për të zhvilluar biznes e investuar, si dhe për përmirësimin e infrastrukturës që ndihmon biznesin. Në vijim, është hartuar dhe ka filluar të zbatohet nga bashkia një program konkret për nxitjen dhe mbështetjen e biznesit. Kjo veprimtari drejtohet nga një komision i përhershëm, që përbëhet nga përfaqësues të pushtetit vendor, të strukturave të pushtetit qendror në nivel lokal, biznesmenë, përfaqësues të bankave, pedagogë të universitetit “Aleksandër Xhuvani” dhe përfaqësues të medias.

Zona industriale e qytetit të Elbasanit përbën një potencial të rëndësishëm zhvillimi, i cili deri tani është shfrytëzuar shumë pak dhe pa një strategji të qartë. Aty ka një numër të madh ndërtesash industriale jashtë funksionit të tyre, të cilat kanë të gjitha infrastrukturën dhe burimet energjitike të nevojshme për çdo lloj aktiviteti prodhues. Ndërkohë, në rrethinat e qytetit vazhdojnë investimet private për ndërtesa të reja, kur ndërtesa të gatshme e në shumë raste shumë më të përshtatshme vazhdojnë të rrinë pa u shfrytëzuar në pronësi të shtetit.

Kthimi i pjesës së pashfrytëzuar të kombinatit metalurgjik në një park industrial është një nga objektivat më prioritarë për zhvillimin ekonomik të qarkut të Elbasanit. Sipas një studimi paraprak të ISP të Metalurgjisë, krijimi i këtij parku lidhet më shumë me marrjen e disa vendimeve politike nga shteti, që kanë të bëjnë me pronësinë e ndërtesave dhe mënyrën e administrimit të tyre, sesa thjesht me nevojën për financime. Nëpërmjet këtij parku industrial krijohen kushte të favorshme për investitorët vendas e të huaj dhe mund të rritet ndjeshëm numri i ndërmarrjeve të vogla e të mesme të qarkut<sup>13</sup>, duke punësuar rreth 1,500 punonjës.

<sup>12</sup> Këto dokumente janë përgatitur nga bashkia e Elbasanit në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zhvillimit.

<sup>13</sup> Sipas ligjit për ndërmarrjet e vogla e të mesme, ndërmarrjet me deri 5 punonjës quhen mikrondërmarrje, me 6-20 punonjës quhen ndërmarrje të vogla dhe me 21 deri 80 punonjës quhen ndërmarrje të mesme.

## Nxitja e punësimit

Gjatë vitit 2002 në qarkun e Elbasanit u punësuan gjithsej 815 veta, nga të cilët rreth 381 veta pa ndërhyrje, 300 veta me anë të ndërmjetësimit nga zyra e punësimit dhe 134 veta nëpërmjet programeve të punësimit (shih tabelën 1.11). Megjithëse numri i të punësuarve është më i larti se në çdo vit tjetër, ritmet e punësimit janë shumë të ulta në krahasim me numrin e të papunëve dhe me këto ritme duhen 25 deri 30 vjet për t'i punësuar ata.

**Tabela 1.11 Parashikimi i punësimit**

	Punësimi në vitin 2002		Parashikimi për vitin 2007	
	Gjithsej vendi	Qarku i Elbasanit	Gjithsej vendi	Qarku i Elbasanit
Nga ndërmjetësimi i zyrave të punësimit dhe/ose pa ndërhyrjen e tyre	7,000	681	11,000	1,200
Nga programet e nxitjes së punësimit	3,000	134	5,000	550
Nga programet e formimit të të rinjve deri 25 vjec	1,000	-	2,000	300
<b>Gjithsej</b>	<b>11,000</b>	<b>815</b>	<b>18,000</b>	<b>2,050</b>

Në Strategjinë e punësimit dhe formimit profesional janë parashikuar ndërhyrje konkrete dhe financime që në vitin 2007 të arrihet të punësohen mesatarisht në shkallë vendi rreth 65% më shumë punonjës se në vitin 2002. Disa nga këto ndërhyrje janë specifike për qarkun e Elbasanit, ku dhe nevojat për punësim janë më të mëdha Si rrjedhim, (i) zbatimi i masave për zgjerimin e biznesit privat dhe nxitjen e investimeve të huaja, (ii) rritja e parashikuar e prodhimit në ndërmarrjet e mëdha industriale ekzistuese, si dhe (iii) marrja e masave për përshtatjen me tregun e punës, të parashikuara nëpërmjet trajnimit profesional, veçanërisht të të rinjve, mund t'i përshpejtojnë këto ritme. Sipas këtij skenari, mund të arrihet që në vitin 2007 të punësohen rreth 2,000 veta, dhe me këto ritme mesatare vjetore, brenda një periudhe 5-7 vjeçare të përgjysmohet numri i të papunëve.

## 1.5 Varfëria në zonën rurale

### Pronësia e tokës

Qarku i Elbasanit zotëron një sipërfaqe tokë të përgjithshme prej 227,581 ha, nga e cila vetëm rreth 32% (rreth 73 mijë ha) është tokë e punueshme. Pjesa tjetër është e mbuluar me pyje e kullota ose është e papërdorshme. Toka u është dhënë në pronësi fshatarëve dhe në shkallë qarku sipërfaqja e tokës për familje në zonën rurale është 1.34 ha (shih tabelën 1.12). Kjo vlerë është më e vogël në rrethin e Elbasanit dhe më e madhe në rrethin e Gramshit. Në 26 komuna të rrethit sipërfaqja e tokës për çdo familje është mesatarisht 1-

2 ha, ndërsa 15 komuna kanë më pak se 1.5 ha për familje. Në 8 komuna sipërfaqja mesatare e tokës është deri 1 ha për familje, midis të cilave 3 komuna kanë më pak se 0.7 ha për familje. Vetëm në 4 komuna kjo sipërfaqe është më e madhe se 3 ha për familje. Për rreth 10,500 ha tokë çështja e pronësisë nuk është e zgjidhur në mënyrë përfundimtare dhe rreth 86% e tokës “me probleme” ndodhet në rrethin e Librazhdit dhe Gramshit. Për secilin nga këto rrethe kjo përfaqëson rreth 30% të tokës së punueshme gjithsej, duke pasur një ndikim shumë të madh negativ në të ardhurat e komunave të këtyre rretheve<sup>14</sup>.

**Tabela 1.12: Sipërfaqja e tokës për familje**

Rrethi	Sipërfaqja mesatare e tokës për familje Në ha	Numri i komunave me			
		Deri 1ha/familje	1-2 ha/familje	2.01-3 ha/familje	Mbi 3 ha/familje
Elbasan	1.23	6	12	1	1
Gramsh	2.01	0	4	3	2
Librazhd	1.24	2	6	0	1
Peqin	1.52	0	4	1	0
Qarku	1.34	8	26	5	4

Rreth 21% e sipërfaqes së tokës së punueshme të qarkut të Elbasanit është në fushë me pjerrësi 0-6%. Kjo shtrihet në periferi të qyteteve dhe përgjatë luginave të lumenjve Shkumbin e Devoll dhe është tokë me taban të thellë, përbërje mekanike të mesme deri në të rëndë dhe me pjellori të mirë. Rreth 54% e sipërfaqes është në kodër me pjerrësi 7-25%. Kjo është me taban mesatar dhe shumica e saj ka qenë e ujitshme por aktualisht sistemet e ujitjes janë jashtë përdorimit. Rreth 25% e sipërfaqes është në malësi me pjerrësi 26-40%. Kjo është më e përshtatshme për pemëtari dhe patate.

### Të ardhurat nga fermat

Karakteristikat më kryesore të prodhimit nga fermat e qarkut të Elbasanit janë shumëllojshmëria e kulturave bujqësore, prodhimi për konsum familjar dhe jo për treg, rendimentet mjaft të ulëta dhe kostoja e lartë e prodhimit. Disa nga faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë gjendje janë sipërfaqja shumë e vogël e tokës për familje, cilësia e tokës, shumica e të cilës është në zonat kodrinore e malore mbi ujë, dhe mundësia shumë e ulët në treg.

<sup>14</sup> Vlerësimet cilësore në këtë raport bazohen në diskutimet me fokus grupe në zonat e varfëra, si dhe në një vrojtim cilësor në 4 komuna, që është kryer në periudhën mars-maj 2003 nga studentët dhe pedagogët e Universitetit “Aleksander Xhuvani”, dega e ekonomisë, në bashkëpunim me HDPC.



### Llogaritja e të ardhurave nga fermat për vitin 2002

Prodhimi për çdo komunë merr parasysh (i) *prodhimin e kulturave bujqësore*, të llogaritur në bazë të sipërfaqeve të mbjella më çdo kulturë dhe rendimenteve përkatëse. Këtu përfshihen drithërat, fasulet, duhani, luledielli, pambuku, perimet, bostani, soja, foragjeret e njoma, tagjirat; (ii) *prodhimet blegtorale*, në bazë të zhvillimit numerik të blegtorisë, duke marrë në vështrim gjedhin, të leshtat, të dhirtat, njëthundrakët, shpendët e bletët dhe duke llogaritur prodhimin e qumështit, leshit, vezëve dhe mjaltit; (iii) *prodhimet nga frutikultura*, ku përfshihen frutat e ndryshme, ullinjtë, agrumet dhe rrushi; (iv) *prodhime të tjera*, ku përfshihet peshku. Të dhënat mbështeten në regjistrin statistikor të dalë nga evidencat e specialistëve të bujqësisë, në studimet zoostatistikore dhe inventarizimet e kryera, si dhe në intervistat me fermerët e kontaktit.

**Të ardhurat bruto** janë llogaritur me çmimet mesatare të ndjekura gjatë vitit 2002, për çdo komunë e për çdo prodhim. Çmimet e drithërave janë ato të fabrikave të blajës të kombinuara me pjesën e tregtuar në tregun e lirë; çmimet e fruta-perimeve janë ato të shitjes me shumicë në treg të kombinuara me ato të përpunimit; çmimet e produkteve blegtorale janë ato të baxhove të kombinuara me ato të tregut; çmimet e foragjereve janë ato të tregut etj.

**Shpenzimet** për çdo komunë janë llogaritur me modele planesh biznesi për çdo kulturë e kategori toke bujqësore dhe për prodhimin blegtoral. Shpenzimet dalin të larta, rreth 70%, në fermat me shumë kultura dhe pa një specializim të veçantë, të cilat përfaqësojnë rreth 80% të fermave të qarkut. Shpenzimet dalin shumë më të ulta, rreth 45%, në fermat që kanë si aktivitet kryesor fruta-perimet, shumica e të cilave janë në zonën fushore.

Klasifikimi i komunave sipas të ardhurave mesatare për frymë në ditë nga fermat paraqitet në figurën 1.10. Dallohet qartë se komunat e zonës fushore e kodrinore të rrethit të Peqinit dhe Elbasanit janë komunat me të ardhura më të larta nga fermat, ndërsa shumica e komunave në zonat malore të rrethit të Gramshit dhe Librazhdit janë me të ardhura të pakta nga fermat.

### Ndihma ekonomike

Në zonën rurale të qarkut të Elbasanit përfitojnë ndihmë ekonomike<sup>15</sup> 10,943 familje apo rreth 22.5% e familjeve gjithsej dhe e ardhura mesatare mujore e tyre nga kjo ndihmë është rreth 531 lekë (shih tabelën 1.13). Këto përfaqësojnë një popullsi prej rreth 50,000 banorë. Në figurën 1.11 paraqitet klasifikimi i komunave sipas treguesit të ndihmës ekonomike<sup>16</sup>. Shihet qartë se komunat e rrethit të Librazhdit dhe të Gramshit kanë përqindjen më të madhe të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.

<sup>15</sup> Ndihma ekonomike në fshat jepet në bazë të ligjit nr. 7710, datë 18.05.1993. Mënyra sesi vepron në çdo komunë për përcaktimin e familjeve përfituese nuk lejon që në këtë proces të ketë spekulime.

<sup>16</sup> Ky tregues shpreh përqindjen e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe është llogaritur në nivel komune.

**Tabela 1.13 Shpërndarja e ndihmës ekonomike në komunat e qarkut**

Rrethi	Numri i familjeve në zonën rurale	Familje përfituese të ndihmës ekonomike, në%	Të ardhurat mujore për frymë nga ndihma ekonomike, në lekë
Elbasan	26,239	18.3	553.8
Gramsh	5,132	28.3	521.0
Librazhd	12,054	33.6	510.7
Peqin	5,291	12.2	544.4
Qarku	48,716	22.5	531.4

### Emigracioni dhe remitancat

Rreth 25% e familjeve të zonës rurale del se kanë mesatarisht 2 pjesëtarë të tyre në emigracion. Nevoja ekonomike quhet si arsyeja mbizotëruese e emigrimit. Përfaqësues të këtyre familjeve pohojnë se kjo është e vetmja zgjidhje për meshkujt dhe sidomos për të rinjtë për të punuar, sepse në fshat kanë shumë pak tokë. Ata synojnë të emigrojnë që të punësohen dhe të dërgojnë para për të ndihmuar familjen e tyre. Numri i emigrantëve është rritur shumë pas vitit 1995 dhe sidomos pas ngjarjeve të vitit 1997. Nga familjet raportohet se mesatarisht ato marrin nga emigrantët rreth 100 \$US në muaj.


### Të ardhurat për frymë

Të ardhurat mesatare për frymë për çdo komunë janë llogaritur duke marrë parasysh të ardhurat nga fermat për vitin 2002, të ardhurat e parafërta nga emigracioni dhe ndihmën ekonomike. Siç shihet nga tabela 1.14 dhe figura 1.12, të ardhurat më të larta për frymë në ditë i ka zona rurale e rrethit të Peqinit, i cili ka një sipërfaqe më të madhe toke fushore dhe me tregues të mirë ujitjeje, që krijojnë mundësi për kultura bujqësore më intensive dhe rendimente më të larta. Të ardhurat për frymë në ditë i kanë më të ulëta komunat e rretheve Librazhd e Gramsh, ku mbizotërojnë tokat malore.

Këto rezultate përkohë edhe me të dhënat mbi përdorimin e imputeve bujqësore. Kështu, në rrethin e Peqinit përdoren rreth 5.4 kv/ha plehra kimike, në rrethin e Elbasanit rreth 3.6 kv/ha, ndërsa në atë të Librazhdit dhe Gramshit përkatësisht 2.9 dhe 1.4 kv/ha. Të dhëna të ngjashme janë edhe ato të përdorimit të pesticideve, të cilat variojnë nga rreth 1 kg/ha në rrethin e Peqinit në rreth 0.2 kg/ha në rrethin e Gramshit e të Librazhdit.

**Tabela:1.14 Të ardhurat mesatare në zonën rurale në qarkun e Elbasanit**

Rrethi	Numri i banorëve	Të ardhurat neto gjithsej (mijë lekë)	Të ardhura mesatare për frymë në ditë	
			Lekë per frymë në ditë	USD per frymë në ditë
Elbasan	115,522	6,517,858	154.6	1.24
Peqin	25,678	1,488,748	158.8	1.27
Gramsh	25,246	1,220,637	132.5	1.06
Librazhd	58,724	2,961,681	138.2	1.11



Shpërndarja e të ardhurave nga fermat | Fig. 1.10

Komunat Steblevë në rrethin e Librazhdit dhe Tregan në rrethin e Elbasanit dalin me të ardhurat mesatare për frymë në ditë më të larta në shkallë qarku, përkatësisht 2.26 \$/frymë ditë dhe 2.12 \$/frymë ditë. Kjo shpjegohet me faktin se komuna e Steblevës mbjell më se 50% të sipërfaqes së tokës me patate, e cila është një kulturë intensive, ka vetëm rreth 1,700 banorë dhe 3.19 ha tokë për familje<sup>17</sup>. Komuna e Treganit siguron të ardhura të larta nga blegtoaria, sidomos nga delet e dhitë, si dhe nga frutikultura dhe ka mundësi të lartë për të dalë në treg. Shumica e komunave në rrethin e Gramshit dhe Librazhdit kanë të ardhura të ulëta për frymë (shih tabelën 1.15). Këto janë kryesisht zona malore, me pak mundësi për të mbjellë kultura intensive, perime e fruta, larg tregut dhe që përdorin shumë pak impute bujqësore.

**Tabela:1.15 Të ardhurat mesatare për frymë sipas komunave**

Rrethi	Numri i komunave sipas të ardhurave mesatare			
	më pak se 1 \$/ditë frymë	1-1.5 \$/ditë frymë	1.51-2.0 \$/ditë frymë	2.01 - 2.5 \$/ditë frymë
Elbasan	6	8	5	1
Peqin	1	3	1	0
Gramsh	3	6	0	0
Librazhd	3	5	0	1
Gjithsej	13	22	6	2

## 1.6 Rrugët e rritjes së të ardhurave në fshat

### Rritja e prodhimit nga fermat


Rritja e të ardhurave nga fermat dhe shtimi i mundësive për përpunimin dhe shitjen e prodhimeve është rruga kryesore e rritjes së të ardhurave në zonën rurale. Kjo mund të arrihet duke synuar përparësi zhvillimi të posaçme për secilën zonë, në mënyrë që në një periudhë afatmesme të sigurohet një rritje e prodhimit bimor e blegtoral në masën 15% dhe 18% përkatësisht dhe në një periudhë afatgjatë një rritje rreth 50-60% (shih tabelën 1.16).

Në fushë në afërsi të qyteteve është me leverdi: (i) Shtimi i prodhimit të perimeve nga fusha dhe nga serat, duke rritur sipërfaqen e mbjellë deri në rreth 6,000 ha për të prodhuar nga fusha 400-500 kv/ha dhe nga serrat diellore mbi 1,000 kv/ha. (ii) Rritja e prodhimeve të frutave, të tilla si pjeshka, dardha, fiku, rrushi, ulliri e agrumet, duke krijuar pemëtore të reja dhe rritur rendimentin e prodhimit. (iii) Rritja e numrit të krerëve të lopëve të racave të përparuara. (iv) Ngritja e punishteve të vogla të përpunimit të frutave dhe të prodhimeve

<sup>17</sup> Kjo komunë renditet e dyta në qark, pas komunës së Fierzës në rrethin e Elbasanit me 4 ha/familje.



Treguesi i ndihmes ekonomike | Fig. 1.11



Të ardhurat për frymë | Fig. 1.12

bujqësore e blegtorale. Aktualisht vetëm në rrethin e Elbasanit punojnë 15 fabrika bloje me kapacitet 5-150 ton/ditë dhe nevojat janë edhe për rreth 14 fabrika të tjera me kapacitet 2-7 ton/ditë. Punojnë, gjithashtu, 8 fabrika të përpunimit të qumështit me kapacitet 0.3-20 ton/ditë dhe nevojat janë edhe për 21 punishte të tjera me kapacitet 2-7 ton/ditë. Funksionojnë edhe 2 fabrika për përpunimin e frutave me kapacitet 24 dhe 180 ton/orë dhe nevojat janë për rreth 15 fabrika të vogla me kapacitet 1-9 ton/ditë.

Në **zonat kodrinore** është me leverdi: (i) Shtimi i prodhimit të pemëve frutore, duke ngritur 2,700-3,000 ha pemëtore e vreshta të reja dhe rritur rendimentin. Përparësi është ngritja e pemëtoreve e vreshtave familjare me sipërfaqe 2-4 dn. (ii) Rikthimi i traditës së kultivimit të duhanit, duke rritur sipërfaqen deri në 5,000-6,000 ha dhe rendimentin deri në 15-20 kv/ha, duke siguruar tregjet dhe mënjeluar monopolin e grumbulluesve. (iii) Zhvillimi i blegtorisë duke i dhënë përparësi lopës dhe deles.

Në **malësi** është më efektiv përqendrimi në pemët frutore, të tilla si qershi e kumbulla, në blegtorinë e imët dhe në prodhimin e patates në rreth 2500-3000 ha.

### Ndryshimi i strukturës së prodhimit

Rritja e prodhimit nga fermat kushtëzohet edhe nga disa ndryshime të rëndësishme të strukturës së prodhimit. Më të nevojshme janë këto përmirësime: (i) Ulja e sipërfaqes së drithërave nga 50 % në 30-35% dhe rritja e rendimentit me anë të farërave cilësore e një teknologjie më të përparuar kultivimi, duke prodhuar aq sa është e mjaftueshme për të përballuar nevojat e blegtorisë dhe një pjesë të vogël nevojave për bukë. (ii) Rritja e prodhimit blegtoral pjesërisht nga rritja e numerikut dhe kryesisht nga rritja e prodhimtarisë duke nxitur krijimin e fermave blegtorale të madhësisë 10-15 lopë dhe 200-500 dele e dhi. (iii) Nxitja e grumbullimit dhe përpunimit të bimëve mjekësore, të cilat gjenden me shumicë në qarkun e Elbasanit.

**Tabela 1.16 Treguesit kryesorë të zhvillimit të zonës rurale**

Treguesit	Njësia e matjes	Viti 2002	Viti 2006	Viti 2015
<b>I Rritja e prodhimit</b>				
Prodhimi bimor	%	2	15	50
Prodhimi blegtoral	%	3	18	60
<b>II Rritja e numrit të krerëve</b>				
Gjedhe	krere	98,510	110,000	150,000
Të leshta	krere	193,798	210,000	270,000
Të dhirta	krere	165,518	175,000	220,000
<b>III Shtimi i sipërfaqes</b>				
Serra	Ha	64	100	300
Pemëtore	Ha	4,761	5,000	6,000
Ullinj	Ha	3,968	4,200	5,000
Vreshta	Ha	1,518	1,800	2,500
<b>IV Impute të përdorura</b>				
Plehra kimike	Ton	20,177	27,000	40,000
Pesticide	Ton	30	36	50

## 1.7 Masat me përparësi

Masat me përparësi për zbutjen e varfërisë në qarkun e Elbasanit lidhen kryesisht me rritjen e shkallës së punësimit në zonën urbane dhe rritjen e të ardhurave nga fermat në zonën rurale. Në këndvështrimin e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, rëndësi të veçantë merr zbatimi i këtyre masave parësore:

- Zgjerimi i rrjetit të sistemit të formimit profesional në qytetin e Elbasanit në disa profesione të kërkuara dhe shtrirja edhe në rrethet e tjera, për një përshtatje më të mirë të forcave të punës me kërkesat e tregut të punës.
- Kthimi i pjesës së pashfrytëzuar të kombinatit metalurgjik në një park industrial, duke i paraprirë me përgatitjen e një studimi zbatueshmërie.
- Nxitja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, duke i paraprirë me përditësimin dhe zgjerimin e programeve të hartuara për këtë qëllim në nivel lokal dhe ndjekur zbatimin e tyre.
- Nxitja e krijimit të shoqatave të prodhuesve dhe të shërbimit, për të forcuar kooperimin e prodhuesve, duke rritur interesin e fermerëve nëpërmjet përmirësimeve të nevojshme ligjore dhe mbështetjes financiare.
- Financimi për të krijuar modele fermash bujqësore e blegtorale dhe modele linjash përpunimi të prodhimeve, duke zbatuar teknologji të reja, për të ndryshuar mendësinë e fermerëve dhe nxitur ata drejt zbatimit të këtyre modeleve
- Nxitja e investimeve për shtimin e kapaciteteve përpunuese të prodhimeve bujqësore e blegtorale, nëpërmjet financimit për krijimin e modeleve efektive.
- Sigurimi i linjave të kreditimit për frutikulturën, serat, komplekset blegtorale etj., për të ngritur serra familjare 1-3 dy, pemëtore 5-10 dy, ferma me mbi 10 krerë lopë, mbi 100 dele e dhi etj.
- Nxitja e investimeve për farërat e fidanet, duke i prodhuar në vend nëpërmjet shoqatave të specialistëve e fermerëve dhe duke i importuar, për të rritur sipërfaqen ku përdoren farëra hibride e me gjeneracion elite nga 40% që është sot në mbi 90 % të sipërfaqes gjithsej.
- Nxitja e prodhimit bujqësor e blegtoral që mbështet zhvillimin e turizmit rural, për të shfrytëzuar mundësitë e mëdha që ofron natyra e qarkut për këtë lloj biznesi.
- Ngritja e tregjeve të shumicës në afërsi të qyteteve për grumbullimin e prodhimeve të fermerëve.



## shtimi i mundësive për shkollim

fëmijët, si djemtë a vajzat, të cilët nuk kanë mundësi të kryejnë shërbime të edukimit të frekuentimit të shkollave të ulëta të një klasë në shkollën e tyre të afërta dhe me një nivel më të ulët të kualitetit të edukimit. Pas analizave të tërësishme të tërësive të edukimit në nivelin e fund ta përbushë tërësisht të kërkesave të kësaj lloji të politikave, kuadrit të ligjor dhe të mekanizimeve të përgjegjësisë të publikut etj. të cilat janë të nevojshme për të siguruar objektin deri në vitin 2015 është e

Në qarkun e Elbasanit fëmijët, nxënësit dhe studentët përbëjnë 25.8% të numrit të përgjithshëm të popullsisë<sup>18</sup>. Atje funksionojnë 216 shkolla 8-vjeçare, shumica e të cilave në fshat, dhe 189 shkolla fillore vartëse<sup>19</sup>. Në këto shkolla mësojnë rreth 54 mijë nxënës (shih tabelën 2.1). Shumica e tyre banojnë në fshat dhe kjo është më e theksuar në rrethin e Peqinit.

**Tabela 2.1 Të dhëna mbi arsimin 8-vjeçar në vitin shkollor 2002-2003**

	Nr. i shkollave		Nr. nxënësve			
	Fillore vartëse	8-vjeçare	Fillore vartëse	8-vjeçare	Total	Fshat (%)
Elbasan	64	112	5,360	25,012	30,372	52.2
Gramsh	54	34	870	6,361	6,327	71.0
Librazhd	54	49	974	10,437	11,411	79.6
Peqin	17	21	600	5,536	6,136	81.9
<b>Qarku</b>	<b>189</b>	<b>216</b>	<b>7,804</b>	<b>46,442</b>	<b>54,246</b>	<b>63.5</b>

Në qarkun e Elbasanit ka, gjithashtu, 42 shkolla të mesme. Nga këto, 6 janë shkolla të mesme profesionale dhe të gjitha ndodhen në rrethin e Elbasanit. Në këtë rreth kanë filluar punën edhe 6 shkolla private, nga të cilat 2 janë shkolla fillore me rreth 190 nxënës, 2 janë shkolla 8-vjeçare me rreth 220 nxënës dhe 2 janë shkolla të mesme me rreth 195 nxënës.

Në Elbasan funksionon një nga 8 universitetet e vendit, ku bëjnë pjesë 6 fakultete<sup>20</sup>. Gjatë periudhës 1996-2001 në këto fakultete janë diplomuar 2,349 studentë nga qarku i Elbasanit dhe nga rajone të tjera të vendit. Në Universitetin e Elbasanit studiojnë një numër i madh femrash, të cilat në vitin shkollor 2001-2002 përbënin 81.5% të numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar.

## 2.1 Treguesit kryesorë të arsimit bazë

Vlerësimi për mundësinë e kryerjes së arsimit bazë, si për djemtë ashtu edhe për vajzat, është mbështetur në disa tregues kryesorë, të cilët japin mundësinë e njohjes së gjendjes dhe të prirjeve të këtij sektori në qarkun e Elbasanit. Në përzgjedhjen e bërë janë pasur parasysh treguesit e Objektivit përkatës të Mijëvjeçarit për Zhvillimin dhe ata të përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në kuadrin e rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social<sup>21</sup>, si dhe tregues të tjerë, të mundshëm për t'u analizuar dhe mbikëqyrur në qarkun e Elbasanit.

<sup>18</sup> Mesatarja në shkallë vendi është 24.8%.

<sup>19</sup> Shkollat fillore vartëse janë shkolla të ciklit të ulët të fshatrave, ku nuk ka shkolla 8-vjeçare. Ato varen nga shkolla 8-vjeçare më e afërt.

<sup>20</sup> Fakulteti i Shkencave Shoqërore, i Shkencave të Natyrës, i Mësuesisë, Ekonomik, Juridik dhe i Gjuhëve të huaja.

<sup>21</sup> Matrica e treguesve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

**Përfshirja në arsimin bazë<sup>22</sup>** - Analiza statistikore e numrit dhe e shpërndarjes së shkollave 8-vjeçare dhe fillore në qarkun e Elbasanit tregon se përgjithësisht ato japin mundësinë e përfshirjes së kënaqshme<sup>23</sup> në arsimin bazë për të gjithë fëmijët e qarkut (shih figurën 2.1). Numri i fshatrave që nuk kanë shkollë fillore është shumë i vogël dhe ato janë në largësi të shkurtër nga shkollat e fshatrave fqinjë. Nxënësve të shkollave 8-vjeçare, që banojnë në fshatrat ku ka vetëm shkolla fillore, u duhet të lëvizin jo më shumë se 3-5 km për të ndjekur shkollën më të afërt.

**Norma neto e regjistrimit** –Për të dy ciklet e arsimit bazë ky tregues është përkeqësuar dhe për ciklin e ulët është shumë më i vogël se vlera mesatare në shkallë vendi. Megjithatë, nisur nga shkalla e saktësisë së llogaritjeve, vlerat e vitit shkollor 2001-2002 mund të quhen si vlera bazë për qarkun e Elbasanit, sepse për këtë periudhë të dhënat e popullsisë sipas moshave janë marrë nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë. Megjithatë, fakti që vlera e këtij treguesi është më e lartë në zonën rurale se në atë urbane, mendohet se ka të bëjë më shumë me saktësinë e pamjaftueshme të të dhënave të raportuara nga shkollat e fshatrave sesa me dallime të veçanta që u përkasin fëmijëve në qytet. Vihet re, gjithashtu, se norma e regjistrimit të vajzave, si në fshat ashtu edhe në qytet, është më e ulët se e djemve, veçanërisht në ciklin e lartë në zonën rurale. Kjo lidhet me mendësinë e hasur në disa fshatra se për vajzat është i mjaftueshëm vetëm arsimimi në ciklin e ulët.

**Madhësia e klasës dhe numri i mësuesve** - Raportet nxënës/mësues dhe nxënës/klasë janë rritur në të dy nivelet e arsimit bazë dhe janë më të larta se vlerat mesatare në shkallë vendi. Por, analizat më të thella për rrethe, komuna e fshatra të veçanta, tregojnë për pabarazi të mëdha të vlerave të këtyre treguesve në secilin nivel dhe për një shpërndarje të rastit të tyre, që dëshmon për mungesën e një strategjie të qartë mbi shpërndarjen më të mirë të shkollave dhe të mësuesve në territorin e qarkut.


**Tabela 2.2 Treguesit kryesorë të arsimit bazë për qarkun e Elbasanit**

Treguesit	Cikli	Viti shkollor 1995-1996				Viti shkollor 2001-2002			
		Gjithsej	Femra	Fshat	Femra	Gjithsej	Femra	Fshat	Femra
Raporti neto i regjistrimit	U	95	96	99	91	91	89	92	89
Raporti neto i regjistrimit	L	99	100	102	95	94	93	98	97
Raporti nxënës/mësues	U	22	n.a	21	n.a	23	n.a	22	n.a
Raporti nxënës/mësues	L	14	n.a	14	n.a	11	n.a	16	n.a
Raporti nxënës/klasë	U	26	n.a	25	n.a	22	n.a	20	n.a
Raporti nxënës/klasë	L	25	n.a	23	n.a	25	n.a	24	n.a
Frekuentimi në %	U	97	99	97	98	99	98	97	99
Frekuentimi në %	L	99	95	99	98	99	95	98	98
Kalueshmëria në %	U+L	89	93	87	90	94	94	95	96

U - i ulët, L - i lartë

<sup>22</sup> Arsimi bazë është arsimi 8-vjeçar, i cili me ligj është i detyruar për të gjithë, dhe përbëhet nga cikli i ulët (klasat 1 deri 4) dhe cikli i lartë (klasat 5 deri 8).

<sup>23</sup> Mundësia e ndjekjes është quajtur e kënaqshme kur largësia e shkollave fillore nga qendrat e banimit është më e vogël se 3 km.



Përfshirja në arsimin bazë | Fig. 2.1

**Frekuentimi** – Në qarkun e Elbasanit, ndjekja e shkollës nga nxënësit në ciklin e ulët të arsimit bazë në vitin shkollor 2001-2002 është rritur në krahasim me vitin shkollor 1995-1996 (shih tabelën 2.2) dhe është më e lartë se mesatarja në shkallë vendi (shih tabelën 2.4). Frekuentimi në ciklin e lartë është i njëjtë në të dy periudhat dhe mbi mesataren e vendit. Për këta tregues, të paktën sipas të dhënave statistikore, nuk dalin dallime midis zonave urbane dhe rurale. Frekuentimi i djemve dhe vajzave del të jetë, gjithashtu, pa dallime të dukshme, si në qytet ashtu edhe në fshat. Vlerësimi i përgjithshëm është se, në nivel qarku, për shumicën dërrmuese të fëmijëve që regjistrohen në shkollë, quhen të kapërcyera dukuritë e viteve të para të tranzicionit në lidhje me ndjekjen e shkollës.

**Kalueshmëria** – Ky tregues për vitin shkollor 2001-2002 është raportuar në nivele të përmirësuara në krahasim me periudhën e mëparshme 1995-1996 (shih tabelën 2.2). Megjithatë, në të dyja periudhat, ka dallim midis zonës urbane dhe asaj rurale.

**Tabela 2.3 Parashikimi afatmesëm i treguesve kryesorë të arsimit bazë**

Treguesit	Vendi 2002		Qarku 2002		Vendi 2006		Qarku 2006	
	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat
Raporti neto i regjistrimit-CU	96	93	91	92	97	95	92	93
Raporti neto i regjistrimit-CL	93	91	94	98	92	91	94	98
Raporti nxënës/mësues-CU	22	n.a	23	22	23	n.a	23	22
Raporti nxënës/mësues-CL	16.3	n.a	21	16	16.5	n.a	18	16
Raporti nxënës/klasë-CU	22.5	n.a	22	20	22.1	n.a	22	20
Raporti nxënës/klasë-CL	26	n.a	25	24	24	n.a	24	24
Frekuentimi në %-CU	98	n.a.	99	97	99	n.a.	99	97
Frekuentimi në %-CL	97	n.a	99	98	98	n.a	99	98
Kalueshmëria në %	-	-	94	95	-	-	96	97

CU-cikli i ulët, CL-cikli i lartë

**Analfabetizmi** - Norma e analfabetizmit në qarkun e Elbasanit është 1.7%, kundrejt 1.6% në shkallë vendi. Shkalla e analfabetizmit është më e lartë në rrethin e Elbasanit dhe më e ulët në rrethin e Peqinit (shih tabelën 2.4).

**Tabela 2.4 Pjesa e popullsisë analfabete<sup>24</sup>, %**

Rrethi	Analfabetizmi	
	Gjithsej	Grup moshë 15-24 vjeç
Elbasan	1.8	0.7
Gramsh	1.5	0.5
Librazhd	1.6	0.3
Peqin	0.7	0.4
<b>Qarku</b>	<b>1.7</b>	<b>0.6</b>
<b>Vendi</b>	<b>1.6</b>	<b>n.a</b>

Burimi, Repoba 2001

## 2.2 Mundësia reale për marrjen e arsimit bazë

### Klasat e kombinuara

Në shumicën e shkollave fillore vartëse të qarkut të Elbasanit mësimi zhvillohet në klasa të kombinuara për shkak të numrit të vogël të nxënësve. Por kjo gjithë varet edhe në disa shkolla 8-vjeçare. Kështu, për vitin shkollor 2002-2003, rreth 22% e shkollave 8-vjeçare në qarkun e Elbasanit kanë klasa të kombinuara. Më problematik ky fenomen paraqitet në rrethin e Gramshit ku mësimi zhvillohet në klasa të kombinuara në 50% të shkollave 8 vjeçare (shih tabelen 2.5).

Dispozitat normative të arsimit parauniversitar përcaktojnë që në shkolla të zonave rurale, për shkak të numrit të vogël të nxënësve për çdo klasë, puna mësimore-edukative mund të realizohet edhe në klasa të kombinuara. Formimi i klasave të kombinuara bëhet në varësi të numrit të nxënësve. Në ciklin e ulët zakonisht bashkohen klasa e parë me klasën e tretë dhe klasa e dytë me klasën e katërt. Nëse numri i nxënësve në të katër klasat është më i vogël se 25 atëherë formohet vetëm një klasë e kombinuar. Zhvillimi i mësimin në klasa të kombinuara në mjaft shkolla 8-vjeçare dhe të ciklit të ulët në qarkun e Elbasanit kufizon ndjeshëm mundësinë reale të fëmijëve për marrjen e arsimit bazë.

Kjo mënyrë zhvillimi mësimi e ul mjaft efektivitetin e mësimdhënies, kufizon mundësitë e fëmijëve për të nxënë dhe e ul interesin e tyre për shkollën. Veçanërisht këto ndikime negative vihen re në ciklin e lartë, ku edhe ngarkesa lëndore është më e madhe. Si pasojë, i është hapur shtegu krijimit të një kontigjenti fëmijësh, të cilët, megjithëse shkojnë në shkollë, marrin një nivel shumë të ulët dijes.

<sup>24</sup> Në bazë të shpjegimeve metodologjike të INSTAT për regjistrimin e vitit 2001 del që shkalla e analfabetizmit është llogaritur për popullsinë mbi 6 vjeç.

**Tabela 2.5** Numri i shkollave 8-vjeçare me klasa të kombinuara

	Gjithsej	Shkolla me klasa të kombinuara	%
Elbasan	112	13	11.0
Gramsh	34	17	50.0
Librazhd	49	14	28.6
Peqin	21	4	19.0
<b>Qarku</b>	<b>216</b>	<b>48</b>	<b>22</b>

Burimi: Drejtoritë Arsimore të Qarkut të Elbasanit

### Gjendja fizike e shkollave

Gjendja jo e mirë fizike e një numri të madh shkollash, veçanërisht në zonën rurale të qarkut, është një kufizim tjetër i mundësisë reale për marrjen e arsimit bazë. Megjithatë gjatë 10 viteve të fundit janë bërë mjaft investime për përmirësimin e shkollave ekzistuese dhe ngritjen e shkollave të reja, si nga buxheti i shtetit ashtu edhe nga donatorë të huaj, në të katër rrethet e qarkut rreth 35-55% e shkollave kanë nevoja urgjente për rehabilitim apo për ndërtim nga e para. Në përgjithësi, investimet në këtë fushë nuk janë mbështetur në kriteret e rrepta për përcaktimin e përparësive. Kështu, në rrethin e Gramshit rreth gjysma e numrit të shkollave zhvillojnë mësim në mjedise private, sepse shkollat janë në gjendje të papërshtatshme ose janë fare të shkatërruara. Në rrethin e Librazhdit janë përmirësuar ose ndërtuar shkolla të reja që kanë një numër të vogël nxënësish, ndërkohë që gjendja e dy shkollave 8-vjeçare të qytetit me një numër mjaft të madh nxënësish është shumë e keqe.

## 2.3 Dukuria e braktisjes së shkollës

### Largimet nga shkolla

Numri i nxënësve që kanë braktisur shkollën në tre vitet e fundit në qarkun e Elbasanit dhe në secilin nga rrethet që e përbëjnë është zvogëluar ndjeshëm (shih tabelën 2.3 dhe 2.6). Zvogëlimi është më i ndjeshëm në rrethin e Peqinit, rreth 52% në 3 vitet e fundit, dhe më pak i ndjeshëm në rrethin e Librazhdit, rreth 33%.

Braktisja e arsimit bazë ka ardhur duke rënë në shkallë vendi. Nga 3.2% në vitin shkollor 1998-1999, ajo është zvogëluar në 2.4% në vitin shkollor 2001-2002. Në periudhën 2003-2006 është planifikuar që ky tregues të zvogëlohet deri në 1.5% dhe synohet që deri në vitin 2015 të jetë zero<sup>25</sup>.

<sup>25</sup> Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik e Social, Tiranë, prill 2003.

Numri më i madh i fëmijëve që braktisin shkollën është nga fshati. Në vitin shkollor 2002-2003 këta përfaqësonin rreth 96.4% të nxënësve që kanë braktisur shkollën. Shumica e fëmijëve e braktisin shkollën pas klasës së pestë. Në vitin shkollor 2002-2003 këta përfaqësonin rreth 78.2% të nxënësve që kanë braktisur shkollën. Nuk ka dallime thelbësore gjinore në fenomenin e braktisjes së shkollës. Përveç rrethit të Peqinit ku ka më shumë femra sesa meshkuj braktisës të shkollës, në të gjitha rrethet e tjera ka më shumë meshkuj. Vetëm një numër shumë i vogël nxënësish që e braktisin shkollën, rreth 10%, mund t'i rikthehen përsëri asaj<sup>26</sup>.

**Tabela 2.6 Braktisja e shkollës në arsimin 8-vjeçar në qarkun e Elbasanit**

	2000-2001				2001-2002				2002-2003			
	Braktisin shkollën		Në ciklin e lartë %	Fshat %	Braktisin shkollën		Në ciklin e lartë %	Fshat %	Braktisin shkollën		Në ciklin e lartë %	Fshat %
Gjithsej	Femra %	Gjithsej			Femra %	Gjithsej			Femra %			
Elbasan	1,247	50.7	76.3	97.2	775	40.6	71.6	98.2	603	48.9	71.6	99.2
Gramsh	1,41	43.3	81.6	100.0	113	40.7	85.0	100.0	70	44.3	84.3	100.0
Librazhd	3,62	44.2	89.5	89.5	268	46.3	92.9	89.6	244	48.0	90.6	95.5
Peqin	426	58.0	85.2	90.6	356	53.1	81.5	88.8	165	54.5	81.2	86.1
<b>Qarku</b>	<b>2,176</b>	<b>50.6</b>	<b>80.6</b>	<b>94.8</b>	<b>1512</b>	<b>44.6</b>	<b>78.7</b>	<b>94.6</b>	<b>1082</b>	<b>49.3</b>	<b>78.2</b>	<b>96.4</b>

Shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës lidhen me faktorë të ndërthurur ekonomikë dhe socialë, si dhe me emigrimin dhe migrimin e familjeve (shih tabelen 2.7). Kështu, për arsye ekonomike dhe të një niveli të ulët kulturor, familjet ushtrojnë presion tek fëmijët që pas klasës së katërt të braktisin shkollën, duke i përfshirë ata në punët e përditshme. Legjislacioni aktual parashikon ndëshkime për prindërit e fëmijëve që braktisnin shkollën. Në qarkun e Elbasanit janë bërë disa përpjekje për të zbatuar këtë legjislacion, duke vendosur ndëshkime, por këto pothuajse në asnjë rast nuk janë ekzekutuar, pasi mungon një hallkë institucionale ekzekutuese. Ka raste, gjithashtu, që shkollat i paraqesin nxënësit braktisës si të larguar nga vendbanimi, duke u bazuar në një kompromis që arrihet midis familjes dhe pushtetit vendor të komunës, ose sikur ata e vazhdojnë shkollën, por thjesht kanë shumë mungesa, duke e ulur artificialisht këtë tregues.

<sup>26</sup> Vlerësim cilësor i Universitetit të Elbasanit dhe HDPC



**Tabela 2.7 Shkaqet e braktisjes së shkollës në qarkun e Elbasanit**

Shkaqet e braktisjes së shkollës	(%)			
	Elbasan	Gramsh	Librazhd	Peqin
Shkaqe ekonomike dhe sociale	39.0	28.5	40.6	23.6
Emigrimi	47.5	21.4	n.a	36.9
Cilësi e dobët e shkollës	0.6	15.7	n.a	14.8
Faktori kulturor i familjes	0.5	28.5	7.0	n.a
Infrastruktura	8.3	5.7	9.0	21.5
Të tjera	95.9	0.2	43.4	3.2

### Prapambetja e theksuar e nxënësve

Një numër jo i vogël nxënësish të ciklit të ulët ose të lartë të arsimit bazë, megjithëse e ndjekin në mënyrë të rregullt shkollën, shfaqin një prapambetje të theksuar në shkrim dhe lexim, duke iu bashkuar praktikisht grupit të analfabetëve. Këta mund të jenë nxënës që nuk njohin tingujt, që i njohin ato por nuk dinë t'i bashkojnë në rrokje, që nuk dinë të bashkojnë rrokjet në fjalë dhe që nuk dinë të bashkojnë fjalët në fjali. Nxënës të tillë, që nuk janë në gjendje të bashkojnë fjalët në fjali të thjeshta, hasen edhe në klasën e shtatë dhe të tetë, por mësuesit nuk i mbesin në klasë për shkak se këta fëmijë janë të disiplinuar dhe nuk duan që ata të braktisin shkollën dhe të jenë të ekspozuar ndaj rrezikut për t'u bërë pre e dukurive negative. Përgjithësisht këta nxënës e përfundojnë klasën e tetë, por nuk arrijnë të marrin dëftesën e lirim.

**Tabela 2.8 Nxënës me prapambetje të theksuar në arsimin 8 vjeçar, 2001-2002**

	Nxënës me prapambetje		% Cikli ulët	% fshat
	Gjithsej	Femra		
Elbasan	3548	25.8	66.9	70.5
Gramsh	746	33.5	24.8	74.9
Librazhd	800	38.5	41.5	81.9
Peqin	400	45.5	22.5	90.7
<b>Qarku</b>	<b>5494</b>	<b>30.1</b>	<b>54.3</b>	<b>74.2</b>

Në qarkun e Elbasanit janë evidentuar rreth 5,500 nxënës me prapambetje të theksuar në shkrim e këndim, që ndjekin arsimin bazë (shih tabelen 2.8). Këta përfaqësojnë rreth 10% të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Dukuria haset më shumë në zonën rurale dhe tek djemtë. Këto të dhëna tregojnë që njohja, përkufizimi, evidentimi, analiza dhe monitorimi

i fenomenit të prapambetjes së theksuar në shkrim dhe këndim janë shumë të rëndësishme, për të përcaktuar saktë vlerën reale të treguesit të analfabetizmit dhe zonat më problematike, si dhe për të parashikuar ndërhyrjet me përparësi.

## 2.4 Shpërndarja optimale e shkollave

Lëvizja e lirë e njerëzve ka sjellë ndryshime thelbësore në treguesit demografikë të qarkut të Elbasanit. Prirjet për ndërrimin e vendbanimit kanë dhënë një ndikim të dukshëm në numrin e nxënësve të zonës rurale që regjistrohen çdo vit në shkollë. Kështu, nëpërmjet studimit të numrit të lindjeve në periudhën 1997-2002 dhe parashikimit të lindjeve për periudhën 2003-2005 në fshatrat e rrethit të Elbasanit, të ndërthurur me shkollat e fshatrave ku ata mendohet se do mësojnë në të ardhmen, u përcaktua numri i nxënësve në shkollat përkatëse në vitin 2011. Ky numër u krahasua me numrin aktual të nxënësve në secilën shkollë. Përfundimet e kësaj analize tregojnë qartë se rreth 34% të shkollave të studjuara në vitin 2011 do të kenë 30-80% më pak nxënës se aktualisht, ndërsa në rreth 22% të shkollave numri i nxënësve do të jetë më i madh (shih figurën 2.2).

Këto prirje nuk janë marrë parasysh në investimet e kryera në sistemin arsimor. Nga studimi del se në 81 shkolla të vrojtuar, 49.4% e tyre janë ndërtuar të reja ose janë rikonstruktuar pas vitit 1990. Ndër shkollat e ndërtuara apo të rikonstruktuar, 36.5% janë shkolla që do të kenë një ulje të numrit të nxënësve në masën 30-80% në vitin 2011. Po kështu, ndër 16 shkollat që parashikohet të kenë rritje të numrit të nxënësve në vitin 2011, vetëm në 6 shkolla (37.5%) janë bërë investime kapitale të tilla si ndërtim apo rikonstruksion shkolle.

Kryerja e një studimi të plotë mbi shpërndarjen më të mirë të shkollave të arsimit bazë, duke marrë parasysh numrin e lindjeve, si dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në numrin e nxënësve, do të kushtëzojë vendime të rëndësishme mbi disa çështje themelore të sektorit të arsimit, të tilla si: cila do të jetë gjeografia e ardhshme e shkollave, cilat shkolla do të zgjerohen dhe cilat do të pushojnë së funksionuari, ku dhe në çfarë duhet investuar sipas cilës radhë, si duhet të jetë shpërndarja optimale e burimeve njerëzore dhe cilat do të jenë nevojat për kualifikim të tyre, si duhet të jetë shpërndarja e fondeve në pushtetin vendor për arsimin etj. Aktualisht, këtyre pyetjeve u jepet përgjigje në mënyrë sporadike, duke ndikuar negativisht jo vetëm në frytshmërinë e financimeve, por edhe në përgjithësi në frytshmërinë e sistemit arsimor.

## 2.5 Nevoja për disa standarde në arsim

Investimet e kryera deri tani në sektorin e arsimit janë përqendruar më së shumti në përmirësimin e mjedisit të shkollës, i cili është një faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin e procesit mësimor. Por ky përqendrim në investimet kapitale ka lënë jashtë vëmendjes ose



- Zona me tendencë rritje të numrit të nxënësve
- Zona me tendencë zvogëlimi të nxënësve 30%-80%
- Qendrat

Tendencat e ndryshimit të numrit të nxënësve deri në vitin 2011 | Fig. 2.2

ka nxjerrë në plan të dytë aspekte të tjera themelore që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, kualifikimin e mësuesve, administrimin e shkollës dhe të burimeve njerëzore.

Puna që bëhet për kualifikimin e mësuesve, veçanërisht të shkollave të fshatit, vështrohet si e pamjaftueshme, e pafrytshme dhe e pabazuar në standarde vlerësimi. Është e nevojshme që sistemi mjaft i centralizuar ekzistues të zëvendësohet me trajnimin në qendra rajonale trajnimi. Një qendër e tillë pilote tashmë është ngritur në qytetin e Elbasanit, e pajisur në mënyrë bashkëkohore. Kjo vlerësohet të jetë e përshtatshme për t'u shndërruar në një qendër rajonale për kualifikimin e mësuesve. Kjo mund të realizohet me mirëkuptim nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Pedagogjike, në lidhje me rolin, kapacitetin, mënyrën e menaxhimit të një qendre të tillë, si dhe përmbajtjen e kurseve.

Procedurat për emërimin dhe karrierën e mësuesve nuk bazohen në kritere të përcaktuara profesionale dhe në konkurrimin e vlerave. Praktika tregon që mësuesi pasi merr emërimin, e ushtron detyrën e mësuesit derisa del në pension. Mungojnë standardet e vlerësimit, që të motivojnë dhe detyrojnë mësuesin të rrisë kualifikimin e tij dhe të përballet me konkurrencën, njëlloj siç veprohet në fusha të tjera. Një gjendje e ngjashme është edhe për personelin administrues të shkollave. Aktualisht vlerësohet<sup>27</sup> se vetëm 40% e drejtorëve të shkollave në rrethin e Peqinit, 60% në rrethin e Librazhdit dhe 60-70% në rrethin e Gramshit mund të konsiderohen si të përshtatshëm dhe me cilësitë e nevojshme për të kryer detyrën që u është caktuar. Pjesës tjetër i mungojnë aftësitë organizuese dhe drejtuese, si dhe kualifikimi minimal i nevojshëm.

## 2.6 Arsimi i mesëm

Rritja e shkallës së frekuentimit, përmirësimi i cilësisë dhe ndryshimi thelbësor i raportit ndërmjet arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional janë sfidat më të rëndësishme me të cilat përballet arsimi i mesëm në qarkun e Elbasanit.

### Treguesit kryesorë

Në shkallë qarku funksionojnë 42 shkolla të mesme, në të cilat mësojnë rreth 12 mijë nxënës (shih tabelën 2.9). Shumica dërrmuese e këtyre shkollave është në qytete dhe pjesa më e madhe e nxënësve vijnë nga zonat urbane, ndërkohë që vetëm 29.9% e nxënësve janë nga fshati. Nga krahasimet për dy periudha të ndryshme (shih tabelën 2.10) del se përgjithësisht treguesit kryesorë të arsimit të mesëm janë duke u përmirësuar. Numri i nxënësve që regjistrohen në shkollën e mesme është rritur dhe frekuentimi është shumë më

<sup>27</sup> Ky vlerësim është bërë në bazë të një debati të gjerë me specialistë të zgjedhur të sektorit të arsimit nga secili rreth i qarkut të Elbasanit.

i lartë (nga 89% në 94%). Kjo është shoqëruar dhe me rritjen e përpjestimit nxënës/mësues nga 16 në 19 nxënës për mësues.

Objekti i përcaktuar në SKZHES për arsimin e mesëm është që, deri në vitin 2006, rreth 72% e nxënësve që mbarojnë arsimin bazë të vazhdojnë arsimin e mesëm, me synimin afatgjatë që deri në vitin 2015 kjo shifër të arrijë në 90%. Aktualisht ky tregues në rrethin e Elbasanit është arritur që tani, por në rrethet e tjera të qarkut ndryshimet janë të mëdha.

**Tabela 2.9 Numri i shkollave të mesme dhe i nxënësve në vitin shkollor 2002-2003**

	Nr. i shkollave	Nr. i nxënësve	
		Gjithsej <sup>28</sup>	Fshat (%)
Elbasan	22	8,095	23.7
Gramsh	7	1,401	36.5
Librazhd	11	1,996	47.5
Peqin	2	625	41.6
<b>Qarku</b>	<b>42</b>	<b>12,068</b>	<b>29.9</b>


Mundësia për të ndjekur arsimin e mesëm është shumë e kufizuar dhe largësia e madhe e qendrave të banuara nga shkollat e mesme vështrohet si pengesë e madhe për rritjen e numrit të nxënësve që regjistrohen në arsimin e mesëm. Për mjaft zona kjo largësi është shumë më e madhe se 5 km nga shkolla e mesme më e afërt, duke e bërë të pamundur vazhdimin e shkollës nga nxënësit (shih figurën 2.3).

Përfshirja e arsimit të mesëm në studimin e shpërndarjes optimale të shkollave do të mundësonte një planifikim më të mirë të shkollave, konvikteve dhe burimeve njerëzore për një periudhë të paktën afatmesme dhe për krijimin e kushteve që objektivat e vënë për vitet 2006 dhe 2011 të mund të përmbushen (shih tabelën 2.11).

**Tabela 2.10 Tregues për arsimin e mesëm në qarkun e Elbasanit**

Treguesit	1995-1996				2001-2002			
	Gjithsej	Femra	Fshat	Femra	Gjithsej	Femra	Fshat	Femra
Frekuentimi në %	89	96	82	88	94	98	99	99
Raporti nxënës/mësues	16		28		19		29	
Raporti bruto i regjistrimit	41	66	19	30	49	49	22	22
Raporti neto i regjistrimit	37	61	5	8	45	46	20	21
Kalueshmëria	92	92	90	90	97	97	93	93

<sup>28</sup> Në këtë shifër është përfshirë edhe numri i nxënësve që vazhdojnë arsimin e mesëm profesional nga qarqe të tjera.



Përfshirja në shkollat e mesme | Fig. 2.3

Synimi që në tre vitet e ardhshme të rritet numri i nxënësve që vazhdojnë arsimin e mesëm, nuk po shoqërohet me masat paraprake të nevojshme që do të ndihmonin realizimin e tij. Rritja aktuale e numrit të nxënësve të regjistruar në shkollat e mesme kryesisht në zonat urbane, në kushtet e mungesës së investimeve dhe të burimeve të nevojshme njerëzore, është shoqëruar me rritjen e numrit të nxënësve në klasa. Një masë paraprake e domosdoshme në këtë drejtim do të ishte rritja e numrit të mësuesve, në mënyrë që të krijohet mundësia për hapjen e klasave të reja.

**Tabela 2.11**

	Nr. i shkollave të mesme	% e nxënësve që thithen nga arsimi mesëm	% e mësuesve me kualifikimin përkatës	% e nxënësve që vazhdojnë shkollat e mesme profesionale
Elbasan	22	75.7	100.0	17.4
Gramsh	7	62.5	90.0	10.7
Librazhd	11	54	95.4	9.3
Peqin	2	42	96.8	15.1
Qarku	42	n.a	n.a	11.2

Numri i nxënësve që e përfundojnë shkollën e mesme del shumë më i vogël se numri i nxënësve të regjistruar në vitin e parë të kësaj shkolle. Norma e braktisjes së shkollës është e lartë dhe rezultatet e dobëta, mungesat e shumta dhe migrimi konsiderohen si arsye të kryesore të braktisjes. Faktori i fundit është më pak i rëndësishëm, pasi praktika provon që largimet për shkak të migrimit jashtë rrethit janë të krahasueshme me ardhjet në rreth. Kështu, nga krahasimi i të dhënave mbi numrin e nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm 4 vjeçar në vitin 1998 në rrethin e Elbasanit dhe numrin e nxënësve që mbaruan arsimin e mesëm në vitin 2002, del se vetëm 64.9% e nxënësve e kanë përfunduar shkollën e mesme.

Arsimi i mesëm po përjeton, gjithashtu, një krizë në rritje për mësues cilësorë të shkencave ekzakte, veçanërisht në lëndën e matematikës. Kjo po ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e cilësisë së mësimit dhe për rrjedhojë në uljen e interesit nga ana e nxënësve. Ky problem meriton vëmendje të veçantë për gjetjen e mekanizmave për të tërhequr mësues cilësorë të këtyre fushave. Problemet e krijuara në 12 vitet e fundit dhe mungesa e vazhdueshme e vëmendjes për gjetjen e mekanizmave që stimulojnë përgatitjen e mësuesve cilësorë në shkencat ekzakte dhe tërheqjen e tyre në sistemin arsimor po e rëndon gjithnjë më shumë gjendjen, duke rrezikuar që në të ardhmen të hyjë në rrugë të vështirë për t'u zgjidhur.

## Arsimi i mesëm profesional

Vetëm 6 nga 42 shkolla të mesme në qarkun e Elbasanit janë shkolla të mesme profesionale dhe të gjitha ato ndodhen në qytetin e Elbasanit, me përjashtim të shkollës së mesme bujqësore të qytetit të Cërrikut. Në to janë regjistruar rreth 11.2% e nxënësve gjithsej të shkollave të mesme të qarkut dhe ky tregues është shumë më i ulët se vlera mesatare në shkallë vendi. Rreth 40% e nxënësve të shkollave të mesme profesionale në rrethin e Elbasanit vijnë nga rrethe të tjera të vendit, ndërsa 17.6% e tyre vijnë nga rrethi i Gramshit, Peqinit dhe Librazhdit.

Në shkallë vendi, në vitin shkollor 2001-2002 numri i nxënësve që vazhduan shkollat e mesme të arsimit profesional ishte 15.4% e nxënësve gjithsej që vazhduan shkollat e mesme. Në vitin shkollor 2002-2003 ky numër u rrit në 16% dhe për periudhën afatmesme 2003-2006 objektivi është 30%.

Gjithashtu, sistemi arsimor i mesëm profesional duhet të jetë më elastik për sa u përket degëve. Aktualisht ka degë të tilla si gjuhët e huaja, normale dhe në disa degë të shkollës teknike që nuk kanë kërkesa të mjaftueshme për regjistrim. Nga ana tjetër, për disa degë ka më shumë kërkesa se kapacitetet ekzistuese, apo për profesione të caktuara tregu i punës ushtron presion të vazhdueshëm për hapjen e degëve të reja.



## 2.7 Masat me përparësi

Analiza e mësipërme e problemeve të arsimit në qarkun e Elbasanit dhe plotësimi i zotimeve lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit për arsimin parashtron marrjen e këtyre masave me përparësi:

- Kryerja e një studimi pilot për qarkun e Elbasanit mbi shpërndarjen optimale të shkollave të arsimit 8- vjeçar, përcaktimin e prioriteteve të investimeve, planifikimin e burimeve njerëzore etj. me synim rritjen e frytshmërisë së sistemit arsimor. Metodologjia dhe përfundimet kryesore të këtij studimi do të ndihmojnë qarkun e Elbasanit për përcaktimin e masave me përparësi në arsim dhe mund të shërbejnë për zbatimin e kësaj nisme edhe në qarqe të tjera.
- Rritja e rolit të Qarkut në evidentimin dhe zbutjen e pabarazive në sistemin e arsimit midis rretheve të ndryshme të qarkut, veçanërisht në fushën e investimeve.
- Evidentimi i saktë i nxënësve që karakterizohen nga prapambetje e theksuar në shkrim dhe këndim në shkallë qarku, i detajuar sipas gjinisë, vendndodhjes fshat/qytet dhe ciklit të ulët/të lartë të arsimit 8 vjeçar dhe përfshirja e këtij treguesi në treguesit statistikorë të raportueshëm. Monitorimi, analiza dhe përcaktimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e situatës.
- Nxjerrja reale dhe e saktë e numrit si dhe mbikëqyrja e nxënësve që braktisin shkollën. Përcaktimi dhe zbatimi i masave të nevojshme nga ana e drejtorive arsimore në bashkëpunim me autoritetet e pushtetit vendor në nivel bashkie dhe komune për uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën.
- Studimi i të ardhmes së arsimit të mesëm në qarkun e Elbasanit dhe evidentimi i nevojave për arsimin e mesëm profesional për të gjithë qarkun.
- Nxjerrja në dukje e numrit dhe mbikëqyrja e nxënësve që përfundojnë arsimin 8-vjeçar dhe që regjistrohen në arsimin e mesëm, % e nxënësve që regjistrohen dhe e përfundojnë arsimin e mesëm, dhe % e nxënësve të grupmoshës së arsimit të mesëm që e vazhdojnë atë. Nxjerrja dhe mbikëqyrja e këtyre treguesve mbi baza gjinore dhe fshat/qytet.
- Studimi i mundësisë së shndërrimit të qendrës ekzistuese pilote të trajnimit të mësuesve në qendër rajonale për kualifikimin e mësuesve të arsimit 8-vjeçar dhe të mesëm.



# kapitulli i tretë

## nxitja e barazisë gjinore

gjinore në ardhjen e afërme dhe të paktën deri në vitin 2015 në kryesime të kësaj agjende është barazimi i gjinor. Nën eufemizimin e "barazimit të gjinor" përfshihen të gjitha sferat e të jetës dhe të punës, të cilat ndikojnë në statusin e gruas në shoqëri dhe në punë. Në nivel kombëtar, del në pah se për të arritur këto objektiv dhe për të bërë të mundur zbatimin e politikave, kuadrit ligjor, mekanizmit të monitorimit dhe ndërgjegjësimit të publikut etj. Kështu, barazimi i gjinor deri në vitin 2015 është normale.

Femrat zënë rreth 49.4% të popullsisë së qarkut të Elbasanit. Pjesa e popullsisë së qarkut që banon në zonën rurale është më e madhe krahasuar me strukturën e popullsisë në shkallë vendi. Kështu, nga 362,736 banorë gjithsej që ka qarku, 65.6% jetojnë në fshat krahasuar me 57.8% që zë popullsia rurale në shkallë kombëtare. Pjesa rurale e popullsisë është më e madhe në rrethin e Librazhdit, Peqinit dhe Gramshit. Si rrjedhim, si në shkallë qarku ashtu edhe në secilin rreth, numri më i madh i femrave jetojnë në fshat.

Jetëgjatësia mesatare për qarkun e Elbasanit është 70.1 vjeç për meshkujt dhe 75.6 për femrat. Jetëgjatësia mesatare e femrave është më e madhe për rrethin e Peqinit dhe më e ulët për rrethin e Elbasanit, përkatësisht 76.8 në 75.3 vjeç.

Qarku dhe veçanërisht rrethi i Elbasanit janë dalluar për zhvillimin e shpejtë industrial. Kështu, në vitin 1989 rrethi i Elbasanit renditej në vendin e 2-të, pas Tiranës, për nga kontributi i tij në prodhimin e përgjithshëm industrial të vendit, duke dhënë rreth 10.7% të tij. Industrializimi i shpejtë u shoqërua jo vetëm me shtimin më të madh të popullsisë urbane në rrethin e Elbasanit krahasuar me rrethet e tjera të qarkut, por edhe me aktivizimin e dukshëm të potencialit të brendshëm intelektual të rrethit dhe thithjen e këtyre potencialeve edhe nga rrethet e tjera. Femra jo vetëm ka qenë pjesë e këtij procesi, por edhe ka luajtur një rol të rëndësishëm e mjaft aktiv në jetën sociale dhe ekonomike të Elbasanit. Kjo duket qartë edhe në vlerën e Indeksit të Zhvillimit Gjinnor dhe të Indeksit të Fuqisë Gjinnore të qarkut të Elbasanit, përkatësisht 0.754 dhe 0.415, që e rendisin në grupin e rajoneve me zhvillim dhe fuqizim gjinnor të mesëm<sup>29</sup>.

### 3.1 Arsimimi i femrave

Elbasani shquhet nga një lidhje e veçantë e njerëzve me arsimin, që mendohet se është edhe më e hershme se ngritja aty e shkollës së parë Normale të vendit. Tradita e arsimdashjes, e shoqëruar edhe me qëndrimin mjaft pozitiv ndaj zhvillimit dhe me një potencial intelektual të kultivuar në vite, kanë bërë që vështirësitë e shumta të hasura gjatë dekadës së fundit të mos e fashisin dëshirën për t'u arsimuar. Prandaj edhe ulja e numrit të nxënësve të përfshirë në arsimin 8-vjeçar e të mesëm dhe një vëmendje më e paktë ndaj arsimimit, veçanërisht të femrave që u vu re në vitet e para të tranzicionit, në qarkun e Elbasanit u kapërcye shpejt dhe vitet e fundit nxënësit kanë filluar t'i kthehen përsëri shkollës.

<sup>29</sup> Këta tregues matin përkatësisht pabarazinë midis grave dhe burrave, nga këndvështrimi i aftësive bazë e kushteve të jetesës, dhe mundësitë që u janë krijuar grave për të treguar aftësitë e tyre dhe për të marrë pjesë gjallërisht në jetën politike, ekonomike e shoqërore. Treguesit për Shqipërinë janë llogaritur për herë të parë në vitin 2002 nga HDPC (shih UNDP, Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor Shqipëria 2002).

Kjo traditë ka ndikuar dukshëm edhe në arsimimin e femrave. Kështu, gjatë vitit shkollor 2001-2002, numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin 8-vjeçar në qarkun e Elbasanit ishte 67,000 dhe nga këto 50.1% ishin vajza. Po kështu, gjatë po këtij viti shkollor, në shkollat e mesme të qarkut u regjistruan 11,600 nxënës dhe nga këta 53% ishin vajza. Këta tregues janë më të lartë se treguesit mesatarë në nivel kombëtar.

Në qarkun e Elbasanit, në arsimin e detyrueshëm 8-vjeçar, në përgjithësi, nuk vihen re dallime gjinore dhe përfshirja e femrave mund të konsiderohet plotësisht e barabartë me të meshkujve (shih tabelën 3.1). Brenda ciklit të shkollës 8-vjeçare, ka një përfshirje më të madhe të nxënësve në ciklin e ulët<sup>30</sup> krahasuar me ciklin e lartë të këtij niveli shkollimi. Në këtë cikël dallimet gjinore në përfshirje në arsim pothuajse nuk ekzistojnë.

Në Shqipëri, Ligji mbi Arsimin u garanton të drejtën e barabartë për shkollim si djemve ashtu edhe vajzave. Arsimi fillor është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga gjinia, dhe nuk ekzistojnë ndryshime të mëdha në ndjekjen e shkollës mes dy sekseve. Numri total i nxënësve që ndoqën shkollën gjatë vitit akademik 2000-2001 ishte 684,270 dhe nga këta 49.4% ishin vajza.

Numri më i madh i nxënësve që braktisin shkollën 8-vjeçare vihet re në ciklin e lartë dhe sidomos në klasën e pestë. Edhe në këtë cikël vajzat zënë një pjesë pak më të madhe se djemtë. Kjo është më e dukshme në rrethin e Peqinit. Kështu, në këtë rreth, gjatë vitit shkollor 2001-2002 braktisën shkollën 405 nxënës, nga të cilët rreth 55% ishin vajza. Shumica e këtyre fëmijëve, rreth 86%, ishin nga zonat e thella rurale, me një largësi të konsiderueshme të vendbanimit nga shkolla, kushte këto më pak të favorshme për vajzat. Megjithatë, nga një vlerësim cilësor rezultoi se në zonën rurale të këtij rrethi ka raste të braktisjes së shkollës nga vajzat edhe për shkak të kushteve mjaft të këqija ekonomike apo të mendësisë së disa familjeve fshatare se femrës nuk i duhen shumë vite shkolle.

Në arsimin e mesëm, ku në përgjithësi norma e regjistrimit është më e ulët se në arsimin 8-vjeçar, vihet re që frekuentimi i femrave është shumë më i lartë se i meshkujve (shih tabelën 3.1). Rrethi i Peqinit ka normën më të ulët të ndjekjes të arsimit të mesëm në qarkun e Elbasanit, si për femrat ashtu edhe për meshkujt.

<sup>30</sup> Cikli i ulët fillon në klasën e parë dhe mbyllet në klasën e katërt.

Në rrethin e Peqinit ka dy shkolla të mesme të përgjithshme, njëra ndodhet në qytetin e Peqinit dhe tjetra në komunën e Pajovës. Në këto shkolla mësojnë 589 nxënës, nga të cilët 48.3% janë femra. Një pjesë e mirë e nxënësve që përfundojnë shkollën 8-vjeçare nuk e ndjekin shkollën e mesme. Frekuentimi i arsimit të mesëm është shumë i madh në qytet krahasimisht me fshatin. 78% e vajzave që mbarojnë klasën e tetë në qytet e vazhdojnë shkollën e mesme, kurse për fshatin kjo shifër është vetëm 13%. Nga shkaqet më thelbësore të numrit të ulët të vajzave që ndjekin shkollën e mesme në fshat është largësia e vendit të banimit të tyre nga shkolla, mungesa e sigurisë dhe pamundësia për të udhëtuar larg. Në disa zona të rrethit ka filluar të rikthehet, gjithashtu, konservatorizmi i fshatit ndaj shkollimit të vajzave.

**Tabela 3.1 Frekuentimi në qarkun e Elbasanit (në %)**

	8-vjeçar			I mesëm		
	Gjithsej	Femra	Raporti F/M	Gjithsej	Femra	Raporti F/M
Elbasan	98.37	100.00	1.01	97.59	97.33	0.99
Gramsh	100.26	98.32	1.00	82.65	90.86	1.19
Librazhd	102.23	97.15	1.01	90.07	97.97	1.20
Peqin	101.48	98.82	1.00	100.00	100.00	1.00
<b>Qarku</b>	<b>99.63</b>	<b>99.27</b>	<b>1.00</b>	<b>96.25</b>	<b>97.60</b>	<b>1.05</b>

Burimi: Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Përfundime të ngjashme nxirren edhe nga analiza e fenomenit të analfabetizmit, i cili pothuajse u zhduk deri në fillim të vitit 1990, por ka filluar të rishfaqet gjatë viteve të tranzicionit, veçanërisht në zonat e thella rurale. Analfabetizmi në qarkun e Elbasanit nuk mund të quhet fenomen gjinor. Ai më shumë sesa me gjininë lidhet me kushtet social-ekonomike të familjes si dhe mundësinë praktike të ndjekjes së shkollës, pavarësisht që në zona të veçanta ka filluar të dallohen shenja konservatorizmi dhe mentaliteti frenues ndaj shkollimit të vajzave.

Mbështetur në të dhënat e regjistrimit të popullsisë, analfabetizmi në nivel qarku është 1.7% ndërsa për femrat ai është 2%. Këto shifra janë pak më të përkeqësuar sesa mesatarja kombëtare (shih tabelen 3.2). Duke analizuar shifrat në bazë rrethi vihet re që Elbasani ka një shkallë më të lartë analfabetizmi dhe një numër më të madh femrash që nuk dinë shkrim e këndim, krahasuar me rrethet e tjera të qarkut. Shkallën më të ulët të analfabetizmit e ka rrethi i Peqinit.

**Tabela 3.2 Popullsia që nuk di shkrim dhe këndim, %**

	Analfabetizmi gjithsej Gjithsej	Analfabetizmi per femrat Femra
Elbasan	1.8	2.2
Gramsh	1.5	1.9
Librazhd	1.6	2.0
Peqin	0.7	0.7
<b>Qarku</b>	<b>1.7</b>	<b>2.0</b>
<b>Vendi</b>	<b>1.6</b>	<b>1.9</b>

Burimi: Repoba 2001

Këto të dhëna pohojnë se analfabetizmi në përgjithësi dhe për femrat në veçanti është një fenomen që meriton më shumë vëmendje në qarkun e Elbasanit dhe se duhet ndërtuar një strategji e kujdesshme në mënyrë që të mos gjejë terren të përshtatshëm për t'u përhapur.

### 3.2 Kontributi i femrave në arsim

Në qarkun e Elbasanit femra jep kontribut të rëndësishëm në sektorin e arsimit. Kështu, gjatë vitit shkollor 2001-2002, 59.6% e numrit të përgjithshëm të mësuesve në arsimin 8-vjeçar dhe të mesëm ishin femra.

Në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” 80.2% e studentëve dhe 50.6% e pedagogëve janë femra. Femrat pedagoge kanë përfaqësim të mirë si përsa i përket detyrës që kryejnë, ashtu dhe shkallës së kualifikimit (shih tabelën 3.3). Kështu, 2 ndër tre dekanë të këtij universiteti dhe 25% e përgjegjësve të departamenteve janë femra. Për sistemin universitar në shkallë vendi rreth 30.7% e përgjegjësve të departamenteve janë femra.

Dallime vihen re në nivelin e kualifikimit të pedagogëve. Shumica e femrave janë asistent pedagoge dhe pedagoge, ndërsa vetëm rreth 13% e asistent profesorëve janë femra krahasuar me rreth 44% për sistemin universitar në shkallë vendi. Po kështu, nuk ka asnjë femër me titullin profesor në universitetin e Elbasanit. Megjithëse universiteti është i ri dhe një pjesë e madhe e kuadrove janë pedagogë dhe asistent pedagogë, midis të cilëve numri i femrave është i konsiderueshëm, kërkohet një përfshirje më e gjerë e femrave në punën kërkimore-shkencore, për të krijuar shanse të barabarta me meshkujt për marrjen e titujve shkencorë. Kjo do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së përgatitjes së studentëve në këtë universitet.

Tabela 3.3 Pjesëmarrja e gruas në poste drejtuese në Universitet

	Universiteti "Aleksandër Xhuvani"		Universitetet në të gjithë vendin	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Rektor	1	-	8	12.5
Dekan	3	66.6	30	20.0
Përgjegjës departamenti	12	25.0	101	30.7
Profesor	11	-	231	8.2
Asistent profesor	45	13.3	211	43.6
Doktor	34	26.5	n.a	n.a
Pedagog	166	50.6	172	55.8
Asistent pedagog	93	67.7	203	67.0

### 3.3 Punësimi i femrave

Tranzicioni shqiptar midis të tjerash e thelloi pabarazinë e gruas në tregun e punës dhe rriti vështirësitë për të në familje. Nevoja për ndërmarrjen dhe zbatimin e shpejtë të një numri të madh reformash ekonomike anashkaloi kujdesin për të vlerësuar ndikimin e tyre në pozicionin e femrës shqiptare në shoqëri dhe për të parandaluar ndikimin negativ që jepnin këto reforma. Edhe tani që pasojat negative janë të dukshme, strategjitë dhe politikat e ndryshme ekonomike shoqërore ende nuk i kushtojnë vëmendjen e merituar kësaj pabarazie.

Në tregun e punës të qarkut të Elbasanit femrat zënë rreth 41.2% të forcës së punës (shih tabelën 3.4). Vështirësitë në tregun e punës, megjithëse janë të dukshme për të gjithë popullsinë e aftë për punë, janë shumë më të mëdha për femrat. Mundësitë e femrave për t'u punësuar janë kufizuar së tepërmi, megjithëse shkalla arsimore e femrës del të jetë e lartë edhe në zonat ku tradicionalisht burri ka dominuar jetën ekonomike dhe sociale.

Femrat përballen me diskriminimin edhe kur zgjedhin dhe kërkojnë të konsolidohen në rrugën e tyre të karrierës. Edhe në rastet kur femrat kanë të njëjtin kualifikim me meshkujt, ato shumë rrallë kanë pozicione drejtuese si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Në vitin 1997, rreth 70% e grave ishin të punësuar në bujqësi në fermat familjare, rreth 20% punonin në sektorin publik dhe rreth 10% në sektorin privat. Pagat mesatare të femrave në të gjithë këta sektorë dhe në të gjitha nivelet zënë 70% të pagave të meshkujve, për shkak të pozicioneve më të ulta që ato kanë.



Pjesëmarrja e femrës në veprimtarinë ekonomike gjatë viteve të tranzicionit del se është gjithnjë e më e ulët dhe kjo gjendje duket se do të vështirësohet edhe më shumë në kushtet kur jo pak vajza ndërpresin shkollën në klasën e pestë, veçanërisht në zonat e thella, si dhe janë më pak vajza që vazhdojnë shkollën e mesme nga fshati. Në këtë mënyrë, rënia e numrit të viteve të shkollimit për femrat dhe mungesa e vëmendjes së nevojshme për këtë fenomen, do të krijojnë një disavantazh thelbësor në të ardhmen në tregun e punës për femrat. Kjo duket qartë në faktin se aktualisht në shkallë vendi femrat zënë rreth 37% të forcave të punës të punësuar. Përmasat e kësaj dukurie janë pothuajse të njëjta në qarkun e Elbasanit, ku femrat zënë rreth 38% të forcave të punës të punësuar. Gjendja është e ngjashme në të katër rrethet e qarkut (shih tabelën 3.4).

**Tabela 3.4 Treguesit e tregut të punës në qarkun e Elbasanit**

	Elbasan	Gramsh	Librazhd	Peqin	Qarku	Vendi
<b>Forca e punës (000)</b>	105.8	15.6	32.9	14.8	168.1	1347.3
<i>Femra %</i>	41.9	39.1	37.6	39.8	41.3	40.6
<b>Punësimi (000)</b>	81.9	12.8	26.2	12.5	133.5	1041.8
<i>Femra %</i>	38.4	36.7	38.5	39.2	38.4	37.6
<b>Papunësia, %</b>	22.6	17.9	20.4	15.5	20.6	22.7
<i>Femra %</i>	30.0	22.7	25.1	16.8	26.1	28.4

Burimi: Repoba 2001

Në vitin 1990<sup>32</sup> rreth 45% e të punësuarve ishin femra. Sektorët me shkallë të lartë punësimi të femrave ishin shëndetësia - rreth 80%, arsimit - 55%, tregtia – rreth 55% dhe industria – rreth 55%, ndërsa në sektorët të tillë si ndërtimi dhe transporti punësimi i femrave ishte në një shkallë të ulët.

Përqindja e grave të punësuar në sektorin jo bujqësor është një nga treguesit që lidhet me objektivin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas. Një pjesëmarrje e madhe dhe aktive e gruas në sektorin jobujqësor, jo vetëm lejon shfrytëzimin e potencialeve të saj, por ndikon ndjeshëm në rritjen e kontributit dhe pavarësisë së saj në familje dhe shoqëri.

<sup>32</sup> INSTAT, Vjetari Statistikor, 1991

Të dhënat e punësimit për vitin 2001 (shih tabelën 3.5) tregojnë se femra vazhdon të jetë e punësuar në masë të madhe në sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit, ku zë përkatësisht mbi 74% dhe 57% të të punësuarve, madje në këtë të fundit është rritur numri i femrave kundrejt meshkujve, krahasuar me vitin 1990. Punësimi i femrës në sektorin e ndërtimit dhe të transportit vazhdon të jetë i ulët në të katër rrethet, ndërsa vihet re një ulje e ndjeshme e punësimit të femrës në industri. Në nivel qarku, në këtë sektor, janë punësuar rreth 5,400 veta, nga të cilët vetëm rreth 22% janë femra, kundrejt rreth 55% në vitin 1990. Arsyeja kryesore që ka ndikuar në këtë ulje të madhe të shkallës së punësimit të femrës në këtë sektor është mbyllja dhe falimentimi i pjesës më të madhe të industrisë, veçanërisht i industrisë së lehtë dhe ushqimore, ku një pjesë e konsiderueshme e të punësuarve kanë qenë femra.

**Tabela 3.5 Punësimi i femrave sipas sektorëve<sup>32</sup>**

	Bujqësi	Industri	Ndertim	Tregti	Hotele	Transport	Arsim	Shëndetësi
<i>Elbasan gjithsej</i>	46,254	4,154	495	1,514	523	1,422	2,986	1,467
<i>Femra %</i>	42.1	23.9	4.2	30.1	42.6	12.5	66.7	74.6
<i>Gramsh gjithsej</i>	8,594	376	44	146	69	186	642	336
<i>Femra %</i>	37.1	20.7	9.0	34.2	52.2	17.7	57.3	77.7
<i>Librazhd gjithsej</i>	19,933	586	143	327	178	586	1,043	487
<i>Femra %</i>	40.1	17.2	6.3	29.3	42.7	11.6	62.0	78.6
<i>Peqin gjithsej</i>	9,844	283	77	144	40	191	373	132
<i>Femra %</i>	41.6	15.5	2.6	16.6	20.0	15.2	64.1	75.0

Burimi: Repoba 2001

Shumica e femrave të punësuar punojnë në bujqësi. Në rrethin e Elbasanit dhe të Gramshit ato përfaqësojnë rreth 79% të femrave të punësuar gjithsej, në rrethin e Librazhdit rreth 85% dhe në rrethin e Peqinit rreth 90%. Një angazhim kaq i madh në bujqësi dëshmon se jeta e saj e përditshme në fshat po vështirësohet gjithnjë edhe më shumë, në kushtet kur burri ende mban një status të privilegjuar ekonomik brenda familjes, duke qenë pronar i tokës, i shtëpisë etj. Jeta e gruas në fshat është vështirësuar edhe më shumë si pasojë e problemeve në furnizimin me ujë, energji elektrike, nga mungesa e pajisjeve elektroshtëpiake si dhe në disa raste të shtëpive të lindjes apo qendrave shëndetësore me personelin e nevojshëm mjekësor. Ulja e ndjekjes së ciklit të lartë të shkollës 8-vjeçare dhe të mesme në qark veçanërisht për femrat do të krijojë edhe më shumë probleme në të ardhmen lidhur me pozicionin e gruas fshatare në familje dhe në bashkësi.

Përqindja e femrave të punësuar në sektorin jo bujqësor është mjaft e ulët. Në nivel qarku, vetëm rreth 17% e femrave të punësuar gjithsej punojnë në sektorin jo bujqësor. Përmirësimi i këtij treguesi, që lidhet drejtpërdrejt me objektivat e mijëvjeçarit për zhvillimin, kërkon hartimin dhe zbatimin e politikave të veçanta për punësimin e femrave në shkallë vendi, prej ku mund të veçohen edhe ndërhyrje të posaçme për qarkun e Elbasanit.

<sup>32</sup> Të dhënat u referohen vetëm të punësuarve që e kanë deklaruar se në cilin sektor punojnë.

SKZHES parashikon zbatimin e politikave aktive për punësimin. Në këto politika përfshihen vazhdimi i programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet trajnimeve profesionale, si dhe përmirësimi i shërbimeve të ndërmjetësimit të punësimit. Strategjia përcakton si synim të saj që nga programet aktive të punësimit do të përfshihen të papunët e varfër dhe të papunët e rrezikuar, si gratë dhe të rinjtë. Megjithatë, SKZHES mbetet në një shkallë të gjerë në nivelin konstatues lidhur me çështjet gjinore dhe ende nuk përmban masa konkrete që trajtojnë punësimin e femrës.

### Femra në pozicione drejtuese

Në shkallë vendi, vetëm 20.9% e pozicioneve drejtuese në institucione e ndërrmarje shtetërore e në biznese private janë zënë nga femra (shih tabelën 3.6). Ky tregues për qarkun e Elbasanit është 16.6%, pra shumë më i ulët se mesatarja e vendit. Në këtë anë, rrethi i Librazhdit paraqitet me tregues më të përkeqësuar. Vetëm 9.6% e të punësuarve në pozicione drejtuese janë femra në këtë rreth.

Përfshirja e femrave në sipërmarrjet private është, gjithashtu, e ulët në shkallë vendi. Në qarkun e Elbasanit femrat punëdhënëse dhe të vetëpunësuarat zënë përkatësisht 28.6% dhe 39.2% të numrit të përgjithshëm të punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve, pra pak më shumë se mesatarja e vendit. Megjithatë, sipërmarrja dhe vetëpunësimi i femrave është kufizuar pothuajse vetëm në sektorin e tregtisë dhe të shërbimeve.

**Tabela 3.6 Femra në pozicione drejtuese në %**

	Femra në pozicione drejtuese	Femra Punëdhënëse	Femra të vetëpunësuarat
Elbasan	17.6	29.3	39.6
Gramsh	23.3	30.6	36.4
Librazhd	9.6	24.4	38.9
Peqin	17.4	24.1	40.3
<b>Qarku</b>	<b>16.6</b>	<b>28.6</b>	<b>39.2</b>
<b>Vendi</b>	<b>20.9</b>	<b>25.4</b>	<b>37.6</b>

Burimi: Repoba 2001

### Papunësia

Papunësia në qarkun e Elbasanit është 20.6% ose rreth 2% më e vogël se mesatarja e vendit (shih tabelën 1.3). Norma e papunësisë për femrat është mjaft më e lartë sesa për meshkujt jo vetëm për qarkun në tërësi, për të cilin në vitin 2001 rezultoi të jetë rreth 26%, por edhe për të gjitha qytetet që e përbëjnë (shih tabelën 3.7). Numri i të papunëve femra është veçanërisht i lartë në qytetin e Cërrikut, rreth 63%, dhe në qytetin e Elbasanit, rreth 52%.

**Tabela 3.7 Shkalla e papunësisë në bashkitë e qarkut të Elbasanit**

	Elbasan	Cerrik	Gramsh	Librazhd	Përrenjas	Peqin	Qarku
<b>Papunësia, %</b>	<b>37.6</b>	<b>45.3</b>	<b>35.6</b>	<b>29.4</b>	<b>29.9</b>	<b>35.5</b>	<b>20.6</b>
<i>Meshkuj</i>	26.0	30.2	48.0	16.9	23.2	24.9	17.0
<i>Femra</i>	<b>51.6</b>	<b>62.9</b>	<b>25.4</b>	<b>42.8</b>	<b>37.8</b>	<b>49.8</b>	<b>26.1</b>

Burimi: Repoba 2001

Ndryshime kaq të theksuara në nivelin e punësimit të femrave dhe të meshkujve kushtëzohen nga tregu i punës dhe nga vleresimi i paktë i punës dhe rolit të femrës, sepse të dhënat për nivelin e shkollimit provojnë se nuk ka ndryshime në nivelin arsimor të femrave dhe meshkujve.

### 3.4 Femra në strukturat vendimmarrëse

Pjesëmarrja e gruas në politikë dhe në organet vendimmarrëse në shkallë vendi është mjaft e ulët. E njëjta gjë vihet re edhe në qarkun e Elbasanit. Kjo dukuri e ka burimin, në radhë të parë, te numri i ulët i femrave që militojnë në partitë politike dhe që janë të zgjedhura në forumet drejtuese të tyre. Kështu, numri i femrave të zgjedhura në kryesitë e degëve të partive parlamentare në qarkun e Elbasanit ndryshon nga 18.5% deri në 29% të të zgjedhurve gjithsej në këto forume. Ky realitet vijon më tej me numrin e vogël të kandidatëve femra në zgjedhjet parlamentare dhe në zgjedhjet për qeverisjen vendore, si dhe me numrin mjaft të kufizuar të femrave të zgjedhura në këto organe. Aktualisht nga 11 deputetë që përfaqësojnë qarkun e Elbasanit në parlament, vetëm 2 janë femra.

Në parlamentin shqiptar ka nëntë femra deputete, dy prej të cilave janë zëvendëskryetare parlamenti. Asnjë grua nuk është zgjedhur kryetare e ndonjë komisioni parlamentar. Në dy vitet e fundit janë emëruar katër gra si ambasadore në trupat diplomatike të akredituara jashtë vendit. Nga 19 ministrat në qeverinë aktuale të Shqipërisë vetëm dy janë femra.

Çështja e rritjes së numrit të femrave në antarësinë e partive politike dhe në forumet drejtuese të tyre nuk është sa duhet në vëmendjen e strukturave udhëheqëse të këtyre partive. Partitë politike janë fare pak aktive në lidhje me anëtarësimet e reja të femrave dhe më shumë presin që ato të trokasin në dyert e politikës. Por femra nga natyra e ka më të vështirë afrimin me politikën, duke i lënë meshkujt në kushte mjaft komode konkurrence. Megjithatë, disa përpjekje pozitive për të nxitur pjesëmarrjen e femrës në forumet e partive politike dhe

për rritjen e vëmendjes ndaj përfaqësimit gjinor kanë filluar të shfaqen. Kështu, njëra nga partitë e mëdha politike e ka përcaktuar në statutin e saj kuotën prej 30% të përfaqësimit të femrës në forumet drejtuese të saj.

Përfaqësimi i femrave në organet vendimmarrëse të qeverisjes vendore në qarkun e Elbasanit është tepër i ulët (shih tabelën 3.8). Shkalla e ulët e përfaqësimit është e dukshme në të tre mandatet e zgjedhjeve. Kështu, nga shtatë kryetarë bashkie dhe kryetare të këshillit bashkiak në qark, vetëm një kryetar bashkie dhe një kryetare e këshillit bashkiak është femër. Nuk ka asnjë grua të zgjedhur kryetare ndër 44 kryetarët e komunave të qarkut të Elbasanit në të tre mandatet e zgjedhjeve vendore. Po kështu, fjala drejtues fshati (*kryeplak*) duket sikur ka kuptim vetëm për burrat, pasi ndër 386 veta që drejtojnë fshatrat e qarkut të Elbasanit, asnjë dhe asnjëherë nuk është zgjedhur femër. Përfaqësimi i femrës në këshillin bashkiak është shumë i ulët përkatësisht 8.2%, 9.5% dhe 11.8% në zgjedhjet e vitit 1992, 1996 dhe 2000. Në nivel komune, 18 ndër 578 anëtarë të këshillave të komunave janë femra. Kjo pjesëmarrje është veçanërisht e ulët në komunat e rrethit të Gramshit, Librazhdit dhe Peqinit, ku përkatësisht ka vetëm 1 grua, 4 dhe 3 gra anëtare të këshillit të komunave.

**Tabela 3.8 Femrat në organet e pushtetit vendor të qarkut të Elbasanit**

	1992			1996			2000		
	Gjithsej	Femra	%	Gjithsej	Femra	%	Gjithsej	Femra	%
Kryetarë bashkie	7	1	14.2	7	1	14.2	7	1	14.2
Kryetarë të këshillit bashkiak	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	7	1	14.3
Kryetarë komune	44	-	-	44	-	-	44	-	-
Kryetarë të këshillit të komunës	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	n.a	20	1	5.0
Drejtuës fshati	386	-	-	386	-	-	386	-	-
Këshilli bashkiak	109	9	8.2	115	11	9.5	143	17	11.8
Këshilli i komunës	529	10	1.9	554	10	1.8	578	18	3.1
Shuma	1075	20	1.86	1106	22	1.98	1185	38	3.1

Burimi: HDPC

Në numrin mjaft të ulët të femrave të zgjedhura ndikojnë edhe kriteret për të kandiduar në zgjedhjet vendore. Një prej tyre është që kandidati për kryetar komune, bashkie dhe qarku duhet të ketë arsimin e lartë. Të dhënat provojnë që në komuna po ulët gjithnjë edhe më shumë numri i banorëve me arsim të lartë. Kështu, në shumicën e komunave të qarkut të Elbasanit ka më pak se 15 banorë me arsim të lartë (shih tabelën 3.9), nga të cilët shumica rezulton se janë diplomuar me korrespondencë. Në këto rrethana, vendosja e kriterit të arsimit të lartë për zgjedhjet vendore si parakusht për të hyrë në konkurrencë nuk është realiste dhe ka pasojë negative në përzgjedhje. Ky kriter ndikon edhe më negativisht për femrat, të cilat zënë një pjesë të vogël të këtij numri. Prandaj do të ishte e nevojshme që kriteret e kandidimit të ishin më elastike dhe të shprehnin më mirë realitetin.

**Tabela 3.9 Numri i personave me arsim të lartë sipas komunave**

Komuna	Elbasan	Gramsh	Librazhd	Peqin	% ndaj totalit
< 15 banorë me arsim të lartë	5	5	2	2	31.1
16-30 banorë me arsim të lartë	8	2	1	2	28.8
31-50 banorë me arsim të lartë	4	1	3	1	20.0
> 51 banorë me arsim të lartë	3	1	5	0	20.0

Burimi: HDPC

Përfaqësimi më i drejtë gjinor në vendimmarrje kërkon një vëmendje shumë më të madhe nga të gjithë aktorët kryesorë të qarkut. Mungesa e vëmendjes e ndërthurur me traditën në ndarjen e përgjegjësisë midis burrave dhe grave ka ndikim të dukshëm në realitetin e sotëm të qarkut. Klima politike në periudhë zgjedhjesh është një aspekt tjetër me ndikim të madh në numrin e paktë të femrave të zgjedhura. Kjo klimë në shumicën e rasteve nuk ka qenë e favorshme për një konkurim të qetë, të hapur dhe mbi bazën e vlerave e cilësive individuale të kandidatëve. Tensioni që ka shoqëruar shpesh fushatat zgjedhore ka ndikuar së tepërmi në pakësimin e mundësisë së femrave për të konkuruar, në një hezitim dhe mospranim për mbështetje nga ana e familjes dhe nga ana e bashkësisë në rast konkurrimi.

Sikurse në nivel vendi, edhe në qarkun e Elbasanit përpjekjet për t'i besuar femrës poste të rëndësishme drejtuese në administratën vendore dhe në administratën qendrore në nivel vendor janë të pakta (shih tabelën 3.10). Kështu, megjithëse femrat përbëjnë 48.9% të punonjësve të administratës së prefekturës, 46.7% të punonjësve të administratës së bashkive dhe 34.7% të punonjësve të administratës së qarkut, vetëm 12.5% të drejtuesve të institucioneve kryesore janë femra. Edhe përfshirja e femrës në administratën e komunave është në nivel mjaft të ulët. Aktualisht vetëm në 20.6% të vendeve gjithsej të punës të administratave të komunave në shkallë qarku janë punësuar femra.

**Tabela 3.10 Femra në administratën qendrore dhe lokale në qarkun e Elbasanit**

	Total	Femra	%
Drejtues në institucione kryesore	48	6	12.5
Nëpunës në prefekturë	49	24	48.9
Drejtores drejtorie në prefekturë	11	3	27.2
Nëpunës në qark	46	16	34.7
Drejtores drejtorie në qark	10	6	60.0
Nëpunës në bashkitë e qarkut	214	100	46.7
Nëpunës në komuna	493	102	20.6
Trupi pedagogjik efektiv në Universitet	122	55	45.1
Nga këta me titull	90	15	16.6
Kryetare gjykate	3	-	-
Gjyqtare	41	11	26.8

Burimi: HDPC

### 3.5 Përfshirja në OJF-të

Që nga viti 1990 është vërejtur tendenca për një përfshirje gjithnjë në rritje femrave në organizata dhe shoqata të shoqërisë civile. Organizatat Jo Fitimprurëse të grave kanë luajtur një rol të rëndësishëm në hartimin e disa ligjeve në dobi të barazisë gjinore, në ndërgjegjësimin e publikut mbi rolin e femrës në shoqëri dhe në përfshirjen e femrave në veprimtari konkrete të jetës politike, ekonomike e shoqërore të vendit

Në qarkun e Elbasanit ka një përfshirje të mirë të grave në organizatat jo fitimprurëse, disa prej të cilave janë mjaft aktive. Aktualisht në qark funksionojnë 9 shoqata, misioni i të cilave është i përqendruar në problemet e barazisë gjinore. Pesë prej këtyre shoqatave veprojnë në rrethin e Elbasanit, 2 në Gramsh dhe 2 në Librazhd, ndërsa në rrethin e Peqinit nuk ka asnjë shoqatë të tillë. Veprimtaria e tyre është përqendruar në rritjen e ndërgjegjësimin në fushën e të drejtave të grave, të dhunës në familje, këshillimit të grave etj. Një pjesë e shoqatave kanë kontribuar duke dhënë shërbime sociale falas për gratë apo duke organizuar kurse të trajnimit profesional, kryesisht në kompjuter dhe në rrobaqepësi.

Karakteristikë e punës së këtyre shoqatave dhe e strukturave të tjera që merren me problemet e gruas është përqendrimi i aktivitetit të tyre vetëm tek gratë. Për vite me radhë janë organizuar shumë debate për çështje të barazisë gjinore, por këto në shumicën e rasteve janë bërë ndërmjet vetë grave. Në shumë pak raste meshkujt kanë qenë pjesë e aktiviteteve të organizuara për çështje gjinore, ndërkohë që emancipimi i gruas dhe rritja e përfaqësimit të saj mund të arrihet vetëm nëpërmjet emancipimit të të gjithë shoqërisë.

### 3.6 Masa me përparësi në fushën gjinore

Vitet e fundit po i kushtohet një vëmendje më e madhe diskutimit të problemeve gjinore si dhe trajtimit të mjaft dukurive ekonomike e sociale edhe nga këndvështrimi gjinor. Aktorët më aktivë në fushën e çështjeve gjinore janë organizatat jo fitimprurëse të grave dhe institucionet ndërkombëtare, misioni dhe strategjia e të cilave përmban elementë të çështjeve gjinore. Megjithatë, niveli i ndërgjegjësimin të institucioneve të ndryshme ekzekutive dhe vendimmarrëse për rëndësinë e problemit gjinor është ende i ulët. Kjo ka bërë që në rastin më të mirë institucionet të mbeten thjesht në konstatime të fenomeneve të ndryshme që lidhen me barazinë gjinore, çka është shoqëruar me mungesë politikash dhe masash të veçanta për rritjen e vëmendjes ndaj çështjeve gjinore. Në këndvështrimin e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin, masat e mëposhtme me përparësi mund të ndikojnë në mënyrë të dukshme në përmirësimin e treguesve të barazisë gjinore të qarkut të Elbasanit:

- Organizimi i veprimtarive të ndërgjegjësimit për aspektin gjinor në të gjitha nivelet politike dhe qeverisëse të qarkut të Elbasanit.
- Marrja e zotimeve konkrete nga ana e strukturave politike nëpërmjet vendosjes së treguesve sasiorë të anëtarësisë së femrave në partitë politike në nivel lokal, të përfshirjes së femrave në forumet drejtuese të tyre, si dhe të numrit të femrave candidate në fushata të ndryshme elektorale.
- Organizimi i veprimtarive trajnuese për çështjet gjinore me pjesëmarrës nga drejtoritë e burimeve njerëzore në nivel lokal, të drejtorive të marrëdhënieve me publikun, zyrave të punës dhe të sektorëve të tjerë, që ata të lehtësojnë pjesmarrjen e gruas në administratë dhe në tregun e punës.
- Përfshirja e kriterit gjinor në kriteret e përzgjedhjes së punonjësve në nivele të ndryshme të administratës vendore: në komunë, bashki dhe qark.
- Mbështetja e organizatave jo fitimprurëse me profil gjinor për të zhvilluar aktivitete ndërgjegjësimi para dhe gjatë fushatave zgjedhore në mbështetje të kandidateve femra. Veçanërisht vëmendje kërkojnë fushatat e ndërgjegjësimit të bashkësive në zonat rurale për një klimë paqësore gjatë zgjedhjeve si dhe për evidentimin e kandidateve femra dhe mbështetjen e tyre.
- Në përputhje me strategjinë sektoriale të punësimit, të hartuar nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, hartimi dhe zbatimi i programeve të veçanta të nxitjes së punësimit të femrave në nivel qarku e rrethesh.
- Me anë të studimit të tregut të punës në kushtet e veçanta të qarkut të Elbasanit, vënia në dukje e nevojave për profesionet më të kërkuara e të mundshme për femrat dhe nxitja e kualifikimit të femrave në këto profesione nga strukturat shtetërore, private ose të shoqërisë civile.



## përkujdesja për shëndetin e nënës dhe fëmijës

Zvogëlimi i vdekjeve të nënës dhe fëmijës dhe i shëndetit të nënës dhe fëmijës në periudhën e mijëvjeçarit të ardhshëm të paktën me dy të tretat të objektivave të nënës dhe fëmijës nën moshën 5 vjeçare dhe të kshëmrisë të nënës dhe fëmijës nën moshën 5 vjeçare, vaksininim e të gjithë nënës dhe fëmijës, rritjen e kujdesit për nënën dhe fëmijën. Në bazë të analizave në nivel kombëtar, del se Shqipëria mund të përmbushë objektivin 4, për të cilin mbështetjes nga ana e politikave, kuadrit ligjor dhe meve të financimit, ndërgjegjësimit të publikut etj. konsiderohet e dobët. Shqipëria mundet të përmbushë objektivin 5, për të cilin shkalla e mbështetjes së këtyre faktorëve quhet normale.

Zbatimi i reformës në sistemin shëndetësor mbështetet në strategjinë 10-vjeçare të sektorit të shëndetësisë dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social. Reformat synojnë përmirësimin e sistemit rregullator, rritjen e frytshmërisë së përdorimit të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të sistemit shëndetësor, zgjerimin e mundësisë për të patur shërbime shëndetësore etj.

Sistemi shëndetësor në qarkun e Elbasanit administrohet në shkallë rrethi dhe përbëhet nga shërbimi shëndetësor parësor, shërbimi spitalor dhe shërbimi farmaceutik. Shërbimi shëndetësor parësor apo shërbimi ambulator përfaqëson edhe pjesën më të rëndësishme të këtij sistemi. Misioni kryesor i këtij shërbimi është të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit dhe kushte më të mira shëndetësore për popullatën. Ai siguron kontaktin e parë me personat që kanë nevojë për shërbime shëndetësore. Prandaj edhe lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbushjen e objektivave të përcaktuara në fushën e përkujdesjes për shëndetin e nënës dhe fëmijës, sidomos në zonën rurale, ku shërbimi spitalor pothuajse nuk ekziston.

Shërbimi ambulator sigurohet nëpërmjet qendrave shëndetësore dhe ambulancave. Sigurimi i aktivitetit të tyre dhe mirëmbajtja janë përgjegjësi e pushtetit vendor, ndërsa përgjegjësia për kualifikimin profesional, veprimtaritë parandaluese dhe edukuese, mbikëqyrja e cilësisë së shërbimeve, shpërndarja dhe vendndodhja e institucioneve etj., është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë dhe ushtrohet nëpërmjet Drejtorive të Shëndetit Publik të rretheve.

Rrethi i Elbasanit ka përfituar çdo vit rreth 5% të shpenzimeve gjithsej që bëhen në shkallë vendi për sektorin e shëndetësisë<sup>33</sup> (shih tabelën 4.1), ndërkohë që për punët publike ka përfituar rreth 3%. Këto fonde përgjithësisht janë rritur gjatë periudhës 1999-2001 në të gjitha rrethet e qarkut. Po kështu, në strukturën e shpenzimeve totale që bëhen brenda çdo rrethi<sup>34</sup>, shëndetësia zë një pjesë të konsiderueshme, e cila ka ardhur duke u rritur nga viti në vit për secilin nga rrethet përbërës të qarkut. Megjithatë, nevojat për investime në këtë sektor janë shumë më të mëdha se ato që janë financuar deri më sot dhe konsiderohet se është i domosdoshëm përdorimi i skemave më efikase të financimit brenda sektorit, si dhe dhënia e një roli më të rëndësishëm e përgjegjësie më të madhe strukturave të pushtetit vendor. Masa të tilla parashikohen të merren në kuadrin e reformës së decentralizimit.

Në qarkun e Elbasanit, në fushën e shëndetit të nënës dhe fëmijës, përgjithësisht hasen të njëjtat probleme, mangësi e vështirësi që vihen re në shkallë vendi. Megjithatë, disa çështje të veçanta si mundësia për të pasur shërbimin shëndetësor parësor, sidomos në zonat rurale, përkujdesja për fëmijët e porsalindur dhe edukimi i nënave, kërkojnë një trajtim më të vëmendshëm, nëpërmjet ndërhyrjeve me përparësi në shkallë qarku ose komune.

<sup>33</sup> Këto janë fonde të financuara nga Buxheti i Shtetit për shëndetsinë në Rrethin e Elbasanit.

<sup>34</sup> Këtu hyjnë shpenzimet e financuara nga fondet e buxhetit të shtetit dhe ato të pushtetit vendor.

Tabela 4.1 Pjesa e shpenzimeve në sektorët kryesorë sipas rretheve në %

Sektori	Viti 1999				Viti 2000				Viti 2001			
	Elb.	Gramsh	Libr.	Peqin	Elb.	Gramsh	Libr.	Peqin	Elb.	Gramsh	Libr.	Peqin
Punë publike	2.2	0.8	0.5	0.2	3.3	0.9	0.6	0.7	2.8	0.8	0.7	0.4
Arsimi	6	1.4	1.2	0.9	4.6	1.0	1.6	0.7	5.9	1.3	2.0	0.8
Shëndetsia	5.1	0.4	1.7	0.4	5.1	1.3	1.5	0.4	4.9	1.2	1.5	0.4
Shëndetsia ndaj totalit të shpenzimeve në rreth	17	19.1	17.1	12.3	18.8	20.8	17.2	11.9	19.3	18.8	17.8	12.5

## 4.1 Vdekshmëria e fëmijëve

### Vdekshmëria foshnjore

Vdekshmëria foshnjore në qarkun e Elbasanit gjatë dhjetëvjeçarit të fundit ka ardhur duke u ulur (shih tabelën 4.2). Shifra më e lartë e normës së vdekshmërisë foshnjore është vënë re në vitin 1994, rreth 36.5 për 1,000 lindje të gjalla, çka përkon me vitin kur ky tregues në shkallë vendi ka qenë, gjithashtu, në nivelin më të lartë të tij, rreth 36.5 për 1,000 lindje të gjalla. Megjithatë, pothuajse për të gjithë periudhën e shqyrtuar, norma e vdekshmërisë foshnjore në shkallë qarku del se është shumë më e lartë se sa mesatarja e vendit.

Në shkallë rrethi, të dhëna veçanërisht të larta janë ato të rrethit të Gramshit, ndërsa më mirë paraqitet rrethi i Peqinit. Përgjithësisht, të gjitha rrethet, veç Gramshit, gjatë kësaj periudhe kanë shfaqur një prirje uljeje të kësaj norme, me përjashtim të disa luhatjeve në vite të caktuara, siç është rasti i vitit 1999, ku të gjitha rrethet kanë patur shifra më të përkeqësuar krahasimisht me vitin 1998. Përmirësimet më të dukshme janë vënë re në rrethin e Peqinit dhe të Elbasanit, në të cilët vdekshmëria foshnjore në harkun kohor 1993-2002 është ulur përkatësisht rreth 35% dhe 63%.

Tabela 4.2 Norma e vdekshmërisë foshnjore në qarkun e Elbasanit

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Elbasan	34.1	35.5	36.6	33.1	28.2	27.2	28.1	27.6	19.7	22.2
Gramsh	10.7	30.3	27.4	19.7	25.4	21.8	29.3	22.2	35.9	50.5
Librazhd	30.5	39.9	31.2	32.3	21.7	17.5	19.2	17.2	19.0	21.2
Peqin	40.8	42.1	35.2	36.6	16.1	15.7	18.9	12.6	19.8	14.9
Qarku	31.4	36.5	34.2	31.8	25.4	23.4	25.5	23.5	20.9	23.6
Vendi	33.4	35.7	30.0	25.8	22.5	20.5	17.5	16.0	17.4	17.3

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Nga analiza e vdekshmërisë foshnjore brenda secilit rreth del se përgjithësisht ajo është më e lartë në zonën rurale. Kështu, në rrethin e Elbasanit, deri në vitin 1995 vdekshmëria ka qenë më e lartë në qytet sesa në fshat, ndërsa më pas ky tregues ka qenë vazhdimisht më i lartë për fshatin. Ndërkaq, prirjet në rënie të vdekshmërisë foshnjore vihen re si për fshatin ashtu dhe për qytetin. Ndryshime të vlerave të normës së vdekshmërisë foshnjore vihen re edhe brenda qyteteve. Në qytetin e Elbasanit ka zona të veçanta, si lagjja Vullnetari, Haxhias dhe 28 Nëntori me vdekshmëri foshnjore të lartë.

Në përgjithësi, përmirësimet në vdekshmërinë foshnjore është e vështirë të përliqjen me argumente konkrete dhe të besueshme. Kjo gjë është veçanërisht e vështirë në analizën e të dhënave në shkallë komune, në të cilat vihet re një shpërndarje shumë e rastit, herë mjaft të përkeqësuar dhe herë mjaft të larta. Megjithatë, ka argumente të mjaftueshme që tregojnë se ka pasaktësi dhe evidentim jo të rregullt të rasteve të vdekjeve në zonën rurale. Vonesa në regjistrimin e foshnjave të porsalindura në gjendjen civile dhe mungesa e raportimit të rasteve të vdekjes janë mangësi tashmë të provuara. Vihen re mangësi në zbatimin e legjislacionit, i cili detyron që deklarimi i lindjes duhet të bëhet brenda 15 ditëve dhe, në raste të veçanta, jo më vonë se 30 ditë nga dita e lindjes. Me kalimin e këtyre afateve, lindja konfirmohet vetëm me vendim gjykate dhe veç kësaj paguhen 5,000 lekë gjobë. Kjo tregon që vlerat e këtij treguesi duhen parë me rezervë, sepse në disa raste nuk pasqyrojnë si duhet realitetin.

Analiza e shkaqeve të vlerave të larta të vdekshmërisë foshnjore tregon se ato përfshijnë një spektër të gjerë arsyesh, veçanërisht për zonën rurale, që nga mundësia e kufizuar e popullsisë për të shfrytëzuar infrastrukturën shëndetësore dhe deri në nivelin ekonomik, kushtet e jetesës dhe nivelin kulturor të familjes në përgjithësi dhe të nënës në veçanti.

Nga të dhënat ekzistuese të vdekshmërisë foshnjore vihet re se rreth 56% të rasteve të vdekjeve të foshnjave kanë ndodhur në muajin e parë të jetës. Shkak mbizotërues i vdekjes së foshnjave janë sëmundjet e aparatit frymëmarrës dhe ato infektive, të cilat vijnë nga kushtet e këqija të jetesës e të banimit dhe nga niveli i ulët kulturor e njohuritë e pakta të nënës dhe të familjarëve të tjerë mbi mirërritjen e fëmijës.

Rastet e vdekjeve në banesë, megjithëse janë ulur nga viti në vit, mbeten përsëri më të larta sesa vdekjet në klinikë. Del që mesatarisht më shumë se 70% e vdekjeve ndodhin në banesë. Ndihma e mjekut kërkohet me shumë vonesë, duke mos dhënë mundësi që asistenca nga ana e tij të jetë efikase.

Sipas strategjisë së zhvillimit të sektorit të shëndetësisë dhe strategjisë kombëtare të zhvillimit ekonomik e social, vdekshmëria foshnjore në shkallë vendi synohet të ulet nga 17.3 vdekje/mijë lindje të gjalla në vitin 2002, në 14 vdekje/mijë lindje të gjalla në vitin 2006 dhe në

10.1/mijë lindje të gjalla në vitin 2015. Synohet që norma e vdekshmërisë foshnjore në qarkun e Elbasanit të ulet në rreth 17/mijë lindje të gjalla deri në vitin 2005, aq sa është sot mesatarja në shkallë vendi. Kjo do të thotë se për vitin 2015 objektivi është që ky tregues të jetë rreth 13.9/mijë lindje të gjalla.

### Vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç

Norma e vdekshmërisë për fëmijët nën 5 vjeç në qarkun e Elbasanit ka shfaqur përgjithësisht prirje përmirësimi gjatë periudhës 1993-2002, duke patur një rënie prej rreth 1/3 e vlerës së vitit 1993 (shih tabelën 4.3). Ulja më e madhe e këtij treguesi është vërejtur për rrethin e Peqinit, i cili, veçanërisht gjatë vitit të fundit, ka shënuar një shifër mjaft të ulët të vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç, që arrijnë deri në 14.8 vdekje për 1,000 lindje të gjalla. Nga ana tjetër, rrethi i Gramshit, ashtu si dhe për vdekshmërinë foshnjore, ka tregues të përkeqësuar dy vitet e fundit, përkatësisht 41 dhe 61.1 vdekje për 1,000 lindje të gjalla.

Megjithëse vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç ka ardhur duke u ulur, ka ende zona, veçanërisht ato rurale, në të cilat numri i vdekjeve është i madh. Nga pikëpamja e moshës, më problematike janë fëmijët e moshës 1-2 vjeç, ndërsa shkaku kryesor mbeten sëmundjet pulmonare. Edhe në këtë rast dukuri negative është numri i lartë i vdekjeve të ndodhura në banesë. Kjo shpjegohet kryesisht me nivelin e ulët të kulturës shëndetësore të prindërve në zonat më problematike dhe me mungesën e shërbimit të përhershëm shëndetësor në këto zona, i cili bën që fëmijët e sëmurë të paraqiten me mjaft vonesë në spitalin pediatrik më të afërt.

**Tabela 4.3 Norma e vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç**

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Elbasan	45.6	46.4	46.6	43.1	36.1	35.8	38.0	34.4	24.5	28.1
Gramsh	12.6	41.7	31.1	23.0	29.0	27.8	30.6	31.0	41.0	61.1
Librazhd	48.5	58.8	43.6	42.5	26.6	27.3	26.8	21.9	23.2	25.0
Peqin	51.2	65.3	48.6	43.6	21.4	20.9	24.6	21.6	22.0	14.8
<b>Qarku</b>	<b>43.1</b>	<b>50.5</b>	<b>44.3</b>	<b>40.9</b>	<b>32.1</b>	<b>31.7</b>	<b>33.8</b>	<b>30.3</b>	<b>25.5</b>	<b>29.1</b>
<b>Vendi</b>	<b>44.0</b>	<b>47.1</b>	<b>38.7</b>	<b>33.1</b>	<b>27.50</b>	<b>25.9</b>	<b>22.0</b>	<b>19.7</b>	<b>20.1</b>	<b>20.7</b>

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

### Fëmijët e lindur nën peshë

Fëmijët e lindur nën peshë janë kategoria më e prekshme prej vdekshmërisë foshnjore dhe vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç. Ndër shkaqet kryesore të lindjes nën peshë janë kushtet e varfra social-ekonomike të familjeve, ushqyerja e papërshtatshme, streset e ndryshme të nënës, veçanërisht gjatë periudhës së shtatzënisë, kontakti i pakët me personelin shëndetësor dhe ndjekja jo sistematike e gruas shtatzënë në qendrat shëndetësore të specializuara, etj.

Tabela 4.4 Fëmijët e lindur nën peshë në Qarkun e Elbasanit në %

	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Elbasan	4.7	5.2	5.8	5.1	7.9	4.7	6.1	6.4
Gramsh	3.3	3.1	8.1	5.3	6.5	4.4	4.3	3.7
Librazhd	4.3	1.9	2.1	5.7	5.0	3.2	5.0	5.3
Peqin	0.9	1.6	1.2	1.8	0.5	1.9	3.5	2.9
<b>Qarku</b>	<b>4.1</b>	<b>4.0</b>	<b>4.8</b>	<b>4.9</b>	<b>6.6</b>	<b>4.1</b>	<b>5.5</b>	<b>5.7</b>
<b>Vendi</b>	<b>9.3</b>	<b>5.0</b>	<b>7.1</b>	<b>5.7</b>	<b>6.0</b>	<b>4.8</b>	<b>4.4</b>	<b>4.6</b>

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Nga të dhënat shihet qartë se përqindja e fëmijëve të lindur nën peshë në qarkun e Elbasanit është 5.7% ose rreth 24% më e lartë se mesatarja në shkallë vendi (shih tabelën 4.4). Vlerat e këtij treguesi deri në vitin 1998 kanë qenë më të ulëta se mesatarja në shkallë vendi, por, më pas, ndërsa kjo shifër në shkallë vendi ka ardhur vazhdimisht në rënie, në qarkun e Elbasanit është rritur. Rrethet më problematike në këtë aspekt paraqiten Elbasani dhe Librazhdi.

### Vaksinimi i fëmijëve

Pas viteve të para të tranzicionit, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të mbajtur nivele të larta të vaksinimit të popullsisë. Me mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare është siguruar rritja në mënyrë të vazhdueshme e përqindjes së popullsisë të imunizuar nga sëmundje të ndryshme epidemike (shih tabelën 4.5).

Tabela 4.5 Vaksinimi i fëmijëve kundër fruth-rubeolës<sup>35</sup> në %

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Elbasan	42.0	79.5	95.0	93.8	86.0	44.4	86.3	96.0	95.0
Gramsh	100.0	99.3	99.0	100.0	95.0	97.2	99.9	100.0	100.0
Librazhd	96.7	98.3	95.0	97.8	98.0	96.5	98.9	98.0	99.0
Peqin	85.3	88.3	99.0	82.3	99.0	97.4	n.a	92.0	94.0
<b>Qarku</b>	<b>64.0</b>	<b>84.8</b>	<b>96.2</b>	<b>94.4</b>	<b>94.5</b>	<b>57.7</b>	<b>86.2</b>	<b>96.5</b>	<b>97.0</b>
<b>Vendi</b>	<b>81.2</b>	<b>91.0</b>	<b>92.0</b>	<b>95.1</b>	<b>90.0</b>	<b>83.9</b>	<b>92.0</b>	<b>95.1</b>	<b>96.0</b>

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

<sup>35</sup> Nga viti 1993-2000 është zbatuar vetëm vaksinimi kundër fruthit, ndërsa për vitet 2001-2002 u zbatua Programi Kombëtar i luftës kundër fruth-rubeolës.

Qarku i Elbasanit karakterizohet nga tregues mjaft të mirë të vaksinimit në përgjithësi dhe të vaksinimit kundër fruth-rubeolës në veçanti. Në vitin 2002 rreth 97% e fëmijëve të qarkut është vaksinuar kundër fruth-rubeolës krahasuar me rreth 96% që është ky tregues në shkallë vendi. Procesi i vaksinimit menaxhohet në mënyrë efikase nga sektori i epidemiologjisë në secilin rreth dhe si personeli mjekësor ashtu edhe pjesa dërrmuese e popullsisë kanë një shkallë të lartë ndërgjegjësimi mbi rëndësinë që paraqet vaksinimi në kohë i fëmijëve. Shkalla e lartë e vaksinimit lidhet edhe me gjendjen përgjithësisht të mirë të bazës ftohëse për ruajtjen, transportimin dhe zbatimin e vaksinave, sipas kushteve teknike që kërkon vaksinimi. Kjo bazë materiale gjendet si në qytet ashtu dhe në qendrat shëndetësore në fshat.

Nga të dhënat e tabelës 4.5 shihet se, megjithë përqindjen shumë të lartë të fëmijëve të vaksinuar, ende nuk është arritur vaksinimi në masën 100% për të gjitha rrethet e qarkut. Analiza e kësaj dukurie tregon qartë se shkaqet lidhen kryesisht me disa raste mospranimi nga ana e prindërve për vaksinimin e fëmijëve, nga kultura e pamjaftueshme shëndetësore e tyre, apo me raste të largimeve nga vendbanimi në ditët kur bëhet vaksinimi.

Në fakt, regjistrimet në zyrat e gjendjes civile të familjeve që shpërngulen nuk bëhen rregullisht e si pasojë është akoma më e vështirë të kërkohej dokumentacioni i nevojshëm mbi gjendjen e vaksinimit të fëmijëve. Në këto kushte është mjaft e rëndësishme që të krijohet një marrëdhënie më e ngushtë dhe më e drejtpërdrejtë ndërmjet zyrave të gjendjes civile dhe këshillimoreve të fëmijëve apo personelit mjekësor.

Gjithashtu, mungesa e godinave të ambulancave në mjaft fshatra të qarkut ka bërë që vaksinimi të kryhet me vështirësi. Në rastet kur ka ambulancë, popullata e ka më të lehtë të njoftohet dhe disiplinohet për të bërë vaksinat. Aktualisht ka evidencë të mjaftueshme që provon se zonat ku ka ambulanca ose qendra shëndetësore janë me tregues më të lartë vaksinimi.

Një çështje tjetër me rëndësi në këtë fushë është sigurimi i vaksinave, të cilat, deri tani në një masë të madhe janë sjellë nëpërmjet ndihmave të partnerëve ndërkombëtarë, ku UNICEF luan një rol drejtues. Për të garantuar parandalimin e sëmundjeve epidemike dhe diarreike, objektivi afatmesëm në shkallë vendi është sigurimi në masën 100% i vaksinave të përfshira në kalendarin e vaksinimit të detyrueshëm. Synimi është përfshirja graduale e Ministrisë së Shëndetësisë në financimin e tyre deri në mbulimin deri në 100% në fund të vitit 2005. Prandaj, kjo çështje mund të quhet jo problematike për qarkun e Elbasanit.

## 4.2 Vdekshmëria amësore

Qarku i Elbasanit e ka zero treguesin e vdekshmërisë amësore për vitin 2001 dhe 2002 (shih tabelën 4.6). Rrethet e Peqinit dhe të Gramshit nuk kanë patur raste të vdekshmërisë

amësore për më shumë se 6 vite rresht. Shmangia e vdekshmërisë amësore është rezultat i një pune të kujdesshme në vite dhe rritjes në vazhdimësi të kujdesit për nënën. Asistenca e lindjeve nga personeli mjekësor vështrohet si një nga arsyet kryesore të këtij rezultati. Në qarkun e Elbasanit njoftohet se të gjitha lindjet asistohen nga personel i kualifikuar, përfshirë edhe rastet kur lindjet bëhen në banesë, të cilat janë të asistuara nga personel mjekësor.

**Tabela 4.6 Norma e vdekshmërisë amësore për 100,000 lindje të gjalla**

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002
Elbasan	0	38.2	18.8	0	41.7	64.8	24.4	48.8	0	0
Gramsh	0	0	0	219.0	0	0	0	0	0	0
Librazhd	0	0	103.9	0	0	0	0	68.6	0	0
Peqin	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Qarku	0	21.9	32.9	23.4	25.0	37.7	14.7	44.2	0	0
Vendi	19.7	40.2	29.1	32.2	27.5	21.6	20.7	22.6	22.7	26.0

Burimi: Ministria e Shëndetësisë

Pavarësisht nga treguesit pozitivë të vdekshmërisë amësore, mbetet shumë për të bërë në drejtim të shëndetit të nënës. Në këtë aspekt, midis të tjerash, ndihet nevoja e trajnimit të personelit shëndetësor që punon në shërbimet e kujdesit për nënën dhe fëmijën me konceptet bashkëkohore të këtij profesioni.

### 4.3 Mundësia për të pasur shërbime shëndetësore bazë

Në qarkun e Elbasanit, shërbimi shëndetësor parësor pasqyron një sërë problemesh, të lidhura me shpërndarjen e qendrave shëndetësore dhe të ambulancave, pajisjen e tyre me mjetet më të nevojshme dhe nivelin profesional të personelit mjekësor.

#### Qendrat shëndetësore dhe ambulancat

Shërbimi shëndetësor parësor mbështetet në një rrjet ambulancash e qendrash shëndetësore. Numri i ambulancave në qytet varet nga numri i popullsisë, ndërsa çdo komunë duhet të ketë të paktën një qendër shëndetësore në përputhje me tipin standard të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Në secilën qendër shëndetësore duhet të ketë një mjek të përgjithshëm/mjek familje i mbështetur nga infermiere dhe/ose mami. Çdo fshat duhet të ketë të paktën një ambulancë në varësi të qendrës shëndetësore të komunës, ku bën pjesë fshati. Nga 630 qendra shëndetësore që punojnë aktualisht në shkallë vendi, 50 vlerësohet se janë jashtë funksionit dhe nga rreth 2,000 ambulanca që nevojiten për një mbulim normal të popullsisë me shërbime shëndetësore në të gjithë vendin, rreth 1,300 vlerësohet se janë jashtë funksionit.



Në qarkun e Elbasanit funksionojnë aktualisht 64 qendra shëndetësore dhe 229 ambulanca<sup>36</sup>. Si numri i qendrave shëndetësore ashtu edhe ai i ambulancave është zvogëluar dukshëm pas shkatërrimeve nga ngjarjet e vitit 1997 dhe më pas ka filluar të rritet (shih tabelën 4.7). Një prirje e ngjashme vihet re edhe për konsultoret e fëmijëve. Megjithë këtë rritje, numri i ambulancave dhe konsultoreve të fëmijëve mbetet ende më i vogël se ai i vitit 1996.

**Tabela 4.7 Të dhëna për sistemin shëndetësor në qarkun e Elbasanit**

	1996	1997	1998	1999	2000	2002
Qendra Shëndetësore	57	54	51	52	52	64
Ambulanca	240	234	202	203	202	229
Konsultori i fëmijëve	274	266	223	227	227	237
Spitale	7	7	7	7	7	7

Burimi: Ministria e Shëndetësisë


Shkalla e mbulimit me qendra shëndetësore, të ngritura në qendrat e komunave është e mirë (shih tabelën 4.8). Në të gjitha komunat e rretheve Librazhd, Gramsh dhe Peqin ka të paktën një qendër shëndetësore. Në rrethin e Elbasanit ka mungesa të godinave të veçanta të qendrave shëndetësore në dy komuna, në Labinot Fushë dhe Bradashesh. Gjendja fizike e qendrave shëndetësore është e mirë në komunat e Librazhdit, Gramshit dhe Peqinit, sepse ato janë rikonstruktuar ose ndërtuar të reja. Në rrethin e Elbasanit vetëm 45% e godinave ekzistuese janë ndërtuar të reja apo rikonstruktuar gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Situata paraqitet veçanërisht problematike në qendrat shëndetësore të komunave Labinot Mal, Grekan dhe Kajan.

**Tabela 4.8 Shtrirja e qendrave shëndetësore dhe ambulancave në zonat rurale**

	Mbulimi me Qendra Shëndetësore %	Mbulimi me Ambulanca%	Qendra shëndetësore ekzistuese		Ambulanca ekzistuese	
			Rikonstruktuar & ndërtuar të reja (%)	Nga buxheti shtetit (%)	Rikonstruktuar & ndërtuar të reja (%)	Nga buxheti shtetit (%)
Elbasan	91	41.0	45	60	40	96
Gramsh	100	24.4	100	58	60	33
Peqin	100	59.2	100	40	62	100
Librazhd	100	37.8	100	40	17	40

Gjendja është mjaft e ndryshme lidhur me mbulimin e fshatrave të qarkut me ambulancë (shih figurën 4.1). Shkalla e mbulimit është relativisht më e mirë në rrethin e Peqinit, ku rreth 59% e fshatrave kanë godinë ambulance, ndërsa në fshatrat e tre rretheve të tjera të qarkut, shkalla e mbulimit me ambulancë është nën 50%. Më problematike gjendja është në Gramsh, ku vetëm rreth 24% e fshatrave kanë godinë ambulance.

<sup>36</sup> Në qark ka 43 komuna dhe 397 fshatra.



— Kufijtë e Rretheve

Ambulanca



Shpërndarja e ambulancave në zonën rurale | Fig. 4.1

Si rrjedhim, në shkallë qarku vetëm rreth 47.4% e popullsisë që banon në fshat ka mundësi të shkojë në ambulancë (shih tabelën 4.9). Është pozitiv fakti që së fundi ka patur një këmbëngulje të vazhdueshme nga ana e Drejtorive të Shëndetit Parësor ndaj pushtetit vendor në nivel komune për planifikimin paraprak të fondeve për marrjen me qira nga privatet të mjediseve për ambulancë në fshatrat, ku nuk ka të tilla. Me gjithë ndikimin pozitiv që ka kjo masë në disiplinimin e shërbimeve ambulatorë në fshat, kjo mund të quhet vetëm si një zgjidhje e përkohshme, sepse mjediset e marra me qira janë shtëpi banimi dhe në të shumtën e rasteve nuk i plotësojnë kushtet e nevojshme për një qendër të tillë.

**Tabela 4.9 Popullsia në fshatrat që nuk kanë godinë ambulance**

	Banorë Gjithsej	Banorë pa ambulancë	%
Elbasan	109,137	49,545	45.4
Gramsh	25,217	14,269	56.6
Librazhd	55,518	30,714	55.3
Peqin	32,964	11,022	33.4
<b>Qarku</b>	<b>222,836</b>	<b>105,550</b>	<b>47.4</b>

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit janë bërë ndërhyrje me investime për të përmirësuar gjendjen fizike të godinave të qendrave shëndetësore dhe të ambulancave, si nëpërmjet fondeve shtetërore ashtu dhe nëpërmjet fondeve të donatorëve të ndryshëm. Të dhënat dëshmojnë për një përqendrim të financimeve në qendrat shëndetësore, gjë që ka qenë e domosdoshme dhe e frytshme, po të kihet parasysh se ato i shërbejnë gjithë popullsisë së komunës. Ndërkohë, është e nevojshme që të rritet kontributi i strukturave të pushtetit vendor në drejtim të investimeve për ndërtimin e ambulancave të reja apo rehabilitimin e atyre ekzistuese.

Në këtë aspekt, është pozitiv fakti që strukturat e pushtetit vendor në nivel komune kanë filluar të japin shembuj të financimit me fondet e veta për ndërtimin e godinave të ambulancave në fshatra, e kombinuar kjo me pjesëmarrjen e bashkësisë. Rast mjaft shprehës është ndërtimi së fundi i tri ambulancave të reja në komunën e Bradasheshit dhe i një ambulance në komunën e Paprit në rrethin e Elbasanit.

Ndryshimet e theksuara demografike të popullsisë si rrjedhojë e shpërnguljeve të popullsisë, veçanërisht drejt zonave urbane, kanë ridimensionuar edhe nevojat për godina të reja ambulancash dhe qendrash shëndetësore. Kështu, ka fshatra dhe komuna, popullsia e të cilave po pakësohet çdo ditë, ndërsa ka komuna dhe qytete të cilat po përjetojnë në mënyrë të vazhdueshme rritje të numrit të popullsisë së tyre.

Në të gjitha qytetet e qarkut të Elbasanit është nxjerrë në dukje nevoja për shtimin e

ambulancave në zona të ndryshme me përqendrim të lartë të popullsisë, si dhe në komuna, popullsia e të cilave është rritur.

Në kuadrin e sigurimit të mundësisë për të patur shërbime shëndetësore, barazisë në përfitimin e tyre në të gjithë territorin e vendit dhe të përmirësimit të cilësisë së tyre, në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social është parashikuar plotësimi i hartës sanitare të shërbimit parësor, duke synuar që brenda vitit 2006 të plotësohen 100% nevojat për qendra shëndetësore pranë komunave dhe mbi 50% e nevojave për ambulancë pranë çdo fshati, duke siguruar infrastrukturen e nevojshme. **Në qarkun e Elbasanit janë mundësitë që këta tregues të avancohen, duke plotësuar 100% të nevojave me qendra shëndetësore dhe rreth 70% të nevojave me ambulancë. Mund të synohet që plotësimi 100% i nevojave me ambulanca të arrihet deri në vitin 2010.**

### Plotësimi me pajisje dhe mjete mjekësore

Plotësimi me pajisje e mjete i qendrave shëndetësore në përputhje me standardet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë në përgjithësi është nën nivelin e kërkuar, por është krahasimisht më e mirë në komunat e Librazhdit, Gramshit dhe Peqinit, ndërsa në komunat e rrethit të Elbasanit pajisja e tyre me mjetet e nevojshme është në nivelin rreth 60%.

Gjendja e plotësimit me pajisje e mjete e ambulancave për të zhvilluar veprimtarinë në kushte normale vlerësohet se është mjaft e rëndë për të gjithë fshatrat e qarkut. Ambulancat e fshatrave të rrethit Elbasan, Gramsh dhe Librazhd janë të pajisura me mjetet e nevojshme përkatësisht në masën 60%, 14%, 30%, ndërsa në Peqin asnjë ambulancë nuk i ka të gjitha pajisjet e nevojshme sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë. Fondet e pushtetit vendor përdoren për furnizimin e ambulancave me medikamente dhe për kryerjen e ndonjë meremetimi të vogël, por jo për plotësimin e tyre me pajisje dhe mjete mjekësore të nevojshme.

### Personeli mjekësor

Plotësimi i qendrave shëndetësore dhe ambulancave me personelin e nevojshëm mjekësor të mesëm dhe të lartë vlerësohet se është i kënaqshëm. Rrethet e Elbasanit dhe Librazhdit janë të plotësuara në masën 100% me personel të lartë mjekësor, ndërsa rrethet e Gramshit dhe Peqinit, përkatësisht 66% dhe 80% për shkak të mungesave të mjekëve në zonat e thella. Të gjitha rrethet janë të kompletuara me të gjithë personelin e mesëm si në qendrat shëndetësore ashtu dhe në ambulanca, me përjashtim të rrethit të Peqinit ku shkalla e plotësimit është në masën 95%. Kompletimi në shkallë të gjerë të qendrave shëndetësore dhe ambulancave me personelin e mesëm të nevojshëm në të gjithë qarkun ka ardhur si rezultat i hapjes së kurseve 9-mujore të infermierisë, të cilat kanë përgatitur personel të mesëm nga të gjitha fshatrat.

Një objektiv i strategjisë së sektorit të shëndetësisë është sigurimi i një drejtpeshimi në shpërndarjen gjeografike të personelit në sistemin shëndetësor publik. Për këtë, në periudhë afatmesme është parashikuar të kryhet përgatitja e një harte të re për shpërndarjen e personelit sipas kategorive, përmirësimi i strukturave të institucioneve dhe motivimi i personelit që punon në zonat rurale dhe të largëta për të penguar rrjedhjen drejt qyteteve të mëdha.

Megjithatë, shifrat për kompletimin e qendrave shëndetësore dhe ambulancave me personelin e nevojshëm janë të pamjaftueshme për të vlerësuar mundësinë e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore prej popullatës. Në fakt, dalin në dritë gjithnjë e më shumë raste kur mjekët e fshatit janë me banim në qytet dhe, veçanërisht në raste urgjencash, nuk janë të pranishëm për dhënien e ndihmës së parë jashtë orarit zyrtar të punës. Gjithashtu, mjekët nuk zotërojnë të gjitha aftësitë profesionale të domosdoshme për të përballuar rastet që u paraqiten për zgjidhje. Përgjithësisht, mungon një plan për formimim profesional sistematik dhe të qëndrueshëm për personelin mjekësor dhe trajnimet e deritanishme kanë qenë sporadike e tejet të kufizuara nga pikëpamja e numrit dhe tematikës së tyre. Megjithatë, shumica e këtyre nevojave parashikohen të përmbushen në kuadrin e strategjisë kombëtare të sektorit të shëndetësisë dhe janë jashtë përgjegjësi të drejtpërdrejta të strukturave përkatëse në nivel vendor.

#### 4.4 Masat me përparësi

Duke qenë se sektori i shëndetësisë aktualisht është nga sektorët ku ecuria e decentralizimit të përgjegjësi nuk është e madhe, shumica e ndërhyrjeve me përparësi që lidhen me përkujdesjen për shëndetin e nënës e fëmijës programohen dhe financohen në mënyrë të përqendruar në shkallë vendi. Megjithatë, përmbushja e objektivave mund të përshpejtohet dhe ndihmohet me masa shtesë, zbatimi i të cilave varet më shumë nga pushteti vendor dhe nga strukturat e pushtetit qendror në nivel lokal.

- Kryerja e një studimi të plotë mbi sigurimin e mundësisë për të pasur dhe barazisë në përfitimin e shërbimeve shëndetësore në të gjithë territorin e qarkut, përmirësimin e cilësisë së tyre dhe rishpërndarjen optimale të burimeve njerëzore.
- Kompletimi me qendra shëndetësore i qarkut të Elbasanit deri në vitin 2006, duke i dhënë përparësi rrethit të Elbasanit, dhe mbulimi brenda kësaj periudhe në masë 70% i nevojave për ambulanca për të gjitha rrethet, duke u dhënë përparësi zonave me popullsi më të madhe.
- Parashikimi afatgjatë i nevojave për investime në qendrat shëndetësore dhe ambulancat e zonës rurale, i ndërthurur me studimin e shpërndarjes optimale të shkollave, me synim shfrytëzimin e mjediseve të shkollave ekzistuese në fshatrat ku parashikohet ulje e madhe e numrit të nxënësve.

- Vendorsja e një bashkëpunimi institucional midis zyrave të gjendjes civile dhe strukturave të shëndetit publik për të disiplinuar regjistrimin e lindjeve në zonat rurale brenda afateve ligjore. Ky bashkëpunim duhet të shërbejë edhe për mbikëqyrjen e vaksinimit të fëmijëve, në rastin e familjeve që ndryshojnë vendbanim.
- Nxitja dhe mbështetja e fushatave ndërgjegjësuese periodike në të gjitha nivelet nga ana e organeve të pushtetit vendor në bashkëpunim me drejtorinë e shëndetit parësor për kërkesat dhe zbatimin e ligjit nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për Gjendjen Civile”.

## sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm

qëndrueshëm në politikat dhe veprimet e kësaj shtete kundërt i prirjes së brendshme dhe të jashtme brenda vitit 2015. Kështu, sipas planit të punës me ujë të pijshëm dhe ujë të pastruar në banesa të shtetit dhe të bashkëpunimit në objektet e shtetit dhe të bashkëpunimit në atmosferë, për të mbrojtur dhe sipërfaqen e tokës së shtetit dhe të bashkëpunimit, numrin e familjeve me akses në ujë të rrjedhshëm dhe përqindjen e një qyteti të shëndetshëm gjyeno-sanitar. Sipas analizave në nivel komunal, ka të vështirë ta përmbushë këtë objektiv dhe shteti dhe bashkëpunimi në zbatimet e politikave, kuadrit ligjor, burimeve të financimit, përgjegjësimin të publikut etj. për ta përmbushur këtë objektiv deri në vitin 2015 është e dobët.

Problemet që lidhen me garantimin e një mjedisi të qëndrueshëm në qarkun e Elbasanit janë të shumta dhe paraqiten mjaft komplekse. Kjo e vështireson trajtimin e njëkohshëm të tyre, në kushtet kur mendohet se janë të nevojshme investime të mëdha dhe kur burimet financiare janë shumë të kufizuara. Çështja vështirësohet më tej edhe nga fakti se gjatë më se 30 vjetëve të fundit institucionet shtetërore kanë heshtur përballë degradimit të mjedisit në qarkun e Elbasanit, gjë që pasqyrohet qartë në qëndrimin mjaft liberal ndaj ndotjeve industriale, në mungesën e studimeve mbi problemet mjedisore që janë shfaqur, investimet e papërfillshme për përmirësimin e gjendjes dhe mospërfshirja e këtyre problemeve në programet kombëtare të ndërhyrjeve me përparësi në fushën e mjedisit. Prandaj, përzgjedhja e atyre problemeve që kanë ndikimin më kryesor në mjedis dhe janë të mundshme për t'u zgjidhur, mund të ishte një përpjekje e parë realiste drejt përmirësimit të gjendjes. Kjo nuk do të thotë aspak se probleme të tjera të grumbulluara ose të reja janë të parëndësishme, por çështjet e analizuara konsiderohen thjesht si më parësoret për t'u zgjidhur.

Në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social<sup>37</sup> janë përcaktuar këto synime kryesore për periudhën afatmesme 2003-2006 në fushën e mbrojtjes së mjedisit: (i) Të ndalet procesi i degradimit të rëndë mjedisor, që ka ndodhur në këtë dekadë; (ii) Të krijohen kushte për rehabilitimin e zonave të ndotura brenda standardeve minimale të sigurisë; (iii) Të rritet qëndrueshmëria e përdorimit të burimeve mjedisore. Ndërhyrjet do të përqendrohen me përparësi në ato zona ku janë vërejtur nivele të larta të ekspozimit të njerëzve ndaj rrezikut mjedisor. Vëmendja do të përqendrohet, gjithashtu, në ato burime ndotjeje që janë pranë zonave të banuara, që rrezikojnë të dëmtojnë vlera të konsiderueshme ekonomike ose vënë në dyshim zhvillimin, rëndojnë veçanërisht mbi të varfërit.

## 5.1 Ndotjet e trashëguara

Në Qarkun e Elbasanit, Rrethi i Elbasanit konsiderohet se ka grumbulluar pasojat më të mëdha nga ndotja industriale, të cilat e rendisin atë ndër trevat më të ndotura të Shqipërisë. Këto lidhen me zonën industriale dhe veçanërisht me fabrikën e çimentos, kombinatin metalurgjik dhe uzinën e ferro-kromit. Megjithatë, zona me probleme të trashëguara mjedisore ka edhe në rrethin e Librazhdit (miniera e hekur-nikelit dhe fabrika e pasurimit të mineralit në Përrenjas) dhe atë Gramshit (uzina mekanike dhe uzina e baterive).

Përpara vitit 1990 rrethi i Elbasanit quhej si një nga zonat industriale më të rëndësishme të vendit. Industrializimi filloi në vitin 1965 me ngritjen e uzinës së petëzimit të çeliqueve. Më pas, në vitin 1968, filloi punën fabrika e çimentos dhe në periudhën 1976-1977 u vunë në shfrytëzim shumica e uzinave të tjera të Kombinatit Metalurgjik: uzina e koksit,

<sup>37</sup> Këshilli i Ministrave. "Dokumenti i përmirësuar i SKZHES", 23 prill 2003.



aglomerimit, gizës, çelikut, petëzimit të mesëm etj. Në vitin 1981 filloi punë uzina e nikel-kobaltit dhe në vitin 1988 u vu në shfrytëzim uzina e ferro-kromit.

Në përgjithësi teknologjia e përdorur në këto uzina e fabrika nuk bënte kujdes për shkallën e ndotjes së mjedisit, si nga ana e kufizimit të shkarkimeve të gazta, të lëngëta e të ngurta, ashtu edhe në aspektin e përfshirjes në skemat teknologjike të proceseve të trajtimit të mbetjeve. Këto industri nuk mundën të realizonin as treguesit e projektuar të shkarkimeve apo të përpunimit të mbetjeve industriale. Kështu, për shembull, Uzina 12 ka prodhuar koncentrat hekuri për rreth 12 vjet, duke përdorur rreth 6 milion ton mineral hekur-nikeli dhe shkarkuar në atmosferë rreth 25% të tij. Po kështu, TEC-i i kombinatit metalurgjik ka prodhuar avull teknologjik për rreth 24 vjet, duke përdorur rreth 10 milion ton qymyr të dobët me rreth 61% hi dhe shkarkuar në atmosferë rreth 2.6 milion ton hira. Mungesa e kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe e normave të shkarkimeve ndotëse e favorizuan këtë gjendje. Në këtë mënyrë, për një periudhë rreth 25-vjeçare, kjo industri u shndërrua në një ndotës potencial jo vetëm të zonës industriale por edhe të gjithë rrethit të Elbasanit, pasojat e së cilës, ndonëse të pastuduara ende në mënyrë të thellë e të vazhdueshme, vazhdojnë të ndihen gjithnjë e më qartë në ekosistemin dhe në shëndetin e banorëve të trevës së Elbasanit. Gjithashtu, raste të përsëritura të njoftuara deformimesh gjenetike tek kafshët, në mungesë të studimeve të thelluara shkencore, hamendësojnë shpesh lidhje të paprovuara me këto ndotje<sup>38</sup>.

## Shkarkimet e tepruara të pluhurave

Vlera mesatare e përqendrimit të pluhurave në dalje të tre ndotësve më të mëdhenj të rrethit të Elbasanit: oxhaku i fabrikës së çimentos, i uzinës 12 dhe ai i TEC-it, kanë qenë përkatësisht 47-70 gr/m<sup>3</sup>N, 85 gr/m<sup>3</sup>N dhe 67 gr/ m<sup>3</sup>N . Sasia korresponduese e pluhurit apo hirave të shkarkuara në atmosferë vlerësohet të ketë qenë përkatësisht 14,4 kg/ton produkt, 2.1 ton/orë dhe 6.15 ton/orë. Kjo do të thotë se gjatë gjithë periudhës së punës së këtyre industrive nga këto tre burime ndotjeje vetëm pluhura janë shkarkuar në atmosferë rreth 3.5 milion ton<sup>39</sup>. Ky pluhur, me përmbajtje të lartë përbërjesh ndotëse e metalesh të rënda, ka kontaminuar në një shkallë të papërcaktuar qartë tokën dhe ujrat nëntokësore të Elbasanit, duke ndikuar në ujin dhe produktet bujqësore të trevës së Elbasanit. Shkalla e lartë e ndotjes është favorizuar nga imtësia e lartë e pluhurave dhe nga trëndafil i erërave të luginës së lumit Shkumbin<sup>40</sup>. Përveç pluhurave, në atmosferë janë shkarkuar edhe mijëra ton përbërjesh ndotëse të tilla si CO, CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, SO<sub>2</sub> etj.

<sup>38</sup> Njihet që Cr 3 valent që haset në zonën e Elbasanit nuk paraqet rrezik për shëndetin e njerëzve. Nikeli, në vartësi të përshtatshmërisë së tij biologjike me bimësinë, shfaqet toksik dhe pluhurat e hekur-nikelit sjellin sëmundje të rrezikshme të sistemit frymëmarrës.

<sup>39</sup> Llogaritjet janë bërë nga ISP të Metalurgjisë dhe Instituti i Studimeve Mjedisore në bazë të parametrave teknologjikë dhe të kapaciteteve mesatare prodhuese nga fillimi i punës deri në vitin 1990.

<sup>40</sup> Drejtimi kryesor i erës është nga Veri-Lindja në Jug-Perëndim.

Nga disa matje të veçuara mbi përqendrimin e një numri të kufizuar metalesh në tokat brenda dhe jashtë zonës industriale të Kombinatit Metalurgjik, që janë bërë në vitin 1996<sup>41</sup>, rezultojnë përmbajtje të elementeve Cr dhe Ni shumë herë më të larta se të lejuarat nga standardet ndërkombëtare (shih tabelën 5.1). Kampionet e analizuara janë marrë në thellësinë 30-50 cm, e cila përputhet me thellësinë e zhvillimit të pjesës kryesore të sistemit rrënjor të bimëve. Ndotja më e madhe në vendet e marrjes së mostrave del se është deri në thellësinë 35 cm. të tokës.

**Tabela 5.1<sup>42</sup> Përqendrimi i metaleve në tokat e trevës së Elbasanit (në ppm)**

Elementet	Zona industriale			Tokat bujqësore			Vlera maks. të lejuara <sup>43</sup>	
	Maksimale	Minimale	Mesatare	Maksimale	Minimale	Mesatare	Zonë industriale	Tokë bujqësore
Cr	31,170	590	5,663	2,954	344	687	500	200
Ni	9,082	14	1,928	794	167	268	200	75
Co	1,370	16	191	61	16	25	-	300
Cu	246	16	65	96	14	38	300	200
Zn	1,062	63	158	169	61	92	1,000	600
Pb	194	10	44	236	11	26	1,000	1,000

Disa matje të veçuara janë bërë, gjithashtu, për të përcaktuar ndotësit inorganikë në mostrat e ushqimeve me prejardhje shtazore<sup>44</sup>. Këto dëshmojnë grumbullime të plumbit në mëlçitë e kafshëve dhe tejkalime të theksuara të HCB tek qumështi, që mendohet se rrjedhin nga akumulimi i ndotësve në përbërjen e tokës dhe tek bimët (shih tabelën 5.2).

**Tabela 5.2 Ndotësit inorganike**

Ndotësi inorganik	Vlera e matur ppm	Vlera e lejuar ppm	Lloji i mostrës së analizuar
Pb	1.502	0.32	Mëlçi
Hg	0.013	0.05	Ind dhjamor
Cd	0.038	0.05	Ind dhjamor
HCB	0.145	0.05	Qumësht

Ndonëse të pastuduara në mënyrë sistematike, treguesit e sëmundshmërisë dhe paaftësisë në punë në zonat e ndotura të trevës së Elbasanit, rezultojnë, gjithashtu, të larta, krahasuar me zonat e tjera, ku ndotja ka qenë më e paktë.

### Shkarkimet industriale


Shkarkimet industriale ndodhen të depozituara në pesë zona kryesore:

<sup>41</sup> “Studim gjeomjedisor për përcaktimin e ndotjes së tokës dhe të ujërave nga industria metalurgjike”. Instituti i Gjeologjisë Tiranë, ISP të Metalurgjisë, Instituti i Gjeokimisë e Mineralogjisë së Aachenit-Gjermani, tetor 1996.

<sup>42</sup> I njëjti burim. Janë analizuar 9 transversale me 30 deri 50 mostra toke secila.

<sup>43</sup> Sipas standardeve ndërkombëtare të vitit 1980.

<sup>44</sup> Y. TOLA, “Ndotësit mjedisorë të ekozonës së Elbasanit”, maj 2003.



**Ndotja nga zona industriale e Elbasanit | Fig. 5.1**

- (i) Zona buzë lumit Shkumbin me një sipërfaqe rreth 1.5 ha, ku janë depozituar mbetjet e ngurta të furnnaltës, uzinës së çelikut dhe uzinës mekanike. Këto janë skorje furnnalte, skorje çeliku të zeza e të bardha, mbeturina veshjesh zjarrduruese, mbeturina çeliku e gize, okaline etj. në një sasi të përafërt prej 1.5 deri 2 milion tonë. Elementët kryesore ndotës që ato përmbajnë janë metalet e rënda;
- (ii) Dampa e TEC-it, ku janë depozituar sasira të konsiderueshme hiri, që vlerësohet se janë rreth 200-300 mijë ton;
- (iii) Dampa e mbeturinave të uzinës 12 në zonën e Paprit, ku janë të depozituara sasira të mëdha koncentratit hekuri, që vlerësohet se janë rreth 500 mijë ton;
- (iv) Zona e depozitimit të skorjeve të ferrokromit, sasia e përafërt e të cilave është rreth 500 mijë ton;
- (v) Disa zona brenda territorit të kombinatit metalurgjik, ku ka të depozituara hedhurina të uzinave në sasi të mëdha e të papërcaktuara. Një nga këto është pranë ish Uzinës 12, ku janë depozituar rreth 1.1 milion ton pluhura të kapura nga sistemet e pluhurkapjes së kësaj uzine dhe kanë përmbajtje të lartë nikeli.

Në Matricën e Programimit të Veprimeve Prioritare Afatmesme të SKZHES për qarkun e Elbasanit është parashikuar që në periudhën 2004-2006 të kryhet studimi i zbatueshmërisë për zgjidhjen e problemeve mjedisore të shkaktuara nga ish Kombinati Metalurgjik. Burimi i financimit për këtë studim nuk është përfshirë në parashikimet e shpenzimeve të buxhetit të shtetit.

Vendndodhja e këtyre depozitimeve pranë shtratit të lumit Shkumbin ose përrrenjve favorizon kullimin e mbetjeve në ujërat e tyre. Banorët që jetojnë përgjatë brigjeve të lumit, shfrytëzojnë puse private për furnizimin me ujë të pijshëm dhe uji i lumit përdoret për vaditje, ndërkohë që prodhimet bujqësore shiten në të gjithë trevën e Elbasanit. Deri tani nuk është kryer ndonjë vlerësim për shkallën e ndotjes së tokës dhe të ujërave nëntokësore në zonat ku ndikimi i këtyre sedimentimeve mund të jetë më i madh. Një mostër toke që është marrë për qëllime studimi në zonën buzë lumit Shkumbin, ku janë depozituar mbetjet e ngurta të furnnaltës, uzinës së çelikut dhe uzinës mekanike, ka dalë me nivele shumë të larta të kromit, nikelit dhe manganit<sup>45</sup>.

Zona e prekur nga ndotjet e trashëguara, në bazë të analizës së trëndafilit të erërave, të terrenit dhe të rrjedhjeve të lumejve e përrrenjve që ka kjo zonë, mendohet se përfshin rreth 9 komuna, me popullsi rreth 100 mijë banorë, si dhe 3 qytete: Elbasan, Cërrik dhe Peqin, me popullsi rreth 60 mijë banorë. Për nga shtrirja gjeografike, numri i popullsisë dhe dendësia e popullsisë, kjo mund të konsiderohet si zona më e madhe e banuar e ndotur e vendit. Zona e ndotur mund të ndahet në tri pjesë kryesore:

<sup>45</sup> UNEP: "Vlerësimi mjedisor në Shqipëri pas konfliktit". Nairobi-Kenia, nëntor 2000.

(i) **Zona e emergjencës mjedisore** dhe me ndotje të drejtpërdrejt, e cila përfshin zonën industriale dhe “pikat e nxehta” të shkarkimit të mbetjeve industriale. Kjo është dhe zona me ndotje maksimale dhe një burim i vazhdueshëm ndotje për të gjithë trevën nëpërmjet rrjedhjes së ujërave dhe ndotjes së ujërave nëntokësore. Kjo kërkon një studim të hollësishëm të shkallës së ndotjes, të llojit të rreziqeve që paraqet dhe të pasojave që trashëgohen prej saj nga punonjësit e zonës industriale, si dhe përcaktimin e masave që duhen marrë për eliminimin gradual të këtij burimi ndotjeje. Zbatimi i këtyre masave kërkon investime nga shteti dhe nga tri ndërmarrjet ekzistuese private.

(ii) **Zona me ndotje të lartë**, e cila përfshin hapësirën përreth zonës industriale dhe disa komuna në luginën e Shkumbinit. Kjo kërkon një studim të plotë të shkallës së ndotjes së tokës bujqësore, të ujit të pijshëm dhe të ujërave nëntokësore, si dhe përcaktimin e masave që duhen marrë për eliminimin gradual të pasojave. Zbatimi i këtyre masave kërkon investime nga shteti, si dhe kontributin e komunave dhe të bashkësive përkatëse.

(iii) **Zona e ndotur**, e cila përfshin hapësirën e ndotur si rezultat i erërave dhe rrjedhjeve të ujërave. Kjo kërkon një studim të plotë të shkallës së ndotjes së tokës bujqësore, të ujit të pijshëm dhe të ujërave nëntokësore, si dhe përcaktimin e masave që duhen marrë për eliminimin gradual të pasojave. Zbatimi i këtyre masave mund të bëhet me kontributin e komunave dhe të bashkësive përkatëse.

### Depozitime lëndësh të rrezikshme

Në zonën industriale të Gramshit, e cila sot nuk është më në punë, ka të depozituara sasi të konsiderueshme cianuri, pluhuri zhive dhe sasi shumë të mëdha baterish, me përmbajtje të lartë elementesh ndotës, të tilla si plumbi dhe zhiva. Këto përbëjnë një burim ndotjeje me rrezikshmëri të lartë jo vetëm për rrethin e Gramshit, miradministrimi dhe eliminimi gradual i të cilit duhet quajtur si një detyrë parësore. Deri më sot nuk ka dhe nuk janë parashikuar studime mbi masat që duhen marrë për të eliminuar këtë burim ndotje.

## 5.2 Ndotjet e sotme industriale

Burimet më kryesore ndotëse të qarkut të Elbasanit aktualisht janë fabrika e çimentos, uzina e çelikut dhe uzina e ferrokromit, që të tria ndërmarrje private. Këto ndodhen në zonën industriale të rrethit të Elbasanit, e cila aktualisht është një nga zonat më të mëdha industriale të vendit. Sasia dhe përqendrimi i elementeve ndotëse që lëshohen nëpërmjet shkarkimeve të gazta e të ngurta të këtyre uzinave konsiderohet e lartë dhe përbën një burim të vazhdueshëm ndotës, më aktivin në Shqipëri, me pasoja jo vetëm për zonën industriale por për të gjithë trevën e Elbasanit. Mungesa e mbikqyrjes së ndikimit mjedisor të kësaj zone industriale është një nga problemet më të rëndësishme e më parësore për t'u zgjidhur.

## Fabrika e çimentos

Kjo fabrikë është një nga ndotësit më kryesorë të mjedisit në zonën industriale të Elbasanit. Burimi kryesor i ndotjes janë emetimet e pluhurit dhe gazrat që dalin nga furra baraban e pjekjes së klinkerit. Pluhurat janë në sasi të mëdha, rreth 14,4 kg/ton prodhim dhe përqendrimi i tyre në dalje të oxhakut arrin në 47-70gr/m<sup>3</sup>N.

Të dhënat mbi përqendrimin e pluhurave në rrethinat e fabrikës, të cilat janë zona të banuara dhe me prodhim bujqësor, janë mjaft të diskutueshme nga pikëpamja e metodikave të matjeve dhe e normave me të cilat ato krahasohen. Përqendrimi maksimal i pluhurave njoftohet se ka arritur në 0.975 dhe 0.617 mg/m<sup>3</sup> përkatësisht në vitin 2001 e 2002<sup>46</sup>, ndërsa PM10 arrin në 0.075-0.550 mg/m<sup>3</sup><sup>47</sup>, kundrejt përkatësisht 0.5 mg/m<sup>3</sup> dhe 0.07 mg/m<sup>3</sup> që janë normat aktuale<sup>48</sup>. Vlera më e lartë e raportuar nga vetë subjekti industrial për vitin 2002 është 0.617 mg/m<sup>3</sup><sup>49</sup>. Erërat e shpërndajnë këtë pluhur përgjatë gjithë luginës së Shkumbinit.

Drejtuesit e pushtetit vendor të komunës së Bradasheshit, në territorin e së cilës ndodhet zona industriale, shprehin shqetësim të madh për nivelin shumë të lartë të ndotjes. Kur nivelet e shkarkimeve në oxhakun e fabrikës së çimentos janë maksimale, ata bëjnë përpjekje të diskutojnë me drejtuesit e fabrikës, por këta i paraqesin të dhënat e monitorimeve, sikur dalin brenda standarteve ose me tejkalime të vogla. Kjo ndodh edhe me uzinat e tjera. Pushteti vendor nuk ka asnjë kompetencë të ndërhyjë në industrinë që ndodhen brënda territorit administrativ të tij. Këtë kompetencë e kanë institucionet shtetërore, por gjobat që në ndonje rast ato kanë vënë konsiderohen qesharake nga pushteti vendor, krahasuar me dëmin e madh që ata vlerësojnë se i është bërë bashkësisë, që banon përreth zonës industriale, dhe tokës që kjo bashkësi ka në pronësi.

## Uzina e çelikut

Kombinati metalurgjik vazhdon të jetë një ndotës potencial i mjedisit. Prodhimi i çelikut për ndërtim realizohet me një furrë elektrike me kapacitet 15 ton të teknologjisë së viteve '60. Sasia e gazrave (CO, CO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub> etj.) dhe e pluhurave të çliruar që shkarkohen në atmosferë është rreth 140 kg/ton produkt, koncentrimi i pluhurave është mbi 70gr/m<sup>3</sup> dhe ndotja e shkaktuar prej tyre është disa herë më e lartë se normat e Bashkimit Europian. Një gjendje e ngjashme është në sektorin e petëzimit të çelikut, furra e të cilit punon me solar dhe shkarkon në oxhak lënde ndotëse me koncentrim rreth 3 herë më të lartë se këto

<sup>46</sup> Burimi: Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor Elbasan.

<sup>47</sup> Burimi: Instituti i Studimeve Mjedisore Elbasan.

<sup>48</sup> Vlera 0.5 mg/m<sup>3</sup> i referohet normës shtetërore në fuqi, që është ajo e vitit 1974, kur mbrojtjes së mjedisit nga ndotjet industriale nuk i kushtohej asnjë rëndësi. Vlera 0.07 mg/m<sup>3</sup> i referohet normës së OBSH.

<sup>49</sup> Raporti i fabrikës së çimentos i datës 16.10.2002 me rezultatet e matjeve të periudhës 22.7.2002 deri 3.8.2002.

norma. Ndryshimet teknologjike të bëra vitet e fundit nga sipërmarrësit privatë kanë pasur si objektiv kryesisht stabilizimin e prodhimit e rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe nuk kanë ndikuar në pakësimin e ndotjes së mjedisit.

**Tabela 5.3<sup>50</sup> Shkarkimet e elementeve ndotëse në atmosferë gjatë vitit 2002**

Burimi ndotës	Përqendrimi i elementeve ndotëse (gr/Nm <sup>3</sup> )				
	Pluhura	CO	CO <sub>2</sub>	NO <sub>2</sub>	SO <sub>2</sub>
Furra elektrike	48	29.8	56	-	10.3
Norma <sup>51</sup>	0.075	1	-	-	0.4
Furra ngrohëse	0.3	1.4	94	5.7	0.33
Norma	0.1	0.17	-	1.7	0.45
Furra e ferro-kromit	35	151	793	1.01	69.3
Norma	0.075	1	-	-	0.4

Sasitë vjetore të shkarkimeve të elementeve ndotës në atmosferë vazhdojnë të jenë mjaft të larta. Në tabelën 5.3 jepen vlerat e shkarkimeve që dalin nga llogaritjet periodike, duke marrë për bazë parametrat teknologjikë të pajisjeve, lëndët djegëse që përdorin, prodhimtarinë dhe kohën e punës së agregateve kryesore gjatë një viti. Si rezultat i këtyre shkarkimeve, vazhdojnë të dalin mjaft të larta edhe koncentrimet e elementeve ndotëse në ajër (shih tabelën 5.4), të cilat për shumicën e komponentëve pothuajse janë dyfishuar në 5-6 vjetët e fundit.

**Tabela 5.4<sup>52</sup> Ndotja e ajrit në rrethinat e kombinatit metalurgjik (mikrogram/m<sup>3</sup>)**

Viti	LGS		PM10		BLOZA		SO <sub>2</sub>		NO <sub>2</sub>		CO	
	Mes	Max	Mes	Max	Mes	Max	Mes	Max	Mes	Max	Mes	Max
1997	285	785	112	254	95	240	39	71	34	58	730	1,024
1998	342	892	152	312	114	262	42	76	48	80	840	1,112
1999	444	1,031	178	458	122	264	48	104	46	88	840	1,081
2000	532	1,255	222	650	158	299	44	112	49	92	1,225	1,420
2001	638	1,380	285	680	189	304	52	114	54	94	1,117	1,335
2002	644	1,860	340	750	245	505	68	128	62	122	1,140	1,450
Norma <sup>53</sup>	500	1,000	80		50	150	150	500	150	500	2,000	6,000
OBSH <sup>54</sup>	120		70		50		50		40		500	

Të tria industritë kryesore të rrethit të Elbasanit janë duke bërë disa përmirësime në sistemet e pluhurkapjes, të cilat synojnë uljen e ndjeshme të shkarkimit të pluhurave në atmosferë<sup>55</sup>. Në uzinën e çelikut gjatë vitit 2002 filluan punimet për instalimin e një furre elektrike me hark me kapacitet 50 ton, që është rreth 3-fishi i kapacitetit të furrës ekzistuese, e cila është e pajisur me një sistem pluhurkapës, që mund të ndikojë dukshëm në uljen e

<sup>50</sup> ISP të Metalurgjisë: "Monitorimi i shkarkimeve ndotëse nga ndërmarrjet metalurgjike të qarkut të Elbasanit", mars 2003.

<sup>51</sup> Në mungesë të normave të shkarkimit për objektet prodhuese ekzistuese, janë paraqitur normat për objektet prodhuese të reja, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 435 dt. 12.09.2002.

<sup>52</sup> Sipas të dhënave Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor.

<sup>53</sup> Norma shqiptare e vitit 1974.

<sup>54</sup> Norma e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e vitit 1999.

<sup>55</sup> Sipas të dhënave të Agjencisë Rajonale të Mjedisit

shkallës së ndotjes së mjedisit nga kjo uzinë. Në uzinën e ferro-kromit është kryer rikonstruksioni i njërës prej furrave të shkrirjes, duke instaluar edhe një sistem pastrimi pluhurash. Në fabrikën e çimentos janë bërë përmirësime të vazhdueshme për hermetizimin e linjës teknologjike dhe pakësimin e ndotjes dhe parashikohet që së shpejti të instalohet sistemi i pluhurkapjes në oxhak.

Krahas këtyre shkarkimeve, nga procesi teknologjik del një sasi e konsiderueshme lëndësh të ngurta, të cilat kanë në përbërjen e tyre elementë ndotës. Sasitë vjetore të këtyre shkarkimeve jepen në tabelën 5.5. Këto depozitohen në të njëjtat sheshe, ku janë depozituar shkarkimet e periudhës para vitit 1990.

**Tabela 5.5<sup>56</sup> Shkarkimet e lëndëve të ngurta (ton/vit)**

Burimi	Sasia e shkarkuar gjatë vitit 2002				
	Skorje të zeza	Skorje të bardha	Mbetje të ngurta	Okaline	Skorje
Furra elektrike	13,693	725	806		
Katanka		1972			
Furra e ferro-kromit					50,052

### Uzina e ferrokromit

Industria e kromit në zonën industriale të Elbasanit është, gjithashtu, një ndotës potencial, duke shkarkuar në atmosferë për çdo ton ferro-krom të prodhuar rreth 1,000 m<sup>3</sup> gaz. Përbërësit kryesorë të gazit janë CO (55-70%), CH<sub>4</sub> (1.8-6%), C<sub>n</sub>H<sub>m</sub> (9-14%), CO<sub>2</sub> (6-12%) dhe N<sub>2</sub> (7-10%). Shkarkimet e furrave elektrike përmbajnë, gjithashtu, elemente toksike të tilla si SO<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, NH<sub>3</sub> dhe POM, si në gjendje të gaztë ashtu edhe në formë grimcash. Furrat elektrike shkarkojnë edhe rreth 70 gr/m<sup>3</sup> grimca të ngurta, të cilat kanë në përbërjen e tyre SiO<sub>2</sub> (30%), MgO (40%), Al<sub>2</sub>O<sub>3</sub> (6%), Cr<sub>2</sub>O<sub>3</sub> (10%) dhe Fe<sub>2</sub>O<sub>3</sub> (6%)<sup>57</sup>. Në tabelën 5.3 jepen sasitë vjetore të disa prej elementëve ndotës të shkarkuar në atmosferë.

Industria e kromit shkarkon, gjithashtu, një sasi të konsiderueshme skorje (shih tabelën 5.5), e cila depozitohet në të njëjtin shesh depozitimi të periudhës para vitit 1990.

Monitorimi i mjedisit në Qarkun e Elbasanit kryhet nga institucione të specializuara dhe mbështetet nga buxheti i shtetit. Vitet e fundit është arritur të monitorohet cilësia e ajrit, ujërave sipërfaqësore dhe biodiversitetit. Të dhënat e matjeve publikohen çdo dy vjet në raportet zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, si dhe bëhen të ditura periodikisht për publikun nga Agjencia Rajonale e Mjedisit. Por baza materiale për monitorimin është e amortizuar, metodikat janë të vjetruara dhe të

<sup>56</sup> ISP të Metalurgjisë: "Monitorimi i shkarkimeve ndotëse nga ndërmarrjet metalurgjike të qarkut të Elbasanit", mars 2003.

<sup>57</sup> DAPPOLONIA: "Masat imediate për zbatimin e Planit Mjedisor të Veprimt" financuar nga Banka Botërore, qershor 2001.



paunifikuara dhe fondet në dispozicion janë të pamjaftueshme për të realizuar një monitorim korrekt e sipas kërkesave ligjore. Ligji ngarkon, gjithashtu, subjektet publike e private të kryejnë vetë monitorimin e shkarkimeve ndotëse nëpërmjet laboratorëve të akredituara dhe të raportojnë të dhënat në Agjencinë Rajonale të Mjedisit. Por, deri më sot, në Qarkun e Elbasanit nuk ka asnjë laborator të tillë. Instituti i Studimeve e Projektive Metalurgjike, i bazuar në aftësitë njerëzore, përvojën dhe pajisjet matese që ka, po bën përpjekje për krijimin e një njësie monitoruese të pavarur të ndotjes së zonës industriale.

### 5.3 Ndotjet urbane

Niveli i ndotjes së mjedisit urban në qarkun e Elbasanit ndiqet nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit me matje periodike. Programi i monitorimit përgjithësisht është modest dhe i kufizuar në kohë e në hapësirë. Ai bazohet në rreth 5 matje në muaj në një pikë të vetme brenda qytetit të Elbasanit, në lartësi 10 metra. Nga ana tjetër, mungesa e zbatimit të programeve të kontrollit të cilësisë së analizave lë të hapur problemin e shkallës së besueshmërisë së të dhënave<sup>58</sup>. Matje janë bërë edhe nga vetë industrinë, si dhe nga ISP të Metalurgjisë. Megjithë kufizimet, përgjithësisht del se, në qarkun e Elbasanit, qyteti i Elbasanit është më shumë i zbuluar ndaj ndotjes urbane.

#### Ajri

Të dhënat e përafërta të monitorimit të ajrit në qytetin e Elbasanit tregojnë praninë e konsiderueshme të disa elementeve ndotës dhe rritjen 2-3 herë të përqendrimeve të tyre në 5-6 vjetët e fundit (shih tabelën 5.6). Përqendrimeve të pluhurave janë veçanërisht të larta. LGS dhe PM10 në vitin 2002 kanë dalë përkatësisht rreth 3 dhe 2 herë më të larta se normat ndërkombëtare dhe më të lartat e zonave urbane të vendit, duke përjashtuar vetëm një pjesë të qytetit të Tiranës. Edhe vlerat e matura të SO<sub>2</sub>, ndonëse dalin brenda normave, janë më të lartat e zonave urbane të vendit.

Kjo ndotje është pasojë kryesisht e shkarkimeve të zonës industriale, por ka filluar të ndikohet edhe nga rritja e madhe e numrit të automjeteve. Në vitin 2002 ky numër është rritur në nivel qarku me 3,651 automjete krahasuar me një vit më parë<sup>59</sup>, duke e çuar në rreth 15,000 numrin e automjeteve. Në qytetin e Elbasanit qarkullojnë rreth 10,000 automjete gjatë 24 orëve. Nga këto, vetëm rreth 2,000 mjete përdorin benzinën si lëndë djegëse. Kështu që, siç rezulton nga llogaritjet, gjatë vitit 2002 vetëm nga automjetet janë shkarkuar në atmosferë rreth 740 ton CO, 260 ton hidrokarbure, 65 ton SO<sub>2</sub>, 450 ton NOx dhe 100 ton grimca të ngurta<sup>60</sup>.

<sup>58</sup> INSTAT. «Vjetari statistikor 1993-2001», Tiranë, janar 2003.

<sup>59</sup> Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor

<sup>60</sup> Burimi: Instituti i Studimeve Mjedisore Elbasan.

Tabela 5.6<sup>61</sup> Ndotja e ajrit në qytetin e Elbasanit (mikrogram/m<sup>3</sup>)

Viti	LGS		PM10		BLOZA		SO <sub>2</sub>		NO <sub>2</sub>		O <sub>3</sub>	
	Mes	Max	Mes	Max	Mes	Max	Mes	Max	Mes	Max	Mes	Max
1997	95	485	65	202	63	198	18	42	26	72	-	-
1998	118	522	81	216	75	200	20	58	28	68	-	-
1999	155	638	91	258	88	282	20	64	26	74	-	-
2000	216	600	101	385	91	283	22	35	28	45	24	55
2001	279	1,352	144	475	133	345	25	55	23	42	21	85
2002	366	1,381	175	503	168	425	38	96	33	105	57	84
Norma <sup>62</sup>	500				50		150		150			
OBSH <sup>63</sup>	120		70		50		50		50		120	

Lëshimet drejtpërdrejt në atmosferë të gazeve që shkaktojnë ndotje atmosferike u llogaritën për herë të parë në Shqipëri në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare në vitin 1999, duke marrë vitin 1994 si vit bazë. Sipas këtyre llogaritjeve, bioksidi i karbonit CO<sub>2</sub> është gaz kryesor i emetuar në Shqipëri. Rreth 63% e çlirimeve të këtij gazi vjen nga sektori i energjisë dhe i transporteve. Një pjesë tjetër, rreth 33% prodhohet nga pyjet dhe ndryshimet në përdorimin e tokës. Meqenëse nivelet e çlirimit të CO<sub>2</sub> janë të ulta, Shqipëria nuk ka ndonjë detyrim të drejtpërdrejt ndërkombëtar për marrjen e masave të veçanta për uljen e këtyre niveleve<sup>64</sup>.

### Hedhurinat e gurta urbane

Në përgjithësi në Shqipëri koncepti i miradministrimit të hedhurinave urbane përfshin më shumë mbledhjen e tyre në zonat e banuara dhe transportin për në sheshet e grumbullimit. Nuk ka vende trajtimi apo djegieje të këtyre hedhurinave të miradministruara nga shteti dhe as objektiva të qarta për depozitim dhe mbikëqyrjen e tyre. Hedhurinat e gurta shkarkohen në vende të papërshtatshme e jo shumë larg zonave të banuara, zakonisht pranë lumenjve e përrenjve, uji i të cilëve përdoret nga popullsia e fshatrave pranë shtrazit të tyre. Ato zakonisht digjen pa asnjë kriter dhe e ndotin rëndë mjedisin përreth. Duke pasur parasysh përmbajtjen e hedhurinave të gurta, në këto sheshe depozitimi ka kushte për t'u çliruar metan dhe grimca pluhuri me përmbajtje metalesh të rënda, si dhe përbërje të tjera inorganike e organike si dioksina, furane etj. Në mostra të analizuar të ajrit janë gjetur derivate të benzenit, gazra të efektit serrë dhe freone<sup>65</sup>.

Një gjendje e tillë shqetësuese vihet re në të gjitha zonat urbane të qarkut të Elbasanit, por në mënyrë të veçantë në katër bashkitë kryesore. Sasitë e hedhurinave të gurta janë rritur dukshëm në dhjetë vjetët e fundit (shih tabelën 5.7), duke arritur në rreth 0.7 deri 0.9 kg/

<sup>61</sup> Burimi: Instituti i Shëndetit Publik dhe Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor.

<sup>62</sup> Norma shqiptare e vitit 1974 (Instituti i Shëndetit Publik).

<sup>63</sup> Norma e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e vitit 1999 (Instituti i Shëndetit Publik).

<sup>64</sup> Ministria e Mjedisit. "Raport i gjendjes së mjedisit 1999-2000". Tiranë, shkurt 2002.

<sup>65</sup> UNEP: "Vlerësimi mjedisor në Shqipëri pas konfliktit". Nairobi-Kenia, nëntor 2000.

frymë, ndërkohë që vëmendja për përmirësimin e administrimit është përqendruar kryesisht në organizimin e punës për largimin e tyre nga zonat e banuara. Në këtë aspekt janë bërë disa investime për mjetet e grumbullimit e të transportit, duke shfrytëzuar ndihmat e huaja dhe investimet nga pushteti vendor.

**Tabela 5.7 Sasitë optimale të hedhurinave të gurta urbane**

Qyteti	Popullsia	Sasia ton/ditë
Elbasan	86,148	77
Librazhd	7,216	5
Gramsh	10,533	8.5
Peqin	7,267	5

Hedhurinat e gurta urbane të qytetit të Elbasanit janë grumbulluar prej vitesh buzë lumit të Shkumbinit pa asnjë përpunim. Ndotjes së madhe dhe rrezikut për shëndetin aktualisht i është shtuar edhe problemi i tejkallimit të kapacitetit mbajtës të sheshit të depozitimit, që ka çuar në shkarkimet e hedhurinave vend e pa vend. Parashikohet që pas rreth 6 muajsh e gjithë sasia e hedhurinave do të shkarkohet jashtë sheshit të depozitimit. Nevojës urgjente për një shesh të ri pushteti vendor i ka paraprirë me një studim zbatueshmërie për një shesh të ri depozitimi hedhurinash të gurta urbane dhe me projektin përkatës, por investimet e nevojshme nuk janë përfshirë në asnjë nga parashikimet buxhetore afatmesme.

**Tabela 5.8 Perspektiva e ndërtimit të shesheve të reja të depozitimit**

Qyteti	Studim	Projekt	Financim
Elbasan	+	+	-
Librazhd	+	-	-
Gramsh	+	-	-
Peqin	-	-	-

Edhe në qytetet e tjera kryesore të qarkut gjendja e shesheve të depozitimit të hedhurinave është e ngjashme, ndonëse në përmasa më të vogla, për shkak se sasitë e hedhurinave janë më të vogla. Në Librazhd e Peqin ato janë pranë lumit të Shkumbinit, ndërsa në Gramsh pranë lumit të Devollit. Perspektiva e ngritjes së shesheve të reja të depozitimit, që respektojnë kërkesat mjedisore, është e paqartë për shkak të mungesës së projekteve dhe financimeve (shih tabelën 5.8).

Sipas studimit të përgatitur për qytetin e Elbasanit<sup>66</sup>, është bërë një përzgjedhje e sheshit të ri të depozitimit të hedhurinave të gurta urbane me sipërfaqe të përgjithshme 40,000 m<sup>2</sup> dhe kapacitet depozitimi rreth 300,000 m<sup>3</sup>, i cili mund të zgjidhë plotësisht problemin e këtij qyteti për një periudhë deri 15-vjeçare. Zona e përfshirë në studim është tokë bujqësore shumë e ndotur, për shkak të aktivitetit industrial të fabrikës së çimentos, dhe e vlerësuar si e papërshtatshme për bujqësinë. Ky shesh është miratuar edhe nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit. Vlera e përgjithshme e investimit për këtë projekt është rreth 1.2-1.6 milion euro. Deri tani nuk ka asnjë angazhim për të financuar tërësisht ose pjesërisht këtë projekt, me gjithë urgjencën që kërkon zgjidhja e këtij problemi.

Në qytetet e tjera më të vogla, grumbullimi i hedhurinave urbane bëhet pa asnjë kriter e fare pranë ndërtesave të banimit dhe përbën një burim të rrezikshëm ndotjeje për qytetarët e sidomos për fëmijët.

## 5.4 Pyjet

Në qarkun e Elbasanit përfshihet rreth 12% e sipërfaqes së përgjithshme të mbuluar me pyje të vendit, me një vëllim total rreth 1.2 milion m<sup>3</sup> (shih tabelën 5.9), apo rreth 14% të vëllimit të fondit pyjor kombëtar, gjë që tregon se fondi pyjor përfaqëson për qarkun një potencial të rëndësishëm me ndikim të madh mjedisor dhe ekonomik. Përqendrimi më i madh i pyjeve është në rrethin e Librazhdit, ndërsa për rrethin e Peqinit fondi pyjor është mjaft i vogël.

**Tabela 5.9 Fondi pyjor i qarkut të Elbasanit<sup>67</sup>**

Rrethi	Sipërfaqja ha	Nga këto			Vëllimi m <sup>3</sup>
		Shtetërore	Komunale	Private	
Elbasan	38,440	22,190	16,250	-	2,775,000
Gramsh	34,960	22,950	12,010	-	3,387,000
Librazhd	51,510	35,240	16,170	100	5,545,000
Peqin	3,130	440	2,680	10	51,000
<b>Qarku</b>	<b>128,040</b>	<b>80,820</b>	<b>47,110</b>	<b>110</b>	<b>11,758,000</b>

Gjatë dhjetë vjetëve të fundit pyjet kanë pësuar dëmtime të ndjeshme. Dëmtimet më të mëdha kanë ardhur nga prerjet abuzive, të cilat janë bërë më shumë në sipërfaqet e pyllëzuara me plep dhe akacie pranë zonave të banuara, duke i kthyer këto nga sipërfaqe të pyllëzuara në sipërfaqe me bimësi pyjore. Në nivel qarku vlerësohet se këto dëmtime përfaqësojnë një sipërfaqe prej rreth 2,000 ha, nga të cilat rreth 750 ha në rrethin e Elbasanit, 650 ha në rrethin e Gramshit dhe 440 ha në rrethin e Peqinit. Rifitimi i këtij fondi pyjor të shkatërruar bëhet i mundur vetëm me anë të ripyllëzimit të sipërfaqes, kostoja mesatare e të cilit është rreth 140,000 lek/ha.

<sup>66</sup> ECOLOGIA ITALIA. "Administrimi i mbetjeve të gurta urbane në 6 bashkitë kryesore të Shqipërisë". Maj 1999.

<sup>67</sup> Burimi: Drejtoria Rajonale e Pyjeve dhe Kullotave Elbasan.

Dëmtime janë bërë edhe në pyjet e tjera nga prerjet abuzive, sidomos deri në lartësinë 700 metra mbi nivelin e detit. Rifitimi i këtij fondi pyjor bëhet i mundur vetëm me anë të ringritjes<sup>68</sup> së pyjeve, kostoja mesatare e të cilit është rreth 30,000 lek/ha.

Masat kryesore të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social për sektorin e pyjeve janë: (i) vazhdimi i kalimit të pyjeve dhe kullotave në pronësi ose përdorim të komunave; (ii) përmirësimi i strukturave të menaxhimit dhe kontrollit të shfrytëzimit të pyjeve; (iii) fuqizimi i shërbimeve pyjore për rehabilitimin dhe mbrojtjen e pyjeve. Në Matricën e Programit të Veprimeve Prioritare Afatmesme 2003-2006 janë parashikuar si tregues monitorimi sipërfaqja e pyjeve e administruar nga komunat dhe sipërfaqja e ripyllëzuar.

Gjatë dhjetë vjetëve të fundit investimet në këtë sektor për qarkun e Elbasanit kanë qenë shumë të kufizuara, prandaj edhe sipërfaqet e pyjeve të ringritura dhe ato të pyllëzuara janë të vogla (shih tabelën 5.10). Pjesa më e madhe e këtyre investimeve janë financuar nga Banka Botërore<sup>69</sup> dhe nga buxheti i shtetit. Po të ruhen këto ritme investimesh, deri në vitin 2015, rikthimi i pyjeve në gjendjen e para vitit 1991 do të jetë mjaft i vështirë dhe rritja e sipërfaqes së pyllëzuar dhe e vëllimit të pyjeve do të jetë e papërfillshme.

**Tabela 5.10 Shtimi i fondit pyjor**

Rrethi	1992-2002		2003-2005		2006-2010		2011-2015	
	Pyllëzim	Ringritje	Pyllëzim	Ringritje	Pyllëzim	Ringritje	Pyllëzim	Ringritje
Elbasan	351	718	70	300	50	350	150	400
Gramsh	43	800	50	1,000	100	2,500	250	2,500
Librazhd	40	2,782	50	1,000	400	1,500	400	2,000
Peqin	16		200	150	250	150	200	250
<b>Qarku</b>	<b>450</b>	<b>4,300</b>	<b>370</b>	<b>2,450</b>	<b>800</b>	<b>4,500</b>	<b>1,000</b>	<b>5,150</b>
<i>Investime (mijë lekë)</i> <sup>70</sup>	63,000	129,000	51,800	73,500	112,000	135,000	140,000	154,500

Shtimi i fondit pyjor në qarkun e Elbasanit mund të bëhet me anë të ringritjes së pyjeve ekzistuese dhe pyllëzimeve, ku përfshihen pyllëzimi i sipërfaqeve boshe ose i tokave të braktisura të ish fondit bujqësor, dhe ripyllëzimet. Nisur nga gjendja e fondit pyjor të qarkut, nga analiza e koston për çdo proces dhe nga një parashikim realist i mundësive për investime, rezulton se, për një periudhë afatmesme, ringritja është më parësore se pyllëzimi. Kostoja e saj është rreth 4 herë më e ulët dhe bashkësia është shumë më e interesuar për këtë proces. Në tabelën 5.10 paraqitet një skenar për rritjen me rreth 2,200 ha të sipërfaqes së pyllëzuar dhe ringritjen e një fondi pyjor prej rreth 12,000 ha., i cili vlerësohet si mjaft

<sup>68</sup> Ringritja nënkupton cungimin (prerjen), pastrimin dhe ruajtjen.

<sup>69</sup> Projekti i pyjeve i Bankës Botërore.

<sup>70</sup> Kostoja e pyllëzimit është marrë 140,000 l/ha dhe e ringritjes 30,000 l/ha

i frytshëm dhe realist nga specialistët, por që mbështetet në rritjen e interesit dhe të kontributit të bashkësisë për ringritjen e pyjeve<sup>71</sup>.

Frenimi i degradimit të pyjeve të lisit dhe ringritja e tyre vlerësohet si mjaft parësore. Pyjet e lisit rriten nën lartësinë 700 m mbi nivelin e detit dhe, duke qenë më pranë zonave të banuara, janë ekspozuar shumë më tepër ndaj dëmtimeve<sup>72</sup>. Në qarkun e Elbasanit këto zënë një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 28,750 ha, nga të cilat rreth 2,000 ha vlerësohen si mjaft të dëmtuara. Degradimi nga prerjet abuzive është më i theksuar në rrethin e Elbasanit dhe më tipik në komunën e Labinotit Mal. Në këtë komunë ka rreth 700 ha pyje që kanë nevojë të ringrihen.

Kjo lidhet ngushtë me kalimin e administrimit të sipërfaqeve të pyllëzuara tek bashkësia, si një masë tjetër parësore me efekte të dukshme në frenimin e degradimit të pyjeve dhe në ringritjen e pyjeve të dëmtuara. Aktualisht pothuajse i gjithë fondi pyjor i qarkut është pronë shtetërore, rreth 62% e tij administrohet nga shteti dhe pothuajse e gjithë pjesa tjetër nga komunat për plotësimin e nevojave të komunitetit (shih tabelën 5.9). Duke mos i pasur në pronësi, komunat janë të interesuara vetëm t'i shfrytëzojnë pyjet dhe jo t'i ringrenë ato. Në qarkun e Elbasanit janë të gjitha mundësitë që, në përputhje me objektivin e vënë në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, brenda një periudhe afatmesme fondi pyjor të kalojë në administrimin e komunave sipas parashikimit të bërë në këtë strategji.

## 5.5 Zonat e mbrojtura

Në qarkun e Elbasanit ndodhen 7 zona të mbrojtura të miratuara, me një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 10,000 ha, nga të cilat zona e Rrajcës është shpallur “zonë natyrore strikte” (shih tabelën 5.11).

Në ligjin nr. 8906, datë 6.06.2002, “Për zonat e mbrojtura”, janë përcaktuar rregullat për shpalljen, ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe të burimeve natyrore biologjike të tyre. Sipas këtij ligji, në zonat e shpallura “Rezervë natyrore strikte” zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes dhe janë të ndaluara prerja e drurëve dhe e shkurreve, përdorimi i kimikateve, gjuetia, kalimi i kafshëve shtëpiake, ndërtimet e çdo lloji etj. Në zonat “Rezervë natyrore e menaxhuar” zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe ndalohen ndryshimi

<sup>71</sup> Disa investime shtesë janë të nevojshme për sistemime malore.

<sup>72</sup> Në fakt, në qarkun e Elbasanit, pyjet e ahut dalin më pak të dëmtuara.

i gjendjes natyrore, depozitimi i kimikateve etj. Ligji ngarkon Ministrinë e Mjedisit, organet e tjera shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore të hartojnë planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura. Plani i menaxhimit përfshin objektivat e menaxhimit të zonës së mbrojtur, mekanizmat dhe autoritetin drejtues, veprimtaritë e lejuara dhe të ndaluara etj. Ndryshimi i statusit të zonës së mbrojtur bëhet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Mjedisit.

**Tabela 5.11 Zonat e mbrojtura të qarkut të Elbasanit<sup>73</sup>**

Rrethi	Emërtimi	Sipërfaqja ha	Përshkrimi	Miratuar
Librazhd	Rrajca	4,700	Rezervë natyrore strikte	15.01.1996
Librazhd	Kuturman	3,600	Rezervë natyrore e menaxhuar	5.11.1977
Librazhd	Polis	45	Rezervë natyrore e menaxhuar	15.01.1996
Librazhd	Stravaj	400	Rezervë natyrore e menaxhuar	15.01.1996
Librazhd	Sopot	300	Rezervë natyrore e menaxhuar	15.01.1996
Librazhd	Qarrishtë	318	Rezervë natyrore e menaxhuar	15.01.1996
Librazhd	Dardhë-Xhyrë	400	Rezervë natyrore e menaxhuar	15.01.1996
Elbasan	Qafë-Bushi	500	Rezervë natyrore e menaxhuar	5.11.1977
<b>Qarku</b>		<b>10,263</b>		

Gjendja e zonave të mbrojtura është mjaft e keqe dhe ruajtja e përkujdesja për to e papërfillshme. Plane menaxhimi nuk janë hartuar për asnjë nga zonat e mbrojtura të qarkut të Elbasanit dhe për disa prej tyre kufijtë nuk janë shënuar në terren.

Në rrethin e Librazhdit, në Rrajcë, një sipërfaqe prej rreth 1,000 ha është dëmtuar rëndë për shkak të afërsisë me zonat e banuara (fshatrat Bardhaj dhe Skënderbej) dhe nuk ka më vlerat e një rezerve natyrore strikte. Po kështu, në Kuturman është dëmtuar një sipërfaqe prej rreth 300 ha në afërsi të fshatit Mirakë dhe vazhdon presioni i bashkësisë për të ndryshuar statusin e zonës. Një gjendje e ngjashme është në Qafën e Bushit të rrethit të Elbasanit, e cila është dëmtuar rëndë nga prerjet e paligjshme, kullotja e bagëtive dhe mungesa e administrimit, si dhe në zonat e tjera të mbrojtura.

Rivlerësimi i zonave të mbrojtura ekzistuese dhe hartimi i planeve të menaxhimit të tyre mund të konsiderohen si masat më urgjente që duhen marrë për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të tyre. Po kështu, forcimi i administrimit dhe i mirëmbajtjes së zonave ekzistuese në rrethin e Librazhdit dhe të Elbasanit, kanë përparësi në krahasim me kërkesat për shpalljen e zonave të reja të mbrojtura. Në rrethin e Librazhdit janë mundësitë, gjithashtu, për të shtuar sipërfaqen e zonave të mbrojtura të Stravajt, Dardhë-Xhyrë, Polis dhe Qarrishtë me rreth 1,000 ha. Në rrethin e Gramshit janë mundësitë për ta trajtuar si zonë të mbrojtur një sipërfaqe prej rreth 1,600 ha në Gjozezë dhe Shmitër. Kjo do të thotë se sipërfaqja e zonave të mbrojtura të qarkut të Elbasanit mund të rritet gjithsej rreth 1,300 ha.

<sup>73</sup> INSTAT. Vjetari statistikor 1993-2001. Tiranë, janar 2003.

## 5.6 Mundësitë për furnizim me ujë të pijshëm

Sipas të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë<sup>74</sup> rreth 11% e familjeve në qarkun e Elbasanit nuk furnizohen me ujë, ndërsa të tjerat kanë ujë brenda apo jashtë banesës ose furnizohen me ujë pusi (shih tabelën 5.12). Më keq paraqitet gjendja në rrethin e Peqinit, ku rreth ¼ e familjeve nuk kanë furnizim me ujë.

Tabela 5.12 Familje që nuk furnizohen me ujë

Rrethi	Nr. familjeve	% e familjeve që nuk furnizohen me ujë		
		Zona urbane	Zona rurale	Gjithsej
Elbasan	53,071	1	14.6	8.3
Gramsh	7,635	0.8	18	12.3
Librazhd	15,327	0.4	18.4	15.1
Peqin	7,023	2.1	30.8	23.7
Qarku	83,056	1	17.5	11

Mungesa e furnizimit me ujë është një dukuri tipike për zonën rurale të qarkut, ku vetëm rreth 10% e familjeve kanë ujë brenda banesës (shih tabelen 5.13) dhe, nga kjo anë, gjendja është pothuajse e njëjtë në të katër rrethet.

Në nivel qarku, rreth 17.5% e familjeve të zonës rurale nuk kanë furnizim me ujë të pijshëm. Më keq paraqitet gjendja në zonën rurale të rrethit të Peqinit, ku rreth 31% e familjeve nuk kanë furnizim me ujë. Në disa fshatra uji mungon plotësisht për shumicën e familjeve. Në nivel qarku, uji mungon për më shumë se 70% të familjeve në 40 fshatra, nga të cilët në 20 fshatra mungon për më shumë se 90% të familjeve. Nga këto, 3 fshatra janë të rrethit të Elbasanit, 1 fshat në rrethin e Librazhdit, 10 fshatra në rrethin e Gramshit dhe 6 fshatra në rrethin e Peqinit. Në planet afatshkurtra të investimeve nuk është përfshirë pothuajse asnjë prej këtyre fshatrave, sepse i është dhënë përparësi përmirësimit të gjëndjes së furnizimit me ujë të familjeve me ujë jashtë banesës ose që furnizohen me ujë pusi. Prandaj është e nevojshme që investimet të shqyrtojnë me përparësi ndërhyrjet në këto fshatra, të paktën për t'u siguruar furnizimin me ujë jashtë banesës.

<sup>74</sup> INSTAT, Repoba 2001.



**Tabela 5.13 Furnizimi me ujë i zonës rurale**

Rrethi	Nr. i familjeve	% familjeve me ujë brenda banesës	% familjeve me ujë jashtë banesës	% familjeve me pus	% familjeve pa ujë
Elbasan	28,486	8.8	53.2	23.5	14.6
Gramsh	5,132	11.2	64	6.8	18
Librazhd	12,556	12.6	66	3	18.4
Peqin	5,294	6	23.3	40	30.8
Qarku	51,468	9.6	54.3	18.4	17.5

Kapacitetet e pamjaftueshme të furnizimit, pamundësia e marrjes së ujit për një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, shkalla e lartë e amortizimit të sistemeve ekzistuese, kontrolli i pamjaftueshëm i cilësisë dhe metodat e prapambetura të administrimit janë problemet më të rëndësishme për t'u zgjidhur për furnizimin me ujë. Në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social konsiderohet se përmirësimet rrënjësore në furnizimin me ujë të popullsisë janë një objektiv afatgjatë, për shkak të gjendjes së sotme dhe nevojave për financime të mëdha e reforma të thella. Në periudhën afatmesme parashikohet të vazhdojë reforma e decentralizimit të sektorit<sup>75</sup>, privatizimi ose dhënia me koncesion, reforma e tarifave dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit. Parashikohet, gjithashtu, që së shpejti të miratohet edhe strategjia rurale e furnizimit me ujë.

Megjithëse numri i familjeve të zonës urbane që nuk furnizohen me ujë është shumë i vogël, ndërprerjet e furnizimit me ujë në qytete janë shumë të shpeshta dhe familjet kanë ujë të rrjedhshëm vetëm disa orë në ditë. Më keq paraqitet gjendja e furnizimit me ujë në qytetin e Peqinit, ku banorët kanë ujë vetëm rreth 4 orë në ditë, dy orë në mëngjes dhe 2 orë në darkë, nga 7 orë në ditë që është mesatarja në shkallë vendi e furnizimit ditor me ujë të zonës urbane në vitin 2002<sup>76</sup>. Rrjeti i shpërndarjes së ujit, i ndërtuar në vitin 1966, është i amortizuar dhe stacionet e pompave kanë nevojë të përtërihen. Një projekt ide për këtë qëllim është përgatitur në vitin 1999, por nuk është zhvilluar më tej për mungesë fondesh. Më mirë paraqitet gjendja në qytetin e Elbasanit, ku, nëpërmjet një kontrate koncesioni, administrimi i ujesjellesit të qytetit i është dhënë një ndërmarrjeje private, duke krijuar mundësinë e zbatimit të tarifave të reja për konsumatorët dhe të investimeve për furnizimin me ujë sipas parametrave normalë.

<sup>75</sup> Në Matricën e veprimeve me përparësi të SKZHES parashikohet që kalimi i funksioneve nga pushteti qendror tek ai vendor të kryhet brenda vitit 2003.

<sup>76</sup> Sipas Matricës së veprimeve me përparësi të përgatitur nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit në prill 2003.



Furnizimi me ujë i fshatrave | Fig. 5.2

## 5.7 Masat me përparësi

Problemet më të rëndësishme mjedisore të identifikuara në Qarkun e Elbasanit përkojnë plotësisht me përparësitë e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social në fushën e mjedisit. Ato lidhen drejtpërdrejt me objektivin e rehabilitimit të zonave të ndotura dhe pakësimin e ndotjes ekzistuese, aty ku janë vërtetuar nivele të larta të ekspozimit të njerëzve ndaj rrezikut mjedisor, dhe me objektivin e ndaljes së procesit të degradimit të rëndë mjedisor, që sjell si rrezik dëmtimin e vlerave ekonomike dhe vë në pikëpyetje zhvillimin. Bazuar në këtë strategji dhe në këndvështrimin e Objektivave të Mijëvjeçarit për Zhvillimin, rëndësi të veçantë merr zbatimi i këtyre masave me përparësi:

- Studim i pasojave të ndotjes tek shëndeti i banorëve të komunave përreth zonës industriale dhe zbatimi i masave rehabilituese.
- Studim i shkallës së ndotjes së tokës dhe ujërave përreth zonës industriale të Elbasanit dhe i mënyrave më të frytshme të rehabilitimit të tyre (2003-2004).
- Zbatimi i masave për rehabilitimin e tokës dhe ujërave përreth zonës industriale të Elbasanit.
- Zbatimi i masave për uljen e shkallës së ndotjes nga fabrika e çimentos, uzina e çelikut dhe petëzimit dhe uzina e ferrokromit.
- Studimi i masave për largimin e depozitimeve të lëndëve të rrezikshme në zonën industriale të Gramshit.
- Ngritja e një njësie mbikëqyrjeje të ndikimit mjedisor për të gjithë zonën industriale të Elbasanit dhe zonën përreth saj. Plotësimi me pajisje dhe kualifikimi i specialistëve.
- Hartimi i një kuadri ligjor e rregullues të posaçëm për zonën industriale të Elbasanit, ku të përcaktohen qartë normat e shkarkimeve të industrive kryesore dhe masat shtrënguese për respektimin e tyre.
- Përgatitja e një marrëveshjeje midis pushtetit vendor dhe industrive ekzistuese me masat që këto duhet të marrin për të zvogëluar ndikimin në mjedis dhe për të gjelbëruar zonën industriale, me afatet e zbatimit dhe dënimet që rrjedhin nga mosrespektimi i këtyre afateve.
- Ndërtimi i sheshit të depozitimit të hedhurinave të gurta urbane të qytetit të Elbasanit.

- Kalimi i fondit pyjor në administrim të komunave.
- Ringritja e pyjeve të lisit në komunën Labinot-Mal.
- Rivlerësimi i zonave të mbrojtura të rrethit të Librazhdit dhe Elbasanit dhe hartimi i planeve të menaxhimit të tyre.
- Zbatimi i projekteve të rritjes së ndjeshmërisë nga ana e bashkësisë për mbrojtjen e pyjeve.
- Studimi me përparësi dhe përfshirja në planin e investimeve e ndërtimit të ujësjellësve të 20 fshatrave, ku më shumë se 90% e familjeve nuk furnizohen me ujë dhe e 20 fshatrave, ku më shumë se 70% deri 90% e familjeve nuk furnizohen me ujë.
- Financimi i projektit dhe i zbatimit të rikonstruksionit të ujësjellësit të qytetit të Peqinit.